MANUALI PËR PIKAT KOMBËTARE TË PËRFAQËSIMIT PËR CMS-në DHE INSTRUMENTAT E SAJ

UNEP CMS AEWA

Autorësia

E botuar nga Sekretariati i Konventës për Mbrojtjen e Specieve Shtegtare të Kafshëve të Egra dhe Marrëveshja për Mbrojtjen e Shpendëve të Ujit Shtegtarë Afrikano-Euroaziatike.

Citim i rekomanduar
Manuali për Pikat Kombëtare të Përfaqësimit për CMS-në dhe Instrumentat e saj. 2013. Sekretariati i UNEP/CMS dhe Sekretariati i UNEP/AEWA, Bon, Gjermani.

Sekretar Ekzekutiv i CMS-së: Bradnee Chambers

Përgatitur nga: Sekretariati i UNEP/ CMS dhe Sekretariati i UNEP/AEWA
Menaxhimi i Programit: Francisco Rilla
Koordinator Projekti: Sofia Chaichee
Redaktori: Robert Vagg
Grupi i Skicimit: Marco Barbieri, Laura Cerasi, Sofia Chaichee, Bradnee Chambers, Sergey Dereliev, Florian Keil, Bert Lenten, Evelyn Moloko, Francisco Rilla, Robert Vagg

Familja CMS, Pikat Kombëtare të Përfaqësimit dhe Kontribuesit Hanah Al-Samaraie, Susanne Altvater, Akankwasah Barirega, Gerard Boere, Marcel Enzo Calvar, Nancy Céspedes, Thandiwe Chikomo, Marianne Courouble, Natalie Epler, Adeline Fischer, Frauke Fleischer-Dogley, Heidrun Frisch, Almeida Guissamulo, Sandra Hails, Douglas Hykle, Tracy Johnston, Melanie Kemper, Linda Krueger, Donna Kwan, Kelly Malsch, Nina Mikander, Elizabeth Mrema, Taej Mundkur, Narelle Montgomery, James Njogy, Haruko Okusu, Alfred Oteng Yeboah, Warren Papworth, Andrea Pauly, Margi Prideaux, Thomas Rabeil, Houssein Rayaleh, Christiane Roettger, Omar Said, Melissa Sanfourche, Oliver Schall, Simone Schiele, Katrin Schiffer, Johannes Stahl, Andreas Streit, Mohammed Sulayem, Marie Verney, Eleanor Waters, Lindsey West, Nick Williams, Kamar Yousuf, Ying Zhang.

Dizejnimi Teknik: Karina Waedt, www.karinadesign.de

© Sekretariatet e UNEP/CMS dhe UNEP/AEWA të 2013. Ky publikim, me përjashtim të fotografisë së faqes kryesore, mund të riprodhohet në tërësi ose pjesërisht dhe në çdo formë tjetër për qëllime edukative dhe jo-fitimprurëse, pa një leje të posaçme nga mbajtësi i të drejtave të autorit, nëse citohet autorësia e botimit. Sekretariatet e CMS/UNEP dhe AEWA/UNEP do ta vlerësonin marrjen e një kopjeje të çdo lloj publikimi që përdor si burim këtë material. Në asnjë rast ky publikim nuk mund të përdoret për rishitje ose për qëllime të tjera tregtare pa një leje paraprake nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin.

DEKLARATË
Përmbajtja e këtij vëllimi nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet e Sekretariateve të UNEP/CMS dhe UNEP/AEWA ose organizatave kontribuese. Emërtimet e përdorura dhe prezantimi nuk nënkuptojnë shprehjen e asnjë mendimi të çfarëdoshëm nga ana e Sekretariateve të UNEP/CMS dhe UNEP/AEWA ose organizatave kontribuese lidhur me statusin ligjor të një shteti, territori, qyteti apo zone në juridiksionin e tij, ose në lidhje me përcaktimin e kufijve ose vijës kufitare. Pjesa më e madhe e këtij manuali është përkthyer nga vullnetarët nga versioni origjinal në Anglisht, dhe nuk ka garanci për saktësinë. Referenca është në versionin Anglisht, të cilin mund ta gjeni në faqen e sitit të CMS-së.

Ky publikim është financuar bujarisht nga Komisioni Europian nëpërmjet Marrëveshjes së Bashkëpunimit Strategjik midis ENRTP* me UNEP.
* Programi Tematik për Mjedisin dhe Menaxhimin e Qëndrueshëm të Burimeve Natyrore përfshirë këtu dhe Energjinë.

Përkthimi nga origjinali Anglisht në versionin Shqip është menaxhuar nga Fondacioni Rosetta dhe vullnetarët e saj Erald Kumrija, Julinda Karaboja, Orian Cuko, Vjosa Kalaveshi dhe Gentian Cane. Përkthimi dhe dizejnimi është mbështetur nga Fondacioni EuroNatur. Përkthimi përfundimtar dhe faqosja analoge me versionin anglisht u realizua nga Besjana Sevo (AOS).
Kopje të këtij publikimi janë të disponueshme në faqen e internetit të Sekretariatit të UNEP/CMS: http://www.cms.int

Sekretariati i UNEP / CMS
Kampusi UN
Platz der Vereinten Nationen 1, D-53113 Bon, Gjermani
Tel: (+49 228) 815 24 01/02, Fax: (+49 228) 815 24 49
E-mail: secretariat@cms.int, www.cms.int
ISBN 13 978-3-937429-88-5

Tabela e Përmbatjes

Lista e Tabelave V

Lista e Figurave V

Lista e Anekseve V

Parathënie VI

1 Hyrje 1

1.1 Qëllimi dhe Struktura e këtij Manuali 3

1.2 Përcaktimi PKP-ve të Familjes CMS 4

2 Informacion i Përgjithshëm 10

2.1 Arsyetimi për Mbrojtjen e Specieve Shtegtare 10

2.2 Roli i CMS-së 12

2.2.1 Speciet e Mbuluara 12

2.2.2 Anëtarësia e CMS-së dhe Instrumentat të saj 13

2.3 Organet e CMS-së dhe Instrumentat e saj 17

2.3.1 Organet Vendim-marrëse 19

2.3.2 Organet Vartëse 19

2.3.2.1 Organe që Ofrojnë Politika Kalimtare dhe Udhëzime Administrative. 19

2.3.2.2 Organet Këshillimore Shkencore dhe Teknike 20

2.3.2.3 Grupet e Punës 21

2.3.3 Sekretariatet dhe Njësitë Koordinuese 21

2.4 Financimi i Familjes CMS 21

2.4.1 Kontributet e Vlerësuara 21

2.4.1.1 CMS 21

2.4.1.2 Marrëveshjet 21

2.4.2 Kontributet Vullnetare 22

2.4.2.1 CMS dhe Marrëveshjet 22

2.4.2.2 Memorandumet e Mirëkuptimit 22

3 Funksionet në lidhje me Administrimin, Financimin dhe Komunikimin 28

3.1 Emërimi i PKP-ve, Përfaqësuesve dhe Ekspertëve të tjerë 28

3.1.1 Emërimi i PKP-ve 28

3.1.2 Emërimi i Anëtarëve të Organeve Vartëse 29

3.1.2.1 Emërimi i Ekspertëve në Organet Vartëse Shkencore dhe Teknike 29

3.1.2.2 Emërimi i Anëtarëve në Organet që Ofrojnë Politika dhe Udhëzime Administrative Ndërmjet Sesioneve (Përfaqësues në Komitetin e Përhershëm) 31

3.1.2.3 Emërimi i Anëtarëve në Grupet e Punës 31

3.2 Komunikimi dhe Shpërndarja e Informacionit 32

3.3 Çështjet Financiare 34

Tabela e Përmbatjes (përmb.)

4 Takimet e Organeve Vendim–marrëse të Familjes CMS 45

4.1 Përpara Takimit 46
4.1.1 Përgatitja për Thelbin 46
4.1.1.1 Këshillimi Kombëtar 47
4.1.1.2 Propozimi i Specieve 47
4.1.1.3 Vendimet 47
4.1.1.4 Këshillime Rajonale 48
4.1.2 Përgatitja për Logjistikën 49
4.1.2.1 Përbërja e Delegacioneve 49
4.1.2.2 Financimi 50
4.1.2.3 Regjistrimi Paraprak 50
4.1.2.4 Kredencialet 50
4.1.2.5 Vizat 51

4.2 Në Takim 51
4.2.1 Regjistrimi dhe Kredencialet 51
4.2.2 Gjatë Takimit (në sesion) 51
4.2.2.1 Kryerja e Ndërhyrjeve dhe Deklaratave Gjatë Takimeve 54
4.2.3 Koordinimi Rajonal 54
4.2.4 Komitetet 54
4.2.5 Grupet e Punës 54
4.2.6 Aktivitete Dytësore 56
4.2.7 Koordinimi brenda Delegacionit 56

4.3 Ndjekja 56

4.4 Takimet Negociuese 57
4.4.1 Pyetje për Parashtrim 57
4.4.2 Logjistika 58

5 Zbatimi 65

5.1 Çfarë Përfshin Vetë Zbatimi? 66

5.2 Cikli i Zbatimit 66
5.2.1 Hapi 1 Familiarizimi me Instrumentin(tet) dhe Kërkesat për Raportimin Kombëtar 67
5.2.2 Hapi 2 Rishikim i Legjislacionit Kombëtar dhe Identifikimi i Mangësive 68
5.2.3 Hapi 3 Organizimi i një Proçesi Këshillimor Kombëtar 68
5.2.4 Hapi 4 Zhvillimi i Strategjisë Kombëtare dhe/ose Planin e Zbatimit 69
5.2.5 Hapi 5 Nxit dhe Lehtëso Zbatimin e Planit të Veprimit Strategjik Kombëtar për Biodiversitetin (SKPVB) dhe/ose Planin Kombëtar të Zbatimit (PZK) 75
5.2.6 Hapi 6 Monitorimi, Vlerësimi dhe Raportimi mbi Ecurinë e Zbatimin në Nivel Kombëtar 80

5.3 Aspektet Ndërkombëtare të Zbatimit 81
5.3.1 Zbatimi Ndërkufitar dhe Rajonal 81
5.3.2 Bashkëpunimi me Organizatat Ndërkombëtare 82

Tabela e Përmbatjes (përmb.)

6 Raportimi Kombëtar 88
6.1 Përse është i nevojshëm Raportimi Kombëtar? 89
6.1.1 Si Përshtatet Raportimi Kombëtar në Proçesin e Përgjithshëm të Zbatimit 89
6.1.2. Baza Ligjore për Raportimin Kombëtar 89
6.2 Përfitimet e Raportimit Kombëtar për Vendin Raportues 89
6.2.1 Rëndësia dhe Përdorimi i Informacionit të Paraqitur në Raportet Kombëtare 89
6.3 Kur dhe Çfarë Raportohet 91
6.3.1 Shpeshtësia dhe Afatet 91
6.3.2 Formatet e Raportit Kombëtar 91
6.4 Kush Raporton dhe Si raportohet 92
6.4.1 Përfshirja e Grupeve të Interesit dhe Koordinimi 92
6.4.2 Platformat e Raportimit 92
6.5 Hapat për Përpilimin e Raportit Kombëtar 94
6.6. Dorëzimi i Raportit Kombëtar dhe Ndjekja 96
6.6.1 Çfarë ndodh pas Dorëzimit të Raportit Kombëtar? 96

Fjalori 99

Lista e Faqeve të Internetit 104

Atributet për Fotografitë 105

Lista e Tabelave

Tabela 2.1 Lista e Instrumenteve të Familjes CMS 14
Tabela 2.2 Pasqyra e Organeve Vartëse të Përcaktuara nga CMS-ja dhe Instrumentat e saj 18
Tabela 2.3 Metodat e Financimit për Disa nga Instrumentet e Familjes CMS 23
Tabela 3.1 Anëtarësimi i Organeve Këshillimore Shkencore e Teknike në Organet e Familjes CMS ... 30
Tabela 3.2 Përbërja e Përfaqësuesve të Komiteteve të Përhershme të Familjes CMS 31
Tabela 6.1 Baza Ligjore dhe Afatet për Raportimin Kombëtar sipas CMS-së dhe Instrumenteve të saj 90

Lista e Figurave

Figura 2.1 Shtegtimi i Balenave me Gungë 11
Figura 3.1 Rolet e Komunikimit të PKP-së 33
Figura 4.1 Përgatitja e Takimit 49
Figura 5.1 Cikli i Zbatimit për Instrumentet e Familjes CMS 67

Lista e Anekseve

ANEKSI 1.1 Takimi i 37të i Komitetit të Përhershëm të CMS, Dok. 23 (Bon, 2010) Pikat Kombëtare të Përfaqësimit për CMS, Termat e Referencës 5
ANEKSI 1.2 Takimi 6të i Shteteve Nënshkruese të Memorandumit IOSEA (Bangkok, 2012), Termat e Referencës dhe Udhëzimi për Pikat Kombëtare të Përfaqësimit të IOSEA 7
ANEKSI 2.1 Neni VII i Konventës, Konferenca e Palëve 26
ANEKSI 3.1 Rezoluta 9.15 e Konferencës së Palëve të CMS-së (Romë, 2008), Përbërja dhe Organizimi i Komitetit të Përhershëm 37
ANEKSI 3.2 Rezoluta 2.6 e Takimit të Palëve të Memorandumit AEWA (Bon, 2001), Organizimet Institucionale: Komiteti i Përhershëm 40
ANEKSI 3.3 Rezoluta 5.8 e Takimit të Palëve të Memorandumit EUROBATS (Lubjanë, 2006), Krijimi i një Komiteti të Përhershëm të Marrëveshjes 43
ANEKSI 4.1 Rezoluta 1.5 e Konferencës së Palëve të CMS-së (Bon, 1985), Formati i Propozimeve mbi Amendimet e Shtojcave 61
ANEKSI 4.2 Rezoluta 10.4 e KP-së të CMS-së (Bergen, 2011), Mbetjet e Ngurta Detare 63
ANEKSI 5.1 Paketa Trajnuese e SKPVB e KBD-së Versioni 2.1, Kutia 4, Shtjellimi i një SKPVB-je 86

Parathënie

Qëllimi i këtij Manuali është të mbështesë Pikat Kombëtare të Përfaqësimit (PKP) të grupimit CMS në zbatimin e Konventës dhe instrumenteve të saj. Manuali gërsheton një qasje të dyfishtë-është një dokument reference dhe mjet trainimi, dhe duke forcuar institucionet kombëtare, Manuali duhet të kontribuojë domosdoshmërisht në lehtësimin e përpjekjeve kombëtare dhe mbarëbotërore për mbrojtjen e specieve.

Përfaqësuesit qeveritarë si ata me shumë vite përvojë ashtu dhe ata të emëruar së fundmi- të ngarkuar me përgjegjësinë e zbatimit të CMS-së dhe instrumentat e afërt të saj, kanë komentuar se nuk kanë pasur praktikisht asnjë udhëzim në dispozicion që u shpjegon se cili duhet te jete roli i tyre. Në përgjigje të kësaj, Sekretariatet vendosën të përpilojnë këtë manual, me besimin se duke përshkruar mekanizmat e anëtarëve të ndryshëm të familjes CMS, PKP-të do të jenë më të mirëvendosura për pjesëmarrje, duke u lejuar si rrjedhojë shtetet anëtare të përdorin mundësitë e ofruara nga forumet rajonale dhe globale, të themeluara në veçanti për të siguruar veprimet bashkëpunuese dhe të bashkërenduara për të mirën e kafshëve shtegtare të rrezikuara.

Manuali është zhvilluar nga Sekretariati i Konventës për Mbrojtjen e Specieve Shtegtare të Kafshëve të Egra (e njohur gjithashtu edhe si Konventa për Speciet Shtegtare (CMS) ose Konventa e Bonit) në bashkëpunim me Sekretariatin e Marrëveshjes mbi Mbrojtjen e Shpendëve të Ujit Shtegtarë Afrikano-Euroaziatike (UNEP/AEWA), dhe Institutin Ekologjik. Ndihmë tejet e çmuar është ofruar gjithashtu nga Sekretariate të tjera të familjes CMS dhe në këshillim të ngushtë me Pikat Kombëtare të Përfaqësimit (PKP-të) të familjes CMS, partnerët kyç të familjes CMS (Sekretariatin e Ramsar, UNEP/WCMC, Fondin për Mbrojtjen e Saharasë, BirdLife Internacional, Shoqata për Mbrojtjen e Kafshëve të Egra, Rrjeti i Kafshëve të Egra Shtegtare, dhe Zyra Rajonale e UNEP për Afrikën). Zhvillimi i Manualit është bërë i mundur nga financimi i Programit Tematik për Mjedisin dhe Menaxhimin e Qëndrueshëm të Burimeve Natyrore përfshirë Marrëveshjen e Bashkëpunimit Strategjik mbi Energjinë (ENRTP) midis Komisionit Europian (DG e Mjedisit) dhe Programit i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin (UNEP).

Dr. Bradnee Chambers,
Sekretari i Përgjithshëm i Sekretariatit UNEP/CMS

1 Hyrje

"Kafshët e egra në format e tyre të shumta përbëjnë një pjesë të pa-zëvendësueshme të sistemit natyror të tokës që duhet të mbrohet për të mirën e njerëzimit."

Parathënie e tekstit të Konventës për Mbrojtjen e Specieve Shtegtare të Kafshëve të Egra.

Kur përfaqësuesit e mbi 100 shteteve u mblodhën në Stokholm, Suedi më Qershor 1972 për të diskutuar gjendjen e mjedisit në botë në Konferencën e OKB mbi Mjedisin Njerëzor, një nga nevojat e ngutshme që ata njohën ishte një marrëveshje mbarëbotërore mbi mbrojtjen e specieve shtegtare.

Konventa për Mbrojtjen e Specieve Shtegtare të Kafshëve të Egra — përgjithësisht e njohur me emërtimin e shkurtuar Konventa mbi Speciet Shtegtare (CMS)– u realizua pasi qeveria Gjermane mori përsipër përgjegjësinë për të organizuar një konferencë ndërkombëtare për të dakordësuar tekstin e një traktati ndërkombëtar. Negociatat përfunduan me sukses në Qershor të vitit 1979 në Bad Godesberg, një periferi e Bonit, i cili në atë kohë ishte kryeqyteti i Gjermanisë (për këtë arsye Konventa ndonjëherë njihet edhe si "Konventa e Bonit").

Teksti i Konventës vendos parimet të cilat theksojnë objektivat e identifikuara në Konferencën e Stokholmit. Palët pranojnë rëndësinë e mbrojtjes së specieve shtegtare dhe pajtohen që Shtetet Shtrirëse – ato shtete në të cilat speciet shtegtare kalojnë ose shpenzojnë pjesë të jetës së tyre - duhet të ndërmarrin veprime të përbashkëta. {→shih Kutinë e Informacionit 1.1. }

KUTI INFORMACIONI 1.1

Parathënia e Konventës dhe Neni II – Parimet Themelore

Palët Kontraktuese,

DUKE PRANUAR që kafshët e egra në format e tyre të shumta janë një pjesë e pazëvendësueshme e sistemit natyror të tokës që duhet të ruhet për të mirën e njerëzimit;

TË NDËRGJEGJSHËM që çdo gjeneratë e njerëzimit zotëron burimet e tokës për gjeneratat e ardhshme dhe ka detyrimin të sigurojë që kjo trashëgimi të mbrohet, dhe të përdoret me mençuri aty ku shfrytëzohet;

TË VETËDIJSHËM për vlerën gjithnjë në rritje të kafshëve të egra nga këndvështrimi mjedisor, ekologjik, gjenetik, shkenor, estetik, çlodhës, kulturor, edukativ, social dhe ekonomik;

TË VËMENDSHËM veçanërisht për ato specie të kafshëve të egra që shtegtojnë përmes ose jashtë kufijve juridiksionale kombëtare;

DUKE KUJTUAR që Shtetet janë dhe duhet të jenë mbrojtësit e specieve shtegtare të kafshëve të egra që jetojnë brenda ose kalojnë përmes kufijve të tyre juridiksionalë kombëtarë;

TË QARTË që mbrojtja dhe menaxhimi efektiv i specieve shtegtare të kafshëve të egra kërkon veprime të bashkërenduara nga të gjitha Shtetet brënda kufijve juridiksionalë kombëtare në të cilin këto specie kalojnë pjesë të ciklit të tyre jetësor;

DUKE RIKUJTUAR Rekomandimin 32 të Planit të Veprimit miratuar nga Konferenca e Kombeve të Bashkuara mbi Mjedisin Njerëzor (Stokholm, 1972), dhe të përmendur në Sesionin e Njëzetë e Shtatë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara;

RANË DAKORT si vijon …

… Neni II

Parimet Bazë

1. Palët njohin rëndësinë e specieve shtegtare që duhen mbrojtur dhe Shtetet Kufitare që bien dakort për të vepruar ku është e mundur dhe e përshtatshme, duke i kushtuar vëmendje të veçantë specieve shtegtare gjendja e mbrojtjes e të cilave është e pafavorshme, dhe marrja individualisht ose në bashkëveprim e hapave të përshtatshëm dhe të nevojshëm për të mbrojtur këto specie dhe habitatet e tyre.

2. Palët njohin nevojën për të ndërmarrë veprime për të shmangur atë që, një specie shtegtare të bëhet e rrezikuar.

3. Në veçanti, Palët:
   a) duhet të nxisin, bashkëpunojnë dhe mbështesin kërkimet për speciet shtegtare;
   b) do të përpiqen të sigurojnë mbrojtje të menjëhershme për speciet shtegtare të përfshira në Shtojcën I; dhe
   c) do të përpiqen të përfundojnë DOKUMENTE MIRËKUPTIMI që përfshijnë mbrojtjen dhe menaxhimin e specieve shtegtare të përfshira në Shtojcën II.

Pikat Kombëtare të Përfaqësimit (PKP) përbëhen nga zyrtarë të emëruar nga qeveria me përgjegjësinë kryesore në mbikqyrjen dhe udhëheqjen e zbatimit të Konventës për Speciet Shtegtare (CMS) ose një prej instrumenteve të saj në nivel kombëtar dhe në koordinimin me Sekretariatin ose Njësinë Koordinuese dhe homologëve të tyre në Shtetet Anëtare të tjera. Ata përballen me pyetje të ndryshme gjatë proces zbatimit në nivel kombëtar {→shih Paragrafin 2.3 për më shumë informacion rreth këtyre instrumenteve}

1.1 Qëllimi dhe Struktura e këtij Manuali

Manuali ka për qëllim të mbështesë PKP-të e familjes së CMS në zbatimin e Konventës dhe instrumenteve të saj. Ai është zhvilluar për të adresuar mangësitë në informacion dhe mungesën e udhëzimeve mbi rolin dhe përgjegjësitë e PKP-ve të familjes së CMS. Këto mangësi përfaqësojnë një nga faktorët që kufizojnë një përfshirje efektive të PKP-ve në proçese të lidhura me familjen e CMS. Manuali synon të shërbejë si një mjet burimi udhëzues edhe si një mjet praktik trainimi për të mbështetur PKP-të në zbatimin e CMS dhe instrumentave të saj.

Për ta bërë këtë Manual sa më të dobishëm, formati konsiston në gjashtë kapituj kryesorë të cilët janë ndarë më tej në seksione dhe nën-seksione. Informacioni shtesë për çdo kapitull është theksuar në Kutitë e Informacionit dhe përfshin Lista Kontrolli dhe Shembuj Praktikë të përzgjedhura me kujdes. Materialet shtesë dhe lidhjet elektronike të faqeve përkatëse të internetit janë paraqitur në fund të Manualit.

Përmbajtja e gjashtë kapitujve:

- Hyrje (Kapitulli 1)
- Informacion i përgjithshëm mbi strukturën dhe funksionimin e instrumenteve të Familjes CMS (Kapitulli 2)
- Rolet, përgjegjësitë dhe proçeset që lidhen me Pikat Kombëtare të Përfaqësimit të Familjes CMS (Kapitulli 3)
- Procedurat dhe detyrat që lidhen me pjesëmarrjen e PKP-ve në takimet e Familjes CMS (Kapitulli 4)
- Udhëzim për zbatimin e instrumenteve të Familjes CMS në nivel kombëtar (Kapitulli 5)
- Proçesi i raportimit kombëtar pranë instrumenteve të Familjes CMS (Kapitulli 6)

1.2 Përcaktimi i PKP-ve të Familjes CMS

Termi **"Familja e CMS"**, siç përdoret në këtë manual, përfshin vetë CMS-në si edhe instrumentet e saj, domethënë, Marrëveshjet dhe Memorandumet e Mirëkuptimit (MOU) nënshkruar nën kujdesin e saj {→ shih Paragrafin 2.3 për më shumë informacion rreth këtyre instrumenteve }

Termi **"PKP e Familjes CMS"** është përdorur për t'ju referuar personit ose personave të caktuar nga qeveria e një Shteti Anëtar për të qenë përgjegjës në trajtimin e çështjeve që lidhen me CMS-në dhe/ose me një ose më shumë prej instrumenteve të saj.

CMS-ja dhe disa nga instrumentat e saj kanë zhvilluar terma reference për PKP-të e tyre përkatëse. Ky Manual merr në konsideratë këto dokumente, të cilat përmbledhin rolet dhe përgjegjësitë e PKP-së, dhe i trajton më në detaje. Disa prej udhëzimeve të përfshira në këtë manual të familjes CMS janë bazuar mbi Termat e Referencës (TR) të PKP-ve të CMS-së, paraqitur dhe miratuar në Mbledhjen e 37të të Komitetit të Përhershëm të CMS-së dhe TR të Memorandumit të Mirëkuptimit për PKP-të për Breshkën e Detit në Oqeanin Indian dhe Azinë Jug-Lindore (IOSEA) miratuar në Mbledhjen e 6të të Shteteve Nënshkruese në 2012. Të dyja grupet e termave janë përfshirë në {→ Anekset 1.1 & 1.2} të këtij manuali.

Çështjet në lidhje me CMS-në dhe/ose me një ose më shumë prej instrumentave të saj mund të përfshijnë përfaqësimin e qeverisë së caktuar në marrëdhëniet e përditshme të saj me Sekretariatin(tet)/Njësinë(të) Koordinuese, duke përfshirë aktivitete të tilla si komunikimet, monitorimin dhe raportimin, shpërndarjen e informacionit, përfaqësimin në mbledhje, përgjigjen e kërkesave të ndryshme dhe promovimin ose lehtësimin e zbatimit kombëtar të CMS-së dhe/ose të një ose më shumë prej instrumentave të saj.

Paraqitja e Informacionit dhe Përdorimi i Simboleve.

Në rastet kur informacioni i dhënë i takon edhe CMS-së edhe instrumentave të saj, ai do të paraqitet në mënyrë të përgjithshme. Vetëm kur ka ndryshim midis CMS-së dhe instrumentave të saj, atëherë këto informacione do të jenë të theksuara në mënyrë mjaft të qartë.

Në kapitujt në vijim, ka Shembuj Praktikë , Këshilla të Vlefshme , Lista Kontrolli , Kuti Informacioni , Përseritje Kapitulli , Anekse & hapësire për Shënime për të ndihmuar lexuesin që të kuptojë përmbajtjen e këtij Manuali.

Kapitulli në vijim do të ofrojë disa prej informacioneve të përgjithshme mbi Familjen CMS.

SHËNIME

ANEKSI 1.1

Takimi i 37të i Komitetit të Përhershëm të CMS, Dok. 23 (Bon, 2010)
Pikat Kombëtare të Përfaqësimit për CMS
Termat e Referencës

Hyrje

Ky dokument është zhvilluar për të qartësuar rolet e përgjithshme dhe përgjegjësitë e Pikave Kombëtare të Përfaqësimit të CMS-së dhe të japë udhëzime se si ato mund të kontribuojnë në mënyrë më efektive në funksionimin e CMS-së dhe në lehtësimin e ndërveprimit midis Palës që ato përfaqësojnë dhe CMS-së.
Si pika kontakti parësore të Palëve të CMS-së, Pikat Kombëtare të Përfaqësimit kanë një rëndësi të madhe për CMS-në por dhe për vetë Palët. Pikat Kombëtare të Përfaqësimit për CMS-në shërbejnë si urë lidhëse me CMS-në si dhe institucionet përgjegjëse në vend nëpërmjet shkëmbimit të vazhdueshëm të informacionit.

Pikat e Përfaqësimit duhet të punojnë në një nga Ministritë e linjës që merret me mbrojtjen e natyrës në vendet e tyre. Njohuritë bazë mbi operacionet të Konventës janë të dëshirueshme.

Gjuhët e punës së Konventës janë anglishtja, frëngjishtja dhe spanjishtja dhe si rrjedhojë Pika e Përfaqësimit duhet të jetë e aftë të komunikojë të paktën në një nga këto gjuhë.

Përgjegjësitë e Pikave Kombëtare të Përfaqësimit.

Pikat Kombëtare të Përfaqësimit të CMS-së duhet:

- të organizojnë konfirmimin e emërimit të tyre nëpërmjet komunikimit zyrtar nga Ministrat e tyre. Sekretariati i CMS-së duhet te pajiset me informacion kontakti të plotë mbi Pikat e Përfaqësimit dhe të personave të tjerë të kontaktit në mungesë të tyre. Çdo ndryshim në emërim ose informacion kontakti duhet t'i komunikohet Sekretariatit sa më shpejt të jetë e mundur;
- Të sigurojnë përgatitjen, plotësimin dhe dorëzimin në kohë të Raportit Kombëtar të CMS-së pranë Sekretariatit të CMS-së;
- Të mbikëqyrin dhe sigurojnë pagesën e plotë dhe të menjëhershme të kontributit vjetor të CMS-së, dhe të hulumtojnë mundësitë për sigurimin e kontributeve vullnetare;
- Të marrin masa për emërimin e Këshilltarit Shkencor të Palës dhe të informojnë zyrtarisht drejtpërdrejt Sekretariatin e CMS-së mbi informacionin e kontaktit dhe fushën e ekspertizës së kandidatit të vendit të tyre që do të shërbej si Këshilltar Shkencor;
- Të organizojnë dhe të ndjekin proçesin e emërimit të pikave përfaqësuese për Memorandumin e Mirëkuptimit të CMS-së (kur përgjegjësia për Memorandumin nuk qëndron tek Pika e Përfaqësimit e CMS-së) si dhe të veprojnë si pika përfaqësimi për ato instrumenta në periudhë të ndërmjetme dhe të informojnë Sekretariatin e CMS-së në përputhje me rrethanat;
- Të shkëmbejnë rregullisht informacion me Pikat e Përfaqësimit për Marrëveshjet dhe Memorandumet e Mirëkuptimit, mundësisht përmes krijimit të forumeve rajonale dhe kombëtare me Pikat e Përfaqësimit për Memorandume Mirëkuptimi, të promovojnë sinergji dhe të forcojnë koordinimin me ato për të evituar përsëritjen në mënyrë të panevojshme të përpjekjeve;*

* **Kili ka një Komitet Kombetar të CMS-së:** Komiteti Kombëtar i CMS-së, i krijuar nga Dekreti Nr.2 i 2 Janarit 2006, për të këshilluar Ministrin e Punëve të Jashtme, si një njësi koordinuese midis agjensive të ndryshme shtetërore që kanë në fokus Mbrojtjen e Specieve Shtegtare të Kafshëve të Egra. Ai kryesohet nga Ministria e Punëve të Jashtme. Ka një Sekretariat Teknik, përgjegjës për Bujqësinë dhe Shërbimin Blegtoral (SAG). Ai përfshin gjithashtu shërbimet e mëposhtme: Komisionin Kombëtar Mjedisor, Nënsekretarinë e Marinës, Nënsekretarinë e Peshkimit, Drejtorinë e Përgjithshme të Territorit Detare dhe Marinën Tregtare, Shërbimin Kombëtar të Pyjeve, Drejtorinë e Përgjithshme të Ujit, Shërbimin Kombëtar të Peshkimit Detar, Institutin Antarktik Kilian, Muzeu Kombëtar të Historisë Natyrore dhe Komisionin Kombëtar për Kërkime Shkencore dhe Teknike.

- Të shkëmbejnë rregullisht informacion me Pikat e Përfaqësimit për Marrëveshjet Shumë-Palëshe (mbi Biodiversitetin), mundësisht përmes krijimit të një Forumi Kombëtar të Pikave të Përfaqësimit, dhe të promovojnë sinergji dhe të forcojnë koordinimin mes tyre për të evituar përsëritjen e veprimeve në mënyrë të panevojshme;
- Të mbajnë një rrjedhë komunikimi të ndërsjelltë e të përhershme me institucionet e Palëve me fokus në çështjet e CMS-së dhe politik-bërësit e vendeve të tyre nga njëra anë dhe sekretariati i CMS-së nga ana tjetër;
- Të kontrollojnë rregullisht faqen e internetit të CMS-së (www.cms.int) për t'u informuar mbi zhvillimet më të fundit dhe përditësimet dhe të ndajnë me Sekretariatin e CMS-së informacion të mundshëm rreth arritjeve të vendit të tyre dhe veprimeve drejt zbatimit të Konventës dhe aktiviteteve që lidhen me mbrojtjen e specieve shtegtare të rrezikuara;
- T'i sigurojnë Sekretariatit të CMS-së informacione lidhur me masat ligjore, administrative dhe shkencore të ndërmarra nga vendi në lidhje me aktivitetet e mbrojtjes të ndërmarra në vendin e tyre;
- Të sigurojnë që vendi i tyre të përfaqesohet në mbledhjet zyrtare të CMS-së si Konferenca e Palëve duke koordinuar në kohën e duhur emërimin e delegacionit, sigurimin dhe dorëzimin e kredencialeve, dhe aplikimin për financim nëse është e aplikueshme dhe e nevojshme;
- Të sigurojnë që konkluzionet e mbledhjeve të CMS-së, veçanërisht të Konferencës së Palëve të CMS-së, të përcillen në vend dhe të fillojnë zbatimin në nivel kombëtar të vendimeve të marra, nëse është e përshtatshme;
- T'u përgjigjen ftesave sa më shpejt të jetë e mundur (përfshirë përcjelljen e ftesave tek marrësit e tjerë, kur duhet) në lidhje me Konferencën e Palëve, mbledhjet dhe seminaret;
- Të identifikojnë masa nxitëse për grupe interesi kombëtare për një pjesëmarrje aktive në mbrojtjen e specieve shtegtare në vend;
- Të kryejnë këshillime me institucionet përgjegjëse përpara takimeve të Konventës për të diskutuar axhendën dhe dokumentat, dhe të përpilojnë relacionin e vendit në takim (statusi i politikave, raportet e zbatimit, rezultatet e kërkimit shkencor, vështirësitë e hasura etj). Të ndjekin përmbushjen e kërkesave të Sekretariatit p.sh. të nxisë shqyrtimin e raporteve të takimit; ofrimin e të dhënave mbi dokumente, plotësimin e pyetësorëve mbi çështje specifike që lidhen me Konventen, etj;
- Të promovojnë hartimin dhe/ose rishikimin e dokumentave përkatëse p.sh. propozime mbi listën e specieve, Rezoluta dhe Rekomandime;
- Të promovojnë koordinim kombëtar mes institucioneve të ndryshme përmes shkëmbimit të përvojave kombëtare, rajonale dhe nën-rajonale për mbrojtjen e specieve dhe të administrojnë mobilizimin dhe shpërndarjen e burimeve;
- Të udhëheqin fushata të ndërgjegjësimit publik (përmes mediave për praktikat më të mira ose publikimit të shkeljeve dhe pasojave ligjore) për të përkrahur pajtueshmërinë dhe gjenerimin e informacionit për vlerësimin e statusit të pajtueshmërisë me CMS-në si dhe të përcaktojnë përmes këshillimeve mënyra dhe mjeteve për nxitjen dhe rritjen e nivelit të pajtueshmërisë;
- Të udhëheqin zhvillimin e një plan zbatimi të CMS-së në nivel kombëtar për një zbatim efektiv të CMS-së si dhe të rezolutave dhe vendimeve të organeve të saj drejtuese;
- Të identifikojnë aktivitete të cilat kanë nevojë për burime shtesë dhe të ndihmojnë në mobilizimin e burimeve të tilla;
- Të kërkojnë në mënyrë aktive të dhëna ose informacion nga Pika Kombëtare Përfaqësimi të tjera veçanërisht ato nga i njëjti rajon, në rastin kur Pika Kombëtare e Përfaqësimit e CMS-së është një përfaqësues rajonal në një organ vartës ose grup pune (shih Termat e Referencës për anëtarët e Komisionit të Përhershëm);
- Në rastet ku Shteti Palë nuk është pjesë e Komitetit të Përhershëm të CMS-së apo në asnjë Grup Pune, të koordinohen me përfaqësuesin përkatës rajonal dhe të sigurojnë pergjigje në kohë ndaj çdo kërkese për të dhëna ose informacion;

ANEKSI 1.2

Takimi 6 të i Shteteve Nënshkruese të Memorandumit IOSEA (Bankok, 2012) Termat e Referencës dhe Udhëzim për Pikat Kombëtare të Përfaqësimit të IOSEA

Hyrje

Ky dokument u zhvillua për të qartësuar rolet dhe përgjegjësitë e Pikave Kombëtare të Përfaqësimit të IOSEA-s dhe për ta bërë më frytdhënëse pjesëmarrjen në mbledhjet e Shteteve Nënshkruese. Në kushtet e një ndryshimi periodik të delegatëve zyrtarë, është konsideruar me vlerë ekzistenca e një dokumenti që shërben si një udhëzues bazë për aktivitetet para, gjatë ose pas një mbledhjeje të Shteteve Nënshkruese. Kjo do t'i jepte mundësi përfaqësuesve të IOSEA-s që të kontribojnë në mënyrë më efektive në drejtimin e aktivitetit të IOSEA-s ndërmjet mbledhjeve të rregullta të Shteteve Nënshkruese dhe të kuptojnë më mirë proçesin që e rrethon vetë atë - me qëllim që të rritet vlera e kësaj ngjarjeje të veçantë për bashkëpunim ndërkombëtar në ruajtjen e breshkës së detit.

Termat e referencës nuk synojnë të jenë strikte, përderisa është i njohur fakti se Memorandumi i Mirëkuptimit nuk ka fuqi ligjore detyruese dhe rrethanat për zbatimin ndryshojnë nga njëri Shtet Nënshkrues në tjetrin. Sidoqoftë, ato konsiderohen se ofrojnë orientim të vlefshëm tek Pikat Përfaqësuese për t'i asistuar ato në detyrat e rëndësishme për të cilat janë caktuar.

Aktivitetet Ndërmjet Sesioneve

Me qëllimin për të rritur përfitimin dhe për të forcuar rezultatet, secila Pikë Përfaqësimi për IOSEA duhet:

1. Të informojë Sekretariatin sa më shpejt të jetë e mundur për ndonjë ndryshim në personelin përgjegjës për çështjet IOSEA, në mënyrë që Sekretariati të mund të sigurojë marrjen e të gjithë komunikimeve të përshtatshme.
2. Të udhëheq ngritjen dhe funksionimin aktiv, ashtu si duhet, të një komiteti apo rrjeti kombëtar* për breshkën e detit, për të mbledhur së bashku përfaqësues të ministrive, agjencive, departamenteve dhe grupeve të tjera të rëndësishme të interesit, përfshirë organizatat akademike dhe kërkimore, organizatat jo-qeveritare, sektorin privat (të tilla si organizatat e peshkimit, organizatat e turizmit, etj). Ky Komitet duhet të mblidhet rregullisht në kohë për të shkëmbyer informacion mbi ruajtjen e breshkës së detit dhe për të vlerësuar zbatimin e IOSEA.
3. Të mbikqyrë përgatitjen dhe/ose përditësimin e Raportit Kombëtar të IOSEA-s, përfshirë Kartelën me të Dhënat e Vendit, duke përdorur Mjetin e Raportimit Online të krijuar për këtë qëllim. Proçesi i mbledhjes së informacionit nga grupet e interesit për t'u hedhur në Raportin Kombëtar, duhet të fillojë të paktën 6-9 muaj para mbledhjes së Shteteve Nënshkruese. ("Editori" lejon Pikat e Përfaqësimit të pajisura me fjalëkalim të bëjnë ndryshime në raport në çdo kohë).
4. Të identifikojë dhe të delegojë specialist(ë) teknik të përshtatshëm për përgatitjen e vlerësimeve periodike të specieve, në përputhje me vendimet e Mbledhjes së Shteteve Nënshkruese.
5. Të këshillohet me faqen e internetit të IOSEA-s (www.ioseaturtles.org) të paktën njëherë në muaj,

*Programi 6.4c) i Planit të Ruajtjes dhe Menaxhimit të Memorandumit të Mirëkuptimit të IOSEA-s nxit bashkëpunimin në dhe midis sektorëve qeveritarë dhe jo-qeveritarë, përfshirë zhvillimin dhe/ose forcimin e rrjeteve kombëtare. Progresi drejt ngritjes së komiteteve të tilla kombëtare 'të koordinimit' është analizuar që prej Mbledhjes së Tretë të Shteteve Nënshkruese (2005); dhe një rubrikë e veçantë në faqen e internetit të IOSEA-s (nën 'Anëtarësimin') i është kushtuar kësaj teme të rëndësishme.

parapëlqehet madje edhe më shpesh, për t'u njohur me zhvillimet më të fundit nga rajoni, dhe të sigurohet që informacioni i përgjithshëm nga vendi i tyre është i saktë dhe i përditësuar.

6. Të hartojë dhe të dërgojë periodikisht në Sekretariat informacion me interes të përgjithshëm mbi aktivitetet për mbrojtjen e breshkës së detit të zhvilluara në vendin e tyre, për t'u publikuar në faqen e internetit të IOSEA-s, duke përfshirë planet për punën e re dhe detajet mbi takimet e ardhshme me interes.
7. Të komunikojë sa herë të jetë e nevojshme me Pikat e Përfaqësimit Nën-Rajonale përkatëse të IOSEA-s (më e mira, të paktën dy herë në vit), dhe t'u përgjigjet në kohë kërkesave për informacion.
8. Të identifikojë dhe përshkruajë, me sa më shumë hollësi që të jetë e mundur, (në Seksionin 5.4.1 të modelit të raportit kombëtar), burimet që do të kërkohen (përsa i përket burimeve njerëzore, pajisjeve, trainimit, etj.) për të zbatuar më mirë brenda vendit kërkesat e Memorandumit të Mirëkuptimit dhe CMS-së, dhe në veçanti, të përcaktojë aktivitetet e qenësishme që nuk janë zhvilluar për mungesë burimesh.
9. Të kërkojë financim dhe mbështetje brenda buxhetit kombëtar dhe nga burime të tjera brenda vendit për zbatimin e aktiviteteve në lidhje me IOSEA-n, për pjesëmarrjen në mbledhjet përkatëse të IOSEA-s, dhe për kontributet vullnetare ndaj kostove operacionale të IOSEA, për të përmbushur vendimet e Shteteve Nënshkruese.
10. Atje ku është e zbatueshme, merr në konsideratë që të paraqesë një aplikim për të përfituar financim nëpërmjet Mbështetjes Teknike të IOSEA-s dhe Programit të Ngritjes së Kapaciteteve.
11. Të tërheqë vëmendjen dhe të promovojë zbatimin e Memorandumit të Mirëkuptimit të IOSEA-s në forumet kombëtare dhe ndërkombëtare, me qëllimin për të promovuar sinergji dhe për të shmangur përsëritjen e panevojshme të përpjekjeve.

Para Takimit të Shteteve Nënshkruese : Përgatitja

12. Një hap i rëndësishëm në përgatitjen për një Mbledhje të Shteteve Nënshkruese është mbajtja e këshillimeve kombëtare disa muaj përpara mbledhjes. Midis të tjerave, kjo do të lehtësojë analizimin e raportit kombëtar dhe hartimin e çdo rezultati përfundimtar. Zakonisht, Sekretariati bën thirrje paraprake të paktën gjashtë muaj para Mbledhjes së Shteteve Nënshkruese ku kërkon që azhornimet në raportet kombëtare të finalizohen 2-3 muaj përpara Mbledhjes, për t'i dhënë mundësi Sekretariatit që të përgatisë një përmbledhje të plotë të ecurisë së zbatimit.
13. Sekretariati do të qarkullojë një axhendë provizore për Mbledhjen e ardhshme të Shteteve Nënshkruese të paktën tre muaj përpara takimit. Është me rëndësi për Pikën e Përfaqësimit të rishikojë këtë dokument që: (1) të jetë e informuar mbi temat kryesore që do të diskutohen, si dhe për fokusin e çdo takimi tematik; (2) të marrë në konsideratë propozime të çështjeve shtesë të axhendës dhe temave të diskutimit; dhe (3) të ofrojë çdo koment tjetër të përgjithshëm. Delegatët duhet të përgatiten vetë që të diskutojnë aktivitetet kombëtare në këto fusha specifike, si dhe mbi çdo iniciativë ndërkombëtare ose rajonale. Delegatët që parashikohen të bëjnë prezantim në mbledhje do të përmenden në axhendën paraprake.
14. Para mbledhjes, Pikat e Përfaqësimit inkurajohen që të përpilojnë informacion mbi veprimet/nismat e reja të menaxhimit dhe ruajtjes së breshkës së detit që janë zhvilluar në vendin e tyre që prej Mbledhjes së mëparshme të Shteteve Nënshkruese. Ky do të ishte një ushtrim i dobishëm përgatitor për mbledhjet e Grupit Nën-Rajonal të Punës, të mbajtura në mbledhjen e Shteteve Nënshkruese, ku Pikat e Përfaqësimit mund të thirren të parashtrojnë një përditësim të aktivitetit në vendin e tyre.
15. Shtetet Nënshkruese të IOSEA-s kanë vendosur që çdo draft rezolutë duhet të paraqitet në Sekretariat, për një qarkullim më të gjerë (në delegacionet e tjera, Komitetin Këshillimor etj.) të paktën 60 ditë para mbledhjes (shih Raportin e Mbledhjes së Pestë të Shteteve Nënshkruese). Ndonëse projekt rezolutat duhet të paraqiten nëpërmjet një Pike Përfaqësimi, ato mund të përgatiten nga Komiteti Këshillimor ose ndonjë palë tjetër e interesuar. Cdo përjashtim mbi afatin 60 ditor duhet të dakordësohet me konsensus në mbledhjen e Shteteve Nënshkruese. Pikat e Përfaqësimit

duhet të këshillohen sa më shumë të jetë e mundur me partnerë të interesuar mbi përmbajtjet e çdo draft rezolute që ata dëshirojnë të parashtrojnë.

16. Një temë e rëndësishme e diskutimit në mbledhjen e Shteteve Nënshkruese do të jetë sigurimi i financimit dhe mbështetjeve të tjera për punën që do të kryhet në vitin në vazhdim. Pikat e Përfaqësimit nxiten që të kryejnë diskutime të brendshme para mbledhjes së Shteteve Nënshkruese për të kërkuar burime të mundshme financimi që qeveria e tyre ose organizatat e jashtme mund të jenë në gjendje të ofrojnë. Atje ku është e mundur, Pikave të Përfaqësimit u kërkohet që të vijnë të përgatitura në Mbledhjen e Shteteve Nënshkruese për të treguar shumën e burimeve financiare që Qeveria e tyre mund të jetë e aftë për ti siguruar gjatë 1-2 viteve në vazhdim.

Gjatë Takimit: Pjesëmarrja

17. Pikat e Përfaqësimit duhet të rishikojnë çdo rezolutë të propozuar nga Shtetet Nënshkruese dhe të japin informacion siç kërkohet nga delegacione të tjera, Sekretariati ose Komiteti Këshillimor. Ato mund të thirren për të dhënë komente mbi një pyetje proçeduriale, të japin informacion mbi aktivitetet e menaxhimit dhe të ruajtjes kombëtare dhe rajonale, ose të diskutojnë aktivitetet e propozuara dhe perparqësitë për zbatimin e Memorandumit të Mirëkuptimit të IOSEA-s.
18. Gjatë Takimit të Shteteve Nënshkruese, vendet e secilit nga katër nën-rajonet e IOSEA-s do të kenë mundësinë që të diskutojnë midis njëri-tjetrit programet e tyre të tashme mbi ruajtjen, perparësitë, sfidat dhe sukseset; si dhe planet dhe mundësitë e ardhshme për t'u bashkërenduar në nivel nën-rajonal. Cdo nën-rajon do të raportojë sërish në takim si një i tërë.

Pas Takimit: Ndjekja

19. Pikat e Përfaqësimit nxiten të rishikojnë procesverbalin e takimit dhe të bëjnë ndonjë sugjerim (brenda një kuadri kohor që bihet dakord në mbledhje) që korrigjimet apo ndryshimet të reflektohen në dokumentin përfundimtar. Kjo do t'u japë mundësi delegatëve të përqëndrohen mbi atë çfarë u vendos në mbledhje si dhe mbi hapat e tjerë që nevojiten për të çuar përpara objektivat e Memorandumit të Mirëkuptimit të IOSEA-s.
20. Pikat e Përfaqësimit duhet të organizojnë rimbledhjen e komitetit/rrjetit të tyre (sipas rastit) sa më shpejt të jetë e mundur për të përditësuar të gjitha palët mbi vendimet dhe objektivat e IOSEA-s për dy vitet e ardhshme. Kjo duhet të përfshijë diskutimet mes grupeve kombëtare të interesit në lidhje me atë se si ato planifikojnë të zbatojnë bashkarisht në nivel kombëtar kërkesat e Memorandumit të Mirëkuptimit të IOSEA; dhe të kryejnë rregullimet e duhura për masat mbi mbrojtjen e breshkës së detit në të ardhmen në funksion të rezultateve të mbledhjes.
21. Gjithashtu si pjesë e detyrave pas takimit, Pikat e Përfaqësimit duhet të paraqesin çdo dokument të papërfunduar apo të kërkuar nga Sekretariati; dhe duhet t'i japin përparësi maksimale përfundimit të përditësimit të raportit kombëtar, nëse kjo nuk është bërë para mbledhjes.
22. Për të siguruar zbatimin e vazhdueshëm të Memorandumit të Mirëkuptimit, Pikat e Përfaqësimit duhet të marrin përgjegjësi vetjake për fillimin e proçesit të brendshëm të sigurimit të kontributeve financiare ose kontributeve në natyrë në formë vullnetare të përmendura në mbledhjen e Shteteve Nënshkruese. Pikat e Përfaqësimit duhet të informojnë Sekretariatin brenda 45 ditëve nga mbledhja në lidhje me statusin e kontributit financiar vullnetar.
23. Pikat e Përfaqësimit duhet të vazhdojnë të bashkëpunojnë me partnerët nën-rajonalë në periudhat ndërmjet Takimeve periodike të Shteteve Nënshkruese, me synim zbatimin e projekteve dhe aktiviteteve bashkëpunuese për të cilat është rënë dakord gjatë diskutimeve nën-rajonale.
24. Përvec vëmendjes së plotë që u kushtojnë çështjeve të IOSEA-s në rrafshin e brendshëm, Pikat e Përfaqësimit duhet të punojnë me Sekretariatin për të bërë të njohur mbrojtjen e breshkave të detit dhe habitateve të tyre, si dhe punën e IOSEA-s, në forume të tjera përkatëse.

2 Informacion i Përgjithshëm

"Mbrojtja dhe menaxhimi efektiv i specie-ve shtegtare të kafshëve të egra kërkon një veprim të bashkërenduar të të gjithë Shteteve brenda kufijve juridik kombëtarë të të cilave specie të tilla kalojnë një pjesë të ciklit të jetës së tyre"

Parathënie e CMS-së mbi Ruajtjen e Specieve Shtegtare të Kafshëve të Egra.

Ky kapitull jep një pamje të përgjithshme të CMS-së dhe instrumenteve të saj. Temat e mposhtme që janë shtjelluar:

- Arsyetimi për Mbrojtjen e Specieve Shtegtare (Paragrafi 2.1)
- Roli i CMS-së (Paragrafi 2.2)
- Organet e CMS-së dhe Instrumentat e saj (Paragrafi 2.3)
- Financimi i Familjes CMS (Paragrafi 2.4)

2.1 Arsyetimi për Mbrojtjen e Specieve Shtegtare

Speciet shtegtare të kafshëve të egra janë pjesë e trashëgimisë natyrore botërore. Ato formojnë një pjesë të qënësishme të larmisë biologjike dhe burimeve gjenetike të saj dhe luajnë një rol të veçantë si tregues të ndryshimit ekologjik (p.sh. klima dhe ndotja). Veç kësaj, ato sigurojnë shërbime të shumta ekosistemi për shembull përmes shpërndarjes së farave dhe pllenimit të bimëve. Ato janë një burim ushqimi për njerëzit dhe kafshët e tjera. Shumë prej tyre kanë rëndësi kulturore dhe shpirtërore dhe janë elemente kyç të ekoturizmit.

Sidoqoftë, aktivitetet njerëzore kërcënojnë shumë specie, dhe përpjekjet për ruajtjen e specieve shtegtare janë më të vështira sepse nga vetë natyra e tyre si kafshë shtegtare, sjellja e tyre nënkupton se ato janë vazhdimisht në lëvizje {→ shih Kutinë e Informacionit 2.1 dhe Figuren 2.1}. Ato varen nga një sërë habitatesh shpesh herë të brishta. Rreziqet përfshijnë pengesat përgjatë shtegtimit të tyre (digat, linjat e energjisë elektrike, impiantet e mullinjve të erës, gardhet, rrugët, hekurudhat); humbjen dhe degradimin e habitatit; kapjet nga grepat; zhurmat nënujore; speciet aliene invazive; sëmundjet e botës shtazore; gjuetinë dhe peshkimin e paligjshëm; ndotjen; mbeturinat e ngurta detare; helmimet; shkretimin dhe ndryshimin e klimës. Si rezultat, shumë specie shtegtare dikur shumë të përhapura tashmë po rrallohen gjithnjë e më shumë. Ka një nevojë në rritje për të njohur lidhjet midis specieve dhe habitateve të tyre, dhe në veçanti, për të mbrojtur shumimin, dimërimin dhe vendqëndrimet dhe korridoret e shtegtimit. Përderisa speciet shtegtare nuk i kushtojnë vëmendje kufijve juridikë, atëherë ruajtja efektive varet nga bashkëpunimi midis vendeve të ndryshme.

KUTI INFORMACIONI 2.1

Çfarë është Shtegtimi?

Shtegtimi është një fenomen natyror në të cilin individë nga specie të caktuara lëvizin midis vendeve. Kjo mund të ndodhë në kohë të ndryshme të vitit, në faza të ndryshme të jetës së tyre, ose në kërkim të kushteve të përshtatshme për rritje dhe për të mbajtur të vegjlit dhe në disa raste përfshin distanca shumë të gjata.

Neni 1 i CMS-së përkufizon me termin "specie shtegtare" të "gjithë popullatën ose cfarëdo pjese të ndarë gjeografikisht të popullatës së një specieje apo taksoni më të ulët të kafshëve të egra, ku një numër i madh i anëtarëve të të cilëve në mënyrë ciklike dhe të parashikueshme kalojnë një ose më shumë kufij të juridiksionit kombëtar."

Përkufizimi i CMS-së, megjithëse jo plotësisht biologjik, shpjegon në njëfarë mase aspektet e sjelljes së shtegtimit dhe jep mundësi që ta dallojë atë nga format e tjera të lëvizjeve si kërkimi i ushqimit dhe shpërhapja. Kuptimi politik është përshtatur me qëllimet e CMS-së dhe instrumentat e saj që identifikojnë dhe promovojnë zbatimin e masave dhe mjeteve të përbashkëta të ruajtjes së specieve të Shteteve Kufitare. Ajo nënkupton përjashtimin e shtegtarëve, që lëvizin brenda territorit të një shteti, por lejon përfshirjen e shtegtarëve teknikë të tillë si disa specie të lakuriqve të natës dhe specie si Gorillat që jetojnë në zona kufitare.



Figura 2.1 Shtegtimi i Balenës me Gungë
Burimi: Living Planet - Connected Planet, fq. 49

2.2 Roli i CMS-së

CMS-ja, e cila hyri në fuqi në 1983, është e vetmja organizatë globale ndërqeveritare e Kombeve të Bashkuara e ngritur ekskluzivisht për mbrojtjen dhe menaxhimin e specieve shtegtare të tokës, ujit, dhe ajrit, për të gjithë zonën e përhapjes së tyre.

Konventat e tjera globale, si Konventa mbi Larminë Biologjike (CBD), Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Detit (UNCLOS) dhe zbatimi i saj përmes Marrëveshjes mbi Kuotat e Peshkut (FSA), Konventa Ramsar mbi Ligatinat me Rëndësi Ndërkombëtare veçanërisht si Habitate të Shpendëve Ujorë, Konventa mbi Tregtinë Ndërkombëtare të Specieve të Rrezikuara të Florës dhe Faunës së Egër, (CITES) ose Konventa e Trashëgimisë Botërore ndajnë me CMS-në disa objektiva të përbashkëta. Sidoqoftë, këto konventa nuk sigurojnë instrumentat e veçantë të nevojshëm për mbrojtjen e specieve shtegtare. CMS-ja, në kontrast, e adreson faktin që speciet shtegtare i kalojnë kufijtë juridiksionalë. Ajo e bën këtë nëpërmjet forumit të vendeve që në kushte të tjera do të kishin një nivel të ndryshëm mbrojtjeje të mblidhen së bashku për të rënë dakord mbi përparësitë dhe masat e përbashkëta të mbrojtjes.

Më tej, CMS-ja është një konventë kuadër nën të cilën një sërë masash, të përshtatura me nevojat e vecanta të Shteteve Shtrirëse, mund të zhvillohen për një specie të vetme ose një grup speciesh të ngjashme dhe të kalohet nga një marrëveshje bilaterale në një përpjekje me shtrirje gjeografike rajonale ose globale.

Këto masa variojnë nga traktate formale – Marrëveshje ligjërisht të detyrueshme – në instrumente jo-ligjërisht të detyrueshme (Memorandum Mirëkuptimi) tek veprimet e bashkërenduara {→ shih Tabelën 2.1}.

CMS-ja dhe instrumentat e saj përcaktojnë politikën dhe sigurojnë orientim të mëtejshëm mbi çështje të vecanta nëpërmjet Planeve të tyre Strategjike, Planeve të Veprimit, rezolutave, vendimeve dhe udhëzimeve. Të gjithë mbajnë në faqet e internetit të tyre një listë me të gjitha vendimet e marra, botimet e udhëzimeve dhe Planet e Veprimit të miratuara nga Shtetet Anëtare.

Si përmbledhje, CMS-ja siguron:

- Një forum të specializuar, gjithëpërfshirës të ekspertëve mbi speciet shtegtare ndërkufitare;
- Instrumenta global dhe rajonal dhe masa të tjera të porositura dhe të përshtatura me nevojat e klasës taksonomike;
- Mbështetje për zbatim të integruar të mbrojtjes së biodiversitetit;
- Mbështetje për projekte të kërkimit, mbrojtjes dhe ngritjes së kapaciteteve;

2.2.1 Speciet e Mbuluara

Familja CMS mbulon një larmi të gjerë të specieve shtegtare. Shtojcat e CMS-së përfshijnë shumë gjitarë, përfshirë gjitarët e tokës, gjitarët detarë dhe lakuriqët e natës; shpendët; peshqit; zvarranikët dhe një insekt. Ndërmjet instrumentave, Memorandumi për Mbrojtjen e Shpendëve Shtegtarë Afrikano-Euroaziatike (AEWA) mbulon 255 specie shpendësh që kanë një varësi ekologjike ndaj ligatinave, për të paktën një pjesë të ciklit të tyre vjetor. Memorandumi për Mbrojtjen e Popullatave të Lakuriqëve të Natës në Evropë (EUROBATS) mbulon 52 specie të lakuriqëve të natës, Memorandumi i Mirëkuptimit mbi Peshkaqenët mbulon shtatë specie të peshkaqenëve dhe Memorandumi për Mbrojtjen e Breshkës së Detit në Oqeanin Indian dhe Azinë Jug-Lindore (IOSEA) mbulon gjashtë specie të breshkave të detit.*

Nën CMS-në, ato specie në rrezik zhdukjeje janë radhitur në Shtojcën I, me dispozitat përkatëse të përcaktuara në Nenin III, paragrafët 4 dhe 5 {→ shih Kutinë e Informacionit 2.2}. Palët që janë Shtete Kufitare të Zonës së specieve të Shtojcës I janë të detyruara t'u sigurojnë atyre mbrojtje strikte.

* Korrekte në kohën e redaktimit (10 Qershor 2013)

KUTI INFORMACIONI 2.2

Neni III paragrafët 4 dhe 5 të Konventës:

4. Palët që janë Shtete Shtrirëse të specieve shtegtare të renditura në Shtojcën I duhet të përpiqen:
   a) të mbrojnë dhe, atje ku është e mundur dhe nevojshme, të rehabilitojnë ato habitate speciesh që janë të rëndësishme për shpëtimin e species nga rreziku i zhdukjes;
   b) të parandalojnë, të mënjanojnë, të kompensojnë, ose të minimizojnë, siç duhet, efektet negative të aktiviteteve ose pengesat që dëmtojnë seriozisht ose ndalojnë shtegtimin e specieve; dhe
   c) në një masë të mundshme dhe të përshtatshme, të parandalojnë, zvogëlojnë, ose kontrollojnë faktorët që po rrezikojnë ose mund të rrezikojnë më tej speciet, përfshirë kontrollin strikt të hyrjes, ose kontrollin apo eleminimin e specieve ekzotike tashmë të introduktuara.

5. Palët që janë Shtete Shtrirëse të specieve shtegtare të renditura në Shtojcën I duhet të ndalojnë kapjen e kafshëve që u përkasin specieve të tilla. Në këtë mund të bëhen përjashtime vetëm nëse:
   a) kapja bëhet për qëllime shkencore;
   b) kapja bëhet për qëllim të rritjes së shumimit ose të mbijetesës së specieve të prekura;
   c) kapja bëhet për të plotësuar nevojat e përdoruesve tradicionalë që ushqehen me specie të tilla; ose
   d) e kërkojnë rrethanat e jashtëzakonshme; duke patur parasysh që përjashtime të tilla janë të sakta në përmbajtje dhe të kufizuara në kohë dhe hapësirë. Kapje të tilla nuk duhet të ndërmerren në përkeqësim të specieve.

Specie të tjera shtegtare që kanë nevojë ose që përfitojnë në mënyrë domethënëse nga bashkëpunimi ndërkombëtar janë renditur në Shtojcën II. Këto specie, ose individualisht ose në grup taksonomik (të klasës), janë baza për përcaktimin e instrumentave – rajonalë ose global – nën CMS-në.

Konferenca e Palëve (KP) e CMS-së mund të vendosë të shtojë (ose të heqë) një specie nga Shtojcat duke u mbështetur në evidenca shkencore të besueshme. Çdo palë mund t'i bëjë KP-së një propozim të tillë, i cili miratohet nëse mbështetet nga 2/3 e Palëve të pranishme dhe votuese. Ndryshimi hyn në fuqi pas 90 ditëve, vetëm në rast kur një Palë njofton Depozituesin se dëshiron të përfshijë një ankese. AEWA ka një klauzolë të ngjashme, ashtu si EUROBATS (megjithëse ndryshimet hyjnë në fuqi pas 60 ditëve në vend të 90 ditëve).

Marrëveshja mbi Gorrillat mbulon të gjitha speciet dhe nën-speciet e gjinisë *Gorilla* – taksonomia e sotme njeh dy specie (*Gorilla gorilla* and *Gorilla beringei*) secila prej të dyjave kanë dy nën-specie. Neni 1.2 (a) i ASCOBANS përkufizon "cetace të vegjël" çdo specie, nën-specie ose popullatë të balenave me dhëmbë Odonticeti, përveç Balenës kokëmadhe me dhëmbë *Physeter macrocephalus*.

2.2.2 Anëtarësia e CMS-së dhe Instrumentat e saj

Përveç 119 Palëve aktuale të CMS (referuar Shtator 2013), 33 vende shtesë janë Shtete Anëtare në instrumenta, ndërsa shumë nga 119 janë gjithashtu* Palë dhe Nënshkrues të Marëveshjeve dhe Memorandumeve të Mirëkuptimit (p.sh. Franca është Palë në pesë nga të shtatë Marrëveshjet dhe Nënshkruese në pesë Memorandume Mirëkuptimi dhe Senegali është Palë në një Marrëveshje dhe Nënshkruese në gjashtë Memorandume). Në shumë raste, anëtarësimi në një prej këtyre instrumentave ka qenë një hap i parë për t'iu bashkuar Konventës mëmë.

*Këto shifra ishin korrekte referuar 10 Qershorit 2013. Shifrat më të fundit mund të gjenden në http:www.cms.int/about/part_lst.htm

Table 2.1 Lista e Instrumenteve të Familjes CMS

Konventa Mëmë

	CMS Konventa mbi Mbrojtjen e Specieve Shtegtare të Kafshëve të Egra (Instrument për shumë specieve)	CMS

Marrëveshjet

	ACAP Marrëveshja mbi Ruajtjen e Albatrosëve dhe Zgalemëve (Instrument për shumë specie)	Agreement on the Conservation of Albatrosses and Petrels
	ACCOBAMS Marrëveshja mbi Ruajtjen e Gjitarëve detarë në Detin e Zi, Detin Mesdhe dhe Zonën e Afërt të Atlantikut (Instrument për shumë specie)	ACCOBAMS
	AEWA Marrëveshja mbi Mbrojtjen e Shpendëve Ujorë Shtegtarë Afrikano-Euroaziatike (Instrument për shumë specie)	UNEP AEWA
	ASCOBANS Marrëveshja mbi Mbrojtjen e Gjitarëve të Vegjël të Detit në Detin Balltik, në Detin e Irlandës dhe të Veriut, dhe atë të Atlantikut Verilindor (Instrument për shumë specie)	ASCOBANS
	EUROBATS Marrëveshja mbi Mbrojtjen e Popullatave të Lakuriqëve të Natës në Europë (Instrument për shumë specie)	EUROBATS
	GORILLAT Marrëveshja mbi Mbrojtjen e Gorillave dhe Habitateve të tyre (Instrument për shumë specie)	ACCORD CMS GORILLA CMS GORILLA AGREEMENT
	FOKAT E DETIT WADDEN Marrëveshja mbi Mbrojtjen e Fokave të Detit Wadden (Instrument për një specie)	Common Wadden Sea Secretariat

Tabela 2.1 Lista e Instrumentave të Familjes CMS (vazhd.)

Memorandum Mirëkuptimi (MOU)

	Bilbilthi i kënetave Memorandumi I Mirëkuptimit në lidhje me Masat e Mbrojtjes së Bilbilthit të kenetave (Instrument për një specie)
	Dreri Bukhara Memorandumi i Mirëkuptimit në lidhje me Mbrojtjen dhe Rikthimin e Drerit Bukhara (Instrument për një specie)
	Gjitarët Detarë në Rajonin e Ishujve të Paqësorit Memorandumi i Mirëkuptimit mbi Mbrojtjen e Gjitarëve Detarë dhe Habitateve të tyre në Rajonin e Ishujve të Paqësorit (Instrument për shumë specie)
	Gjitarët Detarë me Bisht Piruni (dugong) Memorandumi i Mirëkuptimit mbi Mbrojtjen dhe Menaxhimin e Gjitarëve Detarë Bishtpiruni (*Dugong dugon*) dhe Habitateve të tyre përgjatë gjithë Shpërndarjes së tyre (Instrument për një specie)
	Shpendët e Kullotave të Amerikës Jugore Memorandumi i Mirëkuptimit mbi Mbrojtjen e Specieve të Shpendëve Shtegtarë të Kullotave të Amerikës Jugore dhe habitateve të tyre (Instrument për shumë specie)
	Pula me mjekër e Europës Qendrore Memorandumi i Mirëkuptimit mbi Mbrojtjen dhe Menaxhimin e Popullatës së Pulës me mjekër (*Otis tarda*) (Instrument për një specie)
	Flamingot e Andeve të Larta Memorandumi i Mirëkuptimit mbi Mbrojtjen e Flamingove të Andeve të Larta dhe Habitateve të tyre (Instrument për shumë specie)

Tabela 2.1 Lista e Instrumentave të Familjes CMS (vazhd.)

	Breshkat e Detit të Bregut Afrikan në Atlantik Memorandumi i Mirëkuptimit në lidhje me Masat e Mbrojtjes së Breshkave të Detit në Bregun Afrikan në Atlantik (Instrument për shumë specie)a)
	Breshkat e Detit në Oqeanit Indian dhe Azisë-Juglindore (IOSEA) Memorandumi i Mirëkuptimit mbi Mbrojtjen dhe Menaxhimin e Breshkave të Detit në Oqeanin Indian dhe Azinë Juglindore dhe habitateve të tyre (Instrument për shumë specie)
	Fokat Mesdhetare Memorandumi i Mirëkuptimit në lidhje me Masat e Mbrojtjes së Popullatave të Fokave Mesdhetare të Atlantikut LIndor (Instrument për një specie)
	Shpendët Rrëmbenjës Memorandumi i Mirëkuptimit në lidhje me Mbrojtjen e Shpendëve Shtegtarë Rrëmbenjës në Afrikë dhe Euro-Azi (Instrument për shumë specie)
	Pata kokëkuqe Memorandumi i MIrëkuptimit ndërmjet Republikës së Argjentinës dhe Republikës së Kilit mbi Mbrojtjen e Patës Kokëkuqe (Instrument për një specie)
	Antilopa Saiga Memorandumi i Mirëkuptimit në lidhje me Mbrojtjen , Rikthimin dhe Përdorimin e Qëndrueshëm të Antilopës Saiga (instrumenti i specieve të vetme)
	Peshkaqenët Memorandumi i Mirëkuptimit mbi Mbrojtjen e Peshkaqenëve Shtegtarë (Instrument për shumë specie)
	Krilla siberian Memorandumi i Mirëkuptimit në lidhje me Masat e Mbrojtjes së Krillës Siberiane (Instrument për një specie)

Tabela 2.1 Lista e Instrumentave të Familjes CMS (vazhd.)	
	Kojliku sqephollë Memorandumi Mirëkuptimit mbi Masat e Mbrojtjes së Pëllumbit me gugatje të hollë (Instrument për një specie)
	Huemul-i i Andeve Jugore Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Republikës së Argjentinës dhe Republikës së Kilit mbi Mbrojtjen e Huemul-it të Andeve Jugore (Instrument për një specie)
	Gjitarët e Ujit të Afrikës Perëndimore Memorandumi i Mirëkuptimit mbi Mbrojtjen e Lopëve të ujit dhe Cetacea të vegjël të Afrikës Perëndimore dhe Makaronezisë (Instrument për një specie)
	Elefantët e Afrikës Perëndimore Memorandumi i Mirëkuptimit në lidhje me Masat e Mbrojtjes për Popullatat e Elefantit Afrikan të Afrikës Perëndimore (për një specie)

Më tepër informacion dhe link-e për instrumentat e Familjes CMS do t'i gjeni në adresën: **http://www.cms.int/species/index.htm** (përfshirë p.sh. lidhjet elektronike tekste e marrëveshjes, informacion mbi mbledhjet, planet e ruajtjes, etj.)

2.3 Organet e CMS dhe Instrumentat e saj

Brenda instrumentit të familjes CMS, funksionet janë përgjithësisht të ndara midis disa trupa. Këto trupa mund të klasifikohen përgjithësisht në: (1) Sekretariate ose Njësi Koordinuese (administrative); (2) organe vendim-marrëse (KP/TP/TSHN) dhe organe vartëse (zakonisht të quajtura Komiteti i Përhershëm) të cilat ofrojnë udhëzime gjatë periudhës ndërmjet takimeve të organeve vendim-marrëse dhe (3) këshillat shkencorë dhe teknikë (p.sh. Këshilli Shkencor) {→ shih Tabelen 2.2}.

Tabela 2.2 Pasqyra e Organeve Vartëse të përcaktuara nga CMS-ja dhe Instrumentat e saj

		Trupa Vendim-marrëse	Organe Vartëse		Sekretariati/Njësia Koordinuese, Vendndodhja
			Shkencor dhe Teknik	Administrimi e Politika	
KONVENTA	CMS	Konference e Palëve (KP)	Këshilli Shkencor	Komiteti në Fuqi	Sekretariati, Bon, Gjermani
MARRËVESHJE	ACAP	Takimi i Palëve (TP)	Komiteti Këshillimor	n.a.	Sekretariati, Hobart, Australi
	ACCOBAMS	TP	Komiteti Shkencor	n.a.	Sekretariati, Monako
	AEWA	TP	Komiteti Teknik	Komiteti i Përhershëm	Sekretariati, Bon, Gjermani
	ASCOBANS	TP	Komiteti Këshillimor		Sekretariati i Përbashkët (CMS) Bon, Germany
	EUROBATS	TP	Komiteti Këshillimor	Komiteti i Përhershëm	Sekretariati, Bon, Gjermani
	GORILLAT	TP	Komiteti Teknik	n.a.	Sekretariati CMS, Bon, Gjermani
	FOKAT E DETIT WADDEN	Bordi Tripalësh+	Komiteti Teknik	n.a.	Sekretariati, Wilhelmshaven, Gjermani
MIREKUPTIMI (MOUs)	Bilbilthi i kënetave	Takimi i Shteteve Nënshkruese (TSHN)	n.a.	n.a.	Sekretariati CMS, Bon, Gjermani
	Dreri Bukhara	TSHN	n.a.	n.a.	Sekretariati CMS, Bon, Gjermani
	Cetacet në Rajonin Ishullor në Paqësor	TSHN	n.a.	n.a.	Sekretariati CMS, Bon, Gjermani
	Dugongët	TSHN	Komiteti Këshillimor	n.a.	Sekretariati CMS, Njësia Koordinuese Abu Dhabi, Emiratet e Bashkuara Arabe
	Shpendët e Kullotave të Amerikës së Jugut	TSHN	n.a.	n.a.	Sekretariati CMS, Bon, Gjermani
	Pula me mjekër e Europës Qendrore	TSHN	n.a.	n.a.	Sekretariati CMS, Bon, Gjermani
	Flamingot e Andeve të Larta	TSHN	n.a.	n.a.	Sekretariati CMS, Bon, Gjermani
	Breshkat e Ujit te Bregut Afrikan në Atlantik	TSHN	Komiteti Këshillimor	n.a.	Sekretariati CMS, Bon, Gjermani
	Breshkat e Ujit IOSEA	TSHN	Komiteti Këshillimor	n.a.	Sekretariati CMS, Njësia Koordinuese, Bankok, Tajlandë
	Fokat Mesdhterare*	TSHN	n.a.	n.a.	Sekretariati CMS, Bon, Gjermani
	Shpendët Rrëmbenjës	TSHN	Grup Këshillimor Teknik	n.a.	Sekretariati CMS, Njësia Koordinuese Abu Dhabi, Emiratet e Bashkuara Arabe
MEMORANDUM	Pata kokëkuqe**	TSHN	n.a.	n.a.	Sekretariati CMS, Bon, Gjermani
	Antilopa Saiga	TSHN	n.a.	n.a.	Sekretariati CMS, Bon, Gjermani
	Peshkaqenët	TSHN	Komiteti Këshillimor	n.a.	Sekretariati Provizor (CMS) Bon, Gjermani
	Krilla Siberiane	TSHN	n.a.	n.a.	Sekretariati CMS, Bon, Gjermani
	Kojliku sqephollë	TSHN	n.a.	n.a.	Sekretariati CMS, Bon, Gjermani
	Huemulet e Andeve Jugore**	TSHN	n.a.	n.a.	Sekretariati CMS, Bon, Gjermani
	Gjitarëet e Ujit të Afrikës perëndimore	TSHN	n.a.	n.a.	Sekretariati CMS, Bon, Gjermani
	Elefantet e Afrikes Perëndimore	TSHN	n.a.	n.a.	Sekretariati CMS, Bon, Gjermani

\+ me përfaqësuesit e Danimarkës, Gjermanisë dhe Hollandës
* Sipas tekstit të MOU-t te Sekretariatit CMS siguron sherbimet administrative por koordinimi kryhet nepermjet Qeverisë Spanjolle
** Sekretariati CMS shërben si Depozitues për ato MIRËKUPTIME që arrihen si pjesë e "Protokollit Special Shtesë në Ruajtjen e Florës dhe Faunës së Egër e ndare midis Republikes se Argjentinës dhe Republikes së Kilit"

Burim: http://www.cms.int/publications/pdf/album/inside_english.pdf

2.3.1 Organet Vendim-marrëse

Organi vendim-marrës kryesor për Konventën është Konferenca e Palëve (KP) e cila mblidhet çdo tre vjet. Për pjesën më të madhe të Marrëveshjeve ligjërisht të detyrueshme, në vend të KP-së, mbahet Takimi i Palëve ose TP-ja (përjashtim bën Marrëveshja për Fokat e Detit Wadden-it, e cila mbikqyret nga Bordi i Detit Wadden-it i përbërë nga përfaqësues të shteteve të Danimarkës, Gjermanisë dhe Hollandës); MP-ja mbahet çdo tre apo katër vjet, në varësi të rregullave të çdo Marrëveshjeje të arritur nga Palët. Memorandumet e Mirëkuptimit përmbajnë Mbledhjet e Palëve Nënshkruese (MPN). {→ për më shumë informacion rreth takimeve, shih Kapitullin 4 }

Organet e ndryshme vendim-marrëse të instrumentave të Familjes CMS vlerësojnë progresin e bërë dhe sfidat e hasura gjatë zbatimit, dhe vendosin prioritetet për periudhën e ndërmjetme para sesionit të radhës. Atje ku është e mundur, vlerësojnë gjithashtu edhe financimin e instrumentave dhe përcaktojnë buxhetin.

Rolet dhe funksionet e KP-së të CMS janë të përcaktuara në nenin VII të CMS-së, teksti i të cilit është riprodhuar si {→ Aneksi 2.1} në këtë kapitull. Qëllimi kryesor i KP-së është të vlerësojë dhe të bjerë dakord mbi amendamentet e Shtojcave dhe të miratojë rezolutat. Përveç kësaj KP-ja vendos dhe rishikon rregulloret financiare të CMS-së, miraton buxhetin për tre vitet pasardhëse dhe vlerëson zbatimin e CMS-së. Në veçanti, KP-ja mund të rishikojë dhe vlerësojë statusin e mbrojtjes së specieve shtegtare dhe progresin e arritur drejt ruajtjes së tyre.

Konferenca e Palëve drejtohet nga një Kryetar, zakonisht përfaqësues i Qeverisë Pritëse dhe mbikqyret nga një Byro e përbërë nga zyrtarë të zgjedhur në mbledhje, Kryetari i Komisionit të Përhershëm dhe i Këshillit Shkencor, dhe mbështetet nga Sekretariati. Vendimet – siç është zgjedhja e zyrtarëve, miratimi i axhendës dhe Rregullat Proçeduriale, ngritja e Komiteteve dhe Grupeve të Punës, dhe në fund të Konferencës së Palëve, miratimi i rezolutave bëhet në Seancë Plenare, në atë pjesë të mbledhjes ku marrin pjesë të gjithë delegatët. Diskutimi i detajuar i veprimtarive të përgjithshme të KP-së drejtohet nga Komiteti i Përgjithshëm; disa veprimtari të specializuara si buxheti i referohen një Komiteti të veçantë ose një Grupi Pune. Komitetet dhe Grupet e Punës që mblidhen vetëm gjatë ecurisë së një mbledhjeje të një institucioni vendim-marrës quhen “Grupe Pune përgjatë Sesioneve”; ato që vazhdojne pas mbylljes së mbledhjes quhen “Grupe Pune ndërmjet Sesioneve”. Ato raportojnë gjetjet e tyre dhe i japin rekomandimet e tyre menjëherë ose në mbledhjen e rradhës të organit në varësi të trupit vendim-marrës.

Mbledhjet e trupave vendim-marrëse ndjekin pak a shumë të njëjtat veçori si ato të CMS-së, por kanë prirjen të jenë shumë më të vogla në shkallë, duke reflektuar numër më të vogël të instrumentave në krahasim me Konventën mëmë.

2.3.2 Organet Vartëse

2.3.2.1 Organe që ofrojnë Politika Kalimtare dhe Udhëzime Administrative

Këto organe, që në shumicën e rasteve quhen Komiteti i Përhershëm, japin udhëzime administrative dhe politike ndërmjet takimeve të zakonshme të institucioneve vendim-marrëse, dhe sigurohen që vendimet e tyre janë zbatuar. Ndërsa Këshilli Shkencor i CMS-së (shih më poshtë) është përcaktuar brenda tekstit të Konventës, Komiteti i Përhershëm u formua nga Konferenca e Palëve (fillimisht përmes Rezolutës 1.1 në vitin 1984 ndërsa tani bazohet në Rezolutën 9.15 të vitit 2008). Organe vartëse të ngjashme ekzistojnë brenda disa instrumentave të tjera të Familjes CMS, në mënyrë të vecantë AEWA, Komiteti i Përhershëm i së cilës u krijua përmes miratimit të Rezolutës 2.6 dhe EUROBATS me miratimin e Rezolutës 5.8.

Në rastin e ASCOBANS, organi vartës, që quhet Komiteti Këshillimor, ka një funksion të dyfishtë jo vetëm në dhënien e shërbimeve këshilluese teknike por gjithashtu edhe në udhëzimet administrative dhe politikbërëse. Këto organe formohen ose nga përfaqësues rajonalë të zgjedhur nga organet vendim-marrëse dhe nga përfaqësues të tjerë si qeveria pritëse, ose nga një përfaqësues nga çdo Palë në rastin e Marrëveshjeve më të vogla. Përbërja e këtyre institucioneve jepet me poshtë {→ shih Tabelën 2.2 dhe Tabelën 2.3}. Në rastet kur organi vartës përbëhet nga përfaqësues rajonale të zgjedhur, çdo Shtet Anëtar tjetër mund të marrë pjesë normalisht si vëzhgues pa të drejtë vote.

Mandati i tyre konsiston në:
- monitorimin e buxhetit
- dhënien e rekomandimeve për t'u trajtuar në mbledhjet e ardhshme të organeve vendim-marrëse
- dhënien e këshillave dhe udhëzimeve për Sekretariatet/Njësitë Koordinuese
- përfaqësimin e organeve vendim-marrëse në negociatat me Qeveritë Pritëse dhe UNEP-in në lidhje me Sekretariatet/Njësitë Koordinuese.

Kur e konsiderojnë të përshtatshme, organet vendim-marrëse mund të caktojnë dhe detyra të tjera shtesë për organet vartëse.

2.3.2.2 Organet Këshillimore Shkencore dhe Teknike

Këto organe u japin këshilla organeve vendim-marrëse dhe Sekretariateve/Njësive koordinuese për çështje shkencore dhe prioritetet për punë kërkimore dhe mbrojtje si dhe sigurojnë që i gjithë informacioni i paraqitur nëpërmjet propozimeve, rekomandimeve, etj., të jetë shkencërisht i saktë. Në përgjithësi, ata promovojnë ndërveprimin mes shkencës dhe politikave.

Këshilli Shkencor i CMS-së përbëhet nga anëtarë (të njohur si Këshilltarë Shkencorë) të emëruar nga Palët e Familjes CMS. Sidoqoftë, ata nuk përfaqësojnë pikëpamjet e qeverive të tyre, dhe kontribuojnë si eksperte në punën e instrumentave. Po ashtu, KP-ja emëron një numër të kufizuar Këshilltarësh të kualifikuar në fushat me interes të veçantë si flora dhe fauna. (Neni VIII, paragrafi 2 i CMS-së). {→ shih Kutinë e Informacionit 2.3}

KUTI INFORMACIONI 2.3

KP - Anëtarët e emëruar të Këshillit Shkencor të CMS-së

Pas KP-së 10 (Bergen, 2011) ekzistojnë nëntë Këshilltarë të tillë me përgjegjësi të veçantë për:
peshqit, shpendët, breshkat e detit, gjitarët e ujit, faunën Aziatike, faunën neo-tropikale, faunën Afrikane, ndryshimin klimatik dhe kapjen e specieve.

Disa prej Marrëveshjeve dhe Memorandume Mirëkuptimi kanë themeluar gjithashtu Organe Këshillimore apo Komitete Teknikete {→ shih Tabelën 3.1 në Paragrafin 3.1.2}. Siqodoftë, përbërja e organeve ndryshon në një shkallë të gjerë. {Për informacion të mëtejshëm rreth Komiteteve në Marrëveshjet dhe Memorandume Mirëkuptimi shih gjithashtu Tabelën 2.2.}

2.3.2.3 Grupet e Punës

Grupet e Punës përcaktohen si rregull në mënyrë formale ose jo formale në kuadër të organeve (vendim-marrëse dhe vartëse) të çdo instrumenti. Disa nga këto grupe pune funksionojnë vetëm gjatë kohës së takimit të këtyre organeve ndërsa të tjerat kanë mandat të funksionojnë gjatë periudhave ndërmjet sesioneve për të ofruar këshilla ose rekomandime, {→ shih Paragrafin 4.2.5}. Në varësi të natyrës së mandatit, Grupet e Punës mund të përbëhen nga përfaqësues të Shteteve Anëtare ose nga ekspertë shkencorë brenda ose jashtë organeve teknike të këtyre instrumentave.

Komiteti i Përhershëm i CMS-së, për shembull, ka pasur një Grup Pune Ndërsesional mbi Strukturën e Ardhshme dhe aktualisht ka një Nën-Komitet mbi çështjet Financiare dhe Buxhetore ndërsa Këshilli Shkencor i CMS-së, për shembull përfshin Grupet e Punës rreth Autostradave/Korridoreve Ajrore Globale. Një numër akoma më i madh Grupesh Pune rreth çështjeve dhe specieve të ndryshme janë ngritur përmes Marrëveshjesh dhe Memorandumeve të Mirëkuptimit.

2.3.3 Sekretariatet dhe Njësitë Koordinuese

Sekretariatet dhe Njësitë Koordinuese ofrojnë mbështetje administrative për instrumentat e tyre. Si rregull organi vendim-marrës i instrumentit përcakton buxhetin që i caktohet Sekretariatit/Njësisë Koordinuese, përfshirë numrin e posteve dhe funksioneve. Atje ku Memorandumet e Mirëkuptimit kanë parashikuar Njësi Koordinuese, zakonisht ato financohen përmes kontributeve vullnetare.

Sekretariati i CMS-së ofron funksione sekretariati për ASCOBANS, Marrëveshjen mbi Gorillat dhe për ato Memorandume Mirëkuptimi që nuk kanë të parashikuara Njësi Koordinuese. Sekretariatet e CMS-së dhe një numër i instrumentave të tjerë të administruara nga UNEP-i janë në godina të përbashkëta në Bonn, disa të tjera administrohen nga UNEP-i por ndodhen në vende të tjera (Memorandumi mbi Shpendët Grabitqarë dhe ai i Dugongëve kanë një Njësi Koordinuese të mirëpritur nga Agjensisë Mjedisore Abu Dhabi në Emiratet e Bashkuara Arabe, dhe Memorandumi Mirëkuptimit IOSEA mbi Breshkat e Detit e vendosur në Zyrën Rajonale UNEP në Bangkok, Tajlandë). ACAP, ACCOBAMS dhe Marrëveshja mbi Fokat e Detit Wadden nuk administrohen nga UNEP-i, dhe sekretariatet e tyre ndodhen respektivisht në Hobart (Australi), Monako dhe Wilhelmshaven (Gjermani){→ shih Tabelen 2.2}.

2.4 Financimi i Familjes CMS

2.4.1 Kontributet e Vlerësuara

Secilës palë që ka detyrime ligjore karshi një instrumenti (CMS dhe Marrëveshjet), i kërkohet të kontribuojë financiarisht në buxhetin e miratuar nga organi vendim-marrës. {→ shih Këshilla të Vlefshme 3.1 dhe Paragrafin 3.3}.

2.4.1.1 CMS

Palët kontribuojnë në buxhet në përputhje me shkallën e vlerësimit të Kombeve të Bashkuara (KB) të aprovuar nga Asambleja e Përgjithshme e KB, e përshtatur për të vlerësuar anëtarësinë e CMS-së. Shkalla e Vlerësimit e KB i cakton çdo shteti pjesën që duhet të kontribuojë në buxhetin e KB; Shkalla përshtatet në rastin e CMS-së për të marrë në konsideratë faktin që jo të gjitha shtetet i janë bashkuar Konventës.

2.4.1.2 Marrëveshjet

Disa marrëveshje përdorin gjithashtu shkallën e vlerësimit të KB si model ndërsa të tjera zhvillojnë udhëzimet dhe metodat e tyre për të përcaktuar kontributin e çdo Pale. Këto skema ndonjëherë vendosin një minimum kontributi ose një sasi të caktuar që duhet të plotësohet nga të gjitha palët, ndërsa të tjerat zhvillojnë formulat e tyre. Qasjet e ndryshme rreth financimit të Marrëveshjeve të CMS-së jepen në {→ Tabelën 2.3}.

2.4.2 Kontributet Vullnetare

2.4.2.1 CMS dhe Marrëveshjet

Në rastin e CMS-së dhe Marrëveshjeve ligjërisht të detyrueshme, kontributet vullnetare plotësojnë si rregull ato të përcaktuara dhe kërkohen nga Sekretariatet për financimin e projekteve dhe nismave të tjera që nuk mbulohen nga buxheti standart {→ shih Paragrafin Section 3.3 dhe Kapitullin 5}.

2.4.2.2 Memorandume e Mirëkuptimit

Financimi i Memorandumeve normalisht merr formën e kontributeve vullnetare të posaçme nga Shtetet Nënshkruese si dhe nga vendet e tjera të interesuara.

Megjithatë, varësia nga kontribute vullnetare të posaçme (ad hoc) të cilat nuk sigurojnë vazhdimësi apo parashikueshmëri të financimit e bën të vështirë zbatimin e projekteve afatgjata apo punësimin e stafit. Shumica e Memorandumeve të Mirëkuptimit funksionojnë duke përdorur një kombinim të kontributeve vullnetare nga Shtetet Nënshkruese të shoqëruar me mbështetje financiare nga CMS-ja si dhe me kontribut "në natyrë" nga organizatat partnere.

Për të ndrequr financimet e parregullta, Memorandumi mbi Breshkat Detare në Oqeanin Indian dhe Azinë Jug-Lindore për shembull, i kerkoi së fundmi Nënshkruesve në Mbledhjen e Shteteve Nënshkruese në 2012 të jepnin kontribute vullnetare bazuar në Shkallën e Vlerësimit të Kombeve të Bashkuara (kontribute vullnetare të përcaktuara).

Tabela 2.3 Metodat e Financimit për Disa nga Instrumentet e Familjes CMS

Instrumenti	Metoda e Financimit për Kontributin e Palëve	Shënime shtesë
ACAP	Sistem i pavarur: Zhvilloi formula të ndryshme për Shtete Anëtare të ndryshme , Rezoluta 2.3	Formula 1: Për Palët shkalla e vlerësimit e të cilave është më pak ose e barabartë me 0.15% sipas Shkallës së Vlerësimit të Kombeve të Bashkuara (KB) për buxhetin e KB (aktualisht Rezoluta 58/1B, Mars 2004), kontributet vjetore do të llogariten sipas Shkallës së Vlerësimit të KB; Formula 2: Për palët shkalla e vlerësimit e të cilave është më e madhe se 0.15% sipas Shkallës së Vlerësimit të Kombeve të Bashkuara për buxhetin e KB, kontributet vjetore do te llogariten në bazë të 50% të të Ardhurave të Brendshme Bruto (GNI), dhe 50% GNI për frymë, ku asnjë palë nuk paguan më shumë se 20% të buxhetit total të ACAP-it; Formula 3: Nëse përqindja e llogaritur e kontributeve për një ose më shumë palë që rrjedhin nga Formula 2 i tejkalon 20%, kontributi për palën/palët vendoset në 20% të buxhetit vjetor, dhe kontributi për pjesën e mbetur të Palëve rillogaritet sipas formulës së rënë dakort në Rezolutën 2.3, Shtojca
AEWA	Shkalla e Vlerësimit e KB	Rezoluta 4.6 përcakton që Kontributi minimal nuk do të jetë më pak se 2,000 Euro në vit dhe për periudhën 2009-2012, kontributi maksimal nuk do të kalojë nivelin 20 përqind të buxhetit total.
ACCOBAMS	Shkalla e Vlerësimit e KB	Kontributi minimal prej 200 Euro. Rezoluta 1.7 krijoi Fondin e Granteve Shtesë për Konservim që pranon fonde nga burime të tjera
ASCOBANS	Shkalla e Vlerësimit e KB me modifikime të veçanta	Palët bien dakort të ndajnë kostot e buxhetit me Organizatat e Integrimit Ekonomik Rajonal duke mbuluar 2.5% të kostove administrative dhe palët e tjera mbulojnë pjesën e mbetur në përputhje me Shkallën e KB, por asnjë kontribut i palëve s'duhet të tejkalojë 25% të buxhetit.
CMS	Shkalla e Vlerësimit e KB e përshtatur sipas anëtarësisë së CMS-së	2.5% e BE-së dhe një kufi tavan. Propozimi për të rivendosur nivelin dysheme u refuzua në KP-në 10
EUROBATS	Shkalla e Vlerësimit e KB	Asnjë kontribut i palëve nuk duhet të kalojë nivelin 25% të buxhetit. Një kontribut minimal prej 1,000 Euro është parashikuar gjatë periudhës buxhetore 2011-2014.
GORILLAT	Sistem i Pavarur	Kontribut vjetor fiks prej 3,000 Euro (Rezoluta 2.2)
IOSEA	Kontribute të vleresuara vullnetare me financim nga UNEP	
PESHKAQENËT	Në diskutim	
FOKAT E DETIT WADDEN	Sistem Qeveritar Tripalësh	

SHEMBULL PRAKTIK 2.1

Programi CMS-së për Grantet e Vogla 2012-2014

Programi CMS-së për Grantet e Vogla është duke financuar një projekt që mbështet Taxhikistanin të udhëheqë një bashkëpunim ndërkufitar në lidhje me Leopardët e borës. Projekti po zbatohet nga Flora & Fauna Internacional në bashkëpunim me Departamentin e Pyjeve dhe Gjuetisë nën Komitetin e Mbrojtjes Mjedisore të Republikës së Taxhikistanit. Partnerë të tjerë bashkëpunues përfshijnë agjensi qeveritare dhe joqeveritare nga Afganistani, Kirgizistani dhe Taxhikistani, si dhe Pantera, një OJQ që ka në fokus mbrojtjen e maceve të egra.

Qëllimi kryesor i projektit është të bashkojë të tre vendet për të koordinuar aktivitete në lidhje me Leopardët e borës dhe speciet e tjera shtegtare që kalojnë përmes kufijve të këtyre shteteve. Ndaj, projekti synon bashkëpunimin dhe bashkëveprimin ndërmjet tre vendeve, dhe inkurajon e mbështet qeverinë e Taxhikistanit të luajë rol udhëheqës në aktivitete koordinuese rajonale. Projekti ndihmon gjithashtu në ngritjen e kapaciteteve brenda Shteteve Pjesëmarrëse të Zonës Shtegtare të Leopardëve të borës-përmes zhvillimit të trainimeve, programeve ndihmuese dhe rrjeteve- të zhvillojë dhe zbatojë planin e veprimit për specien.

PËRSËRITJË KAPITULLI

Pyetja 1: Cila kategori e specieve mbulohet nga Shtojca I e CMS-së?

Pyetja 2: Cilat instrumenta parashikohen nën CMS-në për mbrojtjen e specieve në Shtojcën II?

Pyetja 3: Si quhet ose referohet kontributi financiar i detyrueshëm i një Pale pjesë e CMS-së?

Pyetja 4: Ku ndodhet Njësia Koordinuese e Memorandumit mbi Shpendët Grabitqarë?

Përgjigjet:

1) Speciet shtegtare në rrezik zhdukjeje 2) Marrëveshjet dhe MOUs
3) Kontributet e vlerësuara 4) Abu Dhabi

Kapitulli pasardhës do të japë një panoramë më të detajuar rreth rolit të PKP-ve të Familjes CMS.

SHËNIME

ANEKSI 2.1

Neni VII i Konventës
Konferenca e Palëve

1. Konferenca e Palëve do të jetë organi vendim-marrës i kësaj Konvente.

2. Sekretariati do të organizojë një takim të Konferencës së Palëve jo më vonë se dy vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente.

3. Gjithashtu Sekretariati do të organizojë takime të Konferencës së Palëve në një interval kohor jo më shumë se një herë në tre vjet, vetëm nëse Konferenca vendos ndryshe, dhe takime të jashtëzakonshme në çdo kohë pas kërkesës me shkrim të të paktën 1/3 së palëve.

4. Konferenca e Palëve do të krijojë dhe mbajë nën kontroll rregullat financiare të Konventës. Konferenca e Palëve duhet, në çdo takim të zakonshëm të saj, të miratojë buxhetin për periudhën e ardhshme financiare. Secila palë duhet të kontribuojë në buxhet sipas një shkalle që do të miratohet nga Konferenca. Rregullat financiare, përfshirë këtu parashikimin e buxhetit dhe shkallën e kontributeve si dhe modifikimet e tyre, duhet të miratohen me votim të hapur nga Palët prezent dhe që votojnë.

5. Në secilën prej mbledhjeve të saj Konferenca e Palëve do të marrë në shqyrtim zbatimin e kësaj Konvente dhe në veçanti::

   a) do të rishikojë dhe vlerësojë statusin e mbrojtjes së specieve shtegtare;

   b) do të shikojë progresin e bërë në mbrojtjen e specieve shtegtare, veçanërisht ndaj atyre të listuara në Shtojcat I and II;

   c) të bëjë parashikimin dhe të sigurojë udhëzime që mund të jenë të nevojshme për të ndihmuar Këshillin Shkencor dhe Sekretariatin të zbatojë detyrat e ngarkuara;

   d) të marrë në analizë raporte të paraqitura nga Këshilli Shkencor, Sekretariati, çdo Palë apo ndonjë Organ i krijuar për një MARRËVESHJE;

   e) të japë rekomandime për Palët për përmirësimin e statusit të mbrojtjes të specieve shtegtare dhe të shikojë progresin e arritur sipas MARREVESHJES;

   f) në raste kur një MARRËVESHJE nuk është përfunduar, bën rekomandime për mbajtjen e takimit të Palëve që janë Shtete Kufitare të një specie shtegtare apo një grupi të tyre për të diskutuar mbi masat për të përmirësuar statusin e mbrojtjes së tyre;

   g) t'u bëjë rekomandime Palëve për përmirësimin e efektivitetit të kësaj Konvente; dhe

   h) të vendosë për ndonjë masë shtesë që duhet të merret për të zbatuar objektivat e Konventës.

6. Secila mbledhje e Konferencës së Palëve duhet të caktojë datën dhe vendin e mbledhjes së ardhshme.

7. Çdo mbledhje e Konferencës së Palëve duhet të përcaktojë dhe miratojë rregullat për proçedurat për atë mbledhje. Vendimet në një mbledhje të Konferencës së Palëve kërkojnë një shumicë prej 2/3 së Palëve prezent dhe që votojnë, përveç kur thuhet ndryshe në këtë Konventë.

8. Kombet e Bashkuara, Agjencitë e Specializuara të saj, Agjensia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike, si dhe ndonjë Shtet që nuk është Palë në këtë Konventë dhe, për çdo Marrëveshje, organi i caktuar

për Palët në atë Marrëveshje mund të përfaqësohet si vëzhgues në mbledhjet e Konferencës së Palëve.

9. Çdo agjenci apo organ teknikisht i kualifikuar në mbrojtjen, ruajtjen dhe menaxhimin e specieve shtegtare, sipas kategorive të mëposhtme, që ka njoftuar Sekretariatin për dëshirën e pjesëmarrjes në mbledhjet e Konferencës së Palëve si vëzhgues, do të pranohet pavarësisht nëse 1/3 e Palëve nuk paraqet vërejtje:

   a) agjencitë apo organizma ndërkombëtare, qeveritare ose jo, dhe agjencitë e organizmat qeveritare kombëtare; dhe

   b) agjencitë ose organizmat kombëtare joqeveritare që janë miratuar për këtë qëllim nga Shteti ku ato veprojnë.

   Pas pranimit, këto vëzhgues kanë të drejtën të marrin pjesë pa të drejtë vote.

3 Funksionet në lidhen me Administrimin, Financimin dhe Komunikimin

"Njerëzit e zgjedhur për të qenë PKP-të janë çelësi për t'i dhënë jetë Familjes CMS. Entuziasmi ynë është vendimtar për shpë-timin e specieve shtegtare."

James Njogu, Kenia

Ky kapitull trajton proçeset që lidhen me PKP-të dhe rolet e përgjegjësitë e tyre, veçanërisht:

- Emërimin e PKP-ve, Përfaqësuesve dhe Ekspertëve të Tjerë (Paragrafi 3.1)
- Komunikimi dhe Shpërndarja e Informacionit (Paragrafi 3.2)
- Çështjet Financiare (Seksioni 3.3)

3.1 Emërimi i PKP-ve, Përfaqësuesve dhe Ekspertëve të Tjerë

3.1.1 Emërimi i PKP-ve

Nën CMS-në dhe instrumentat e saj, Shteteve Anëtare u kërkohet të emërojnë PKP-të. Sekretariateve dhe Njësive Koordinuese u kerkohet të promovojnë komunikimin dhe bashkëpunimin me dhe midis Shteteve Anëtare. Për të përmbushur këtë përgjegjësi Sekretariatet dhe Njësitë Koordinuese mbajnë një listë të PKP-ve të caktuara nga qeveritë e Shteteve Anëtare.

Përveç kësaj, disa Marrëveshje (p.sh. ACAP, AEWA dhe EUROBATS) shkojnë më tej – në zbatim të Nenin V (4) lit. c) të CMS-së – dhe u kërkojnë Palëve të caktojnë një autoritet kombëtar për të mbikqyrur zbatimin e instrumentit.
PKP-ve të CMS-së u kërkohet shpesh të luajnë rol aktiv në mbikqyrjen dhe ndjekjen e emërimeve të PKP-ve për Marrëveshjet dhe Memorandumet e Mirëkuptimit siç nevojitet.
Proçedura e emërimit kërkon normalisht që një letër formale nga autoriteti përgjegjës i Shtetit Anëtar t'i

dërgohet Sekretariatit/Njësisë Koordinuese përkatëse, d.m.th një letër formale nga qeveria, me nënshkrimin e ministrit apo ekuivalentit i njohur nga instrumenti, dhe me vulën zyrtare. Ajo duhet të përmbajë emrin dhe të dhënat e kontaktit të personit të emëruar. Ndryshimet në këtë aspekt mund t'i komunikohen drejtpërdrejt Sekretariatit/Njësisë Koordinuese nga vetë PKP-ja. Formati i Raportit Kombëtar sërish iu ofron Shteteve Anëtare mundësinë të konfirmojnë dhe/ose përditësojnë informacionin e kontaktit të PKP-ve të tyre. {→ shih Kapitullin 6 për më shumë shpjegime të detajuara të proçesit të Raportimit Kombëtar}

Është avantazh nëse PKP-të arrijnë të qëndrojnë në atë pozicion për disa vite në mënyrë që të mund të përjetojnë një cikël të plotë dhe të krijojnë eksperiencë dhe një rrjet kontaktesh për të siguruar vazhdimësi në rrjedhën e punës dhe komunikimit.

3.1.2 Emërimi i Anëtarëve në Organet Vartëse

3.1.2.1 Emërimi i Ekspertëve në Organet Vartëse Shkencore dhe Teknike

CMS-të dhe disa prej instrumentave të saj përcaktojnë një numër organesh vartëse ku Shtetet Anëtare ftohen të emërojnë anëtarë ekspertë {→ shih Paragrafin 2.3.2 dhe Tabelën 3.1} për të dhënë këshilla teknike dhe shkencore. Në rastin e ASCOBANS-it anëtaret e Komitetit Këshillimor kanë një funksion të dyfishtë {→ shih Tabelën 2.2 ne Paragrafin 2.3}

Në disa raste, çdo Shteti Anëtar i kërkohet të emërojë një ekspert mbi speciet ose grupin e specieve që mbulon instrumenti, ndërsa në të tjerat, të dhëna specifike në ekspertizën e kërkuar jepen për anëtarët e organit përkatës. Në ndryshim me këtë, anëtarësia e disa organeve në varësi me natyrë shkencore dhe teknike që i përkasin instrumentave kufizohet dhe bazohet në përfaqësimin gjeografik.

PKP-të mund të luajnë një rol të rëndësishëm në lehtësimin e përzgjedhjes së ekspertëve dhe emërimin e tyre.

Ndaj, proçesi i emërimit ndryshon sipas përbërjes së këtyre institucioneve.

Table 3.1 Anëtarësimi i Organeve Këshillimore Teknike e Shkencore në Organet e Familjes CMS

CMS	**Këshilli Shkencor (Neni VIII.2)** → çdo Palë ka të drejtë të emërojë një anëtar (Veç kësaj, Rezoluta 1.4 e Konferencës së Palëve përcakton që Këshilli duhet të përfshijë ekspertë të kualifikuar të zgjedhur e emëruar nga KP-ja {shih Kutinë e Informacionit 3.1}
Marrëveshjet	
ACAP	**Komiteti Këshillimor (Neni IX)** → çdo Palë ka të drejtë të emërojë një anëtar
AEWA	**Komiteti Teknik (Neni VII)** → pesëmbëdhjetë anëtarë, që përfshijnë: - nëntë ekspertë që përfaqësojnë rajone të ndryshme të Zonës së Marrëveshjes (të emëruar nga Palët brenda nëntë nën-rajoneve dhe të zgjedhur nga Mbledhja e Palëve) -nga një ekspert për secilën fushë si ekonomia rurale, menaxhimi i gjahut, dhe e drejta mjedisore -Përveç ekspertëve të Palëve: Nga një përfaqësues nga Unioni Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Natyrës dhe Burimeve Natyrore (IUCN), Byroja e Kërkimeve Ndërkombëtare për Ligatinat dhe Shpendët Ujorë (IWRB) dhe nga Këshilli për Gjahun dhe Mbrojtjen e Botes së Egër (CIC).
ACCOBAMS	**Komiteti Shkencor (Neni VII dhe Rezoluta 4.4)** → dymbëdhjetë anëtarë, që përfshijnë: -Një Kryetar -Katër Menaxherë Projektesh, përfshirë një Nën-kryetar -Katër përfaqësues rajonale nga zona ACCOBAMS -Nga një përfaqësues nga Unioni Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Natyrës dhe Burimeve Natyrore (IUCN), Shoqata Europiane e Cetaceve (ECS), dhe nga Komiteti Shkencor i Komisionit Ndërkombëtar të Balenave (IWC)
ASCOBANS	**Komiteti Këshillimor (Neni 5.2)** → Një anëtar nga secila Palë (çdo anëtar i Komitetit mund të shoqërohet nga këshilltarë dhe Komiteti mund të ftojë ekspertë të tjerë të marrin pjesë në mbledhje, Neni 5.4) Komiteti ka funksion këshillues teknik dhe administrativ
EUROBATS	**Komiteti Këshillimor (Rezoluta mbi në krijimin e një Komiteti Këshillimor, Aneksi H i raportit të TP 1)** → Një anëtar nga secila Palë (çdo anëtar mund të shoqërohet nga këshilltarë dhe Komiteti mund të ftojë ekspertë të tjerë të marrin pjesë në mbledhjet e tij, paragrafi 4 i Rezolutës)
GORILLAT	**Komiteti Teknik (Neni VI)** → Një përfaqësues nga Shtetet e Zonës Shtrirëse → Një ekspert nga secila prej fushave të mëposhtme: menaxhimi dhe ruajtja e pyjeve , e drejta mjedisore, shëndeti i kafshëve të egra → Një përfaqësues nga Partneriteti i Mbijetesës së Majmunëve të Mëdhenj (GRASP)
FOKAT E DETIT WADDEN	**Bordi i Detit Wadden (Anekset 3 dhe 4, Marrëveshjet Qeverisëse të Bashkëpunimit Tripalësh të Detit Wadden)** → trembëdhjetë anëtarë, që përfshijnë: - Katër anëtare bordi nga secila Palë (Aneksi 3) - Një kryetar (i emëruar nga qeveria pjesëmarrëse që pret Këshillin e ardhshëm Qeveritar Tripalësh, Aneksi 4)
Disa nga Memorandumet e Mirëkuptimit	
Dugongët	**Grupi Teknik mbi Dugongët** shih Raportin nga Takimi i Dytë Zyrtar i Shteteve Nënshkruese Raporti DM/SS.2 , 19-20 Shkurt 2013, parag. 112-126, Pika e Axhendës 11.4 dhe termat e referencës që janë të përfshira në CMS/Dugong/SS2/Dok.11.4 Aneksi II)
Breshkat e Detit të Bregut Atlantik të Afrikës	**Komiteti Këshillimor** → 10 anëtarë; çdo Shtet Nënshkrues mund të emërojë anëtarë: që mund të mbështeten nga të paktën dy Shtete Nënshkruese të tjerë ose që nuk përfshijnë qytetarë nga shteti që emëron.(Parag. 4)
Breshkat e Detit IO-SEA	**Komiteti Këshillimor** → Deri në 10 anëtarë, të emëruar nga Shtetet Nënshkruese të ndryshme nga shteti i origjinës së tyre. (Termat e referencës, para. 1 dhe 5)
Rrëmbenjësit	**Grupi Këshillimor Teknik** Shih seksionin 13.2 të raportit të Mbledhjes së Shteteve Nënshkruese (Abu Dhabi, 9-11 Dhjetor 2013) dhe MSHF/Rrëmbenjësit/Dokumenti 13.2 Aneksi
Peshkaqenët	**Komiteti Këshillimor** → 10 anëtarë: Afrika: 2; Azia: 2; Amerika e Veriut: 1; Europa: 2; Oqeania: 1; Amerika e Jugut dhe Qendrore & Karaibet: 2 (Seksioni 7, paragrafi 24)

3.1.2.2 Emërimi i Anëtarëve në Organet që Ofrojnë Politika dhe Udhëzime Administrative Ndërmjet Sesioneve (Përfaqësues në Komitetin e Përhershëm)

Meqënëse Komitetet e Përhershme kryejnë funksionet e organeve vendim-marrëse ndërmjet sesioneve, rekomandohet që anëtarët duhet të kenë ekspertizë në çështjet e politikave dhe ato administrative. Anëtarësimi në Komitetet e Përhershme zakonisht përcaktohet sipas një përfaqësimi të balancuar të Palëve nga pikëpamja gjeografike {→ shih Tabelen 3.2 dhe Shembullin Praktik 3.1}. Në varësi të instrumentit, në Konferencën e Palëve ose Takimin e Palëve, rajonet ose nën-rajonet mblidhen për të propozuar Palët që do t'i përfaqësojnë ata, dhe pastaj Konferenca ose Takimi e aprovon zgjedhjen në formë zyrtare. I takon Palëve të zgjedhura në Komitetin e Përhershëm të vendosin se cilët individë do të marrin pjesë.

Prandaj PKP-të e çdo instrumenti kështillohen të koordinohen me PKP-të e vendeve të tjera brenda rajonit ose nën-rajonit të tyre, sipas rastit, në mënyrë që të ndikojnë në vendimin e emërimit të këtyre përfaqësuesve, para mbledhjeve të organeve vendim-marrëse.

Table 3.2 Përbërja e Përfaqësuesve të Komiteteve të Përhershme të Familjes CMS

CMS	**Komiteti i Përhershëm** -Tre Palë nga Afrika -Tre Palë nga Europa -Dy Palë nga Azia -Dy Palë nga Amerika Jugore dhe Qendrore dhe Karaibet; -Një Palë nga Amerika e Veriut (nuk ka asnjë Palë në këtë rajon për momentin) -Një Palë nga Oqeania -Qeveria Depozituese dhe Pritëse e Sekretariatit; dhe ku është e aplikueshme, -Qeveria Organizatore e takimit të ardhshëm dhe të mëparshëm të Konferencës së Palëve. (Rezoluta 9.15)
AEWA	**Komiteti i Përhershëm** - pesë përfaqësues rajonalë - dy për Evropën dhe Azinë Qendrore - një për Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut - një për Afrikën Perëndimore dhe Qendrore - një për Afrikën Lindore dhe Jugore - një përfaqësues i vendit mikpritës të Mbledhjes së ardhshme të Palëve - një përfaqësues nga Shteti Depozitues (Kryetari i Komitetit Teknik është i ftuar për të marrë pjesë si vëzhgues)
EUROBATS	**Komiteti i Përhershëm** → jo më shumë se shtatë Palë duke përfshirë një përfaqësues nga Qeveria Depozituese, Qeveria Pritëse e Sekretariatit dhe pesë anëtarët e zgjedhur (Rezoluta 5.8)

Tekstet e Rezolutës 9.15 të CMS-së, Rezolutës 2.6 të AEWA-së dhe Rezolutës 5.8 të EUROBATS-it janë risjellënë {→ Aneksi 3.1, 3.2 dhe 3.3} të këtij Kapitulli

3.1.2.3 Emërimi i Anëtarëve në Grupet e Punës

Kriteret dhe proçedurat sipas të cilave janë krijuar këto Grupe Pune dhe ekspertiza e anëtarëve të tyre, mund të ndryshojnë në varësi të natyrës dhe fushëveprimit të Grupeve të Punës. Pjesëmarrja në këto mekanizma formale ose joformale mund të përbëjë një avantazh të madh për çdo Shtet Anëtar që dëshiron të paraqesë pikëpamjet dhe qëndrimet e tij mbi një çështje të caktuar. Një komunikim i mirë ndërmjet Sekretariateve dhe Njësive Koordinuese dhe PKP-ve është i nevojshëm për ta lehtësuar këtë proces.

SHEMBULL PRAKTIK 3.1

Përbërja e Komitetit të Përhershëm të CMS-së (2011-2014)

RAJONI	ANËTARËT	VENDI ALTERNATIV
Afrika	Gana (Kryetari), Tunizia, Uganda	Kongo (Brazavil), Mali, Afrika e Jugut
Azia	India, Pakistani	Mongolia, Republika Arabe e Sirisë
Amerika e Jugut dhe Qendrore dhe Karaibet	Kili, Kuba	Argjentina, Kosta Rika
Europa	Norvegjia (Zëvendës-Kryetari), Polonia, Ukraina	Franca, Gjeorgjia, Zvicra
Amerika e Veriut	Vend bosh	Vend bosh
Oqeania	Zelanda e Re	Australia
Depozituesi	Gjermania	
Mikpritëse e KP 10	Norvegjia (gjithashtu përfaqësuese për Evropën)	
Mikpritëse e KP 11	Mbetet të konfirmohet	

3.2 Komunikimi dhe Shpërndarja e Informacionit

Komunikimi është një element kyç i përgjegjësive të çdo PKP-je {→ shih Figuren 3.1}. PKP-të janë pikat kryesore të kontaktit për çështjet:

- brënda Shtetit Anëtar (në nivel qeverie dhe më tej)
- ndërmjet Sekretariatit/Njësisë Koordinuese dhe Shtetit Anëtar dhe
- ndërmjet Shteteve Anëtare.

Prandaj është me shumë rëndësi krijimi i një rrjedhe të rregullt të informacionit dhe komunikimit. "Përditësimi i vazhdueshëm" në lidhje me zhvillimet në CMS dhe instrumentet e saj është pika e fillimit {→ shih Kutia e informacionit 3.1}.

Rekomandohet që PKP-të të komunikojnë rregullisht:
Në nivel kombëtar, me:
- kolegët, vartësit dhe supervizorët brënda organizatës ku punon PKP-ja, si dhe me ministritë dhe agjencitë qeveritare përkatëse.
- ekspertët/anëtarët e organeve ndihmëse shkencore dhe teknike të instrumentit përkatës të CMS-së.
- PKP-të e tjera të CMS-së dhe/ose instrumentet e saj sipas rastit
- PKP-të për Marrëveshje Shumëpalëshe Mjedisore të tjera që lidhen me biodiversitetin
- institucionet e tjera përkatëse eksperte të rëndësishëm (p.sh. organizatat joqeveritare përkatëse) dhe individët;

Në nivel rajonal, me:
- përfaqësuesit e tyre rajonalë në organet përkatëse të CMS-së dhe instrumenteve të saj,

- Autoritetet rajonale/forumet siç është e përshtatshme p.sh. Komisionin Evropian dhe komisionet rajonale ekonomike, të tilla si Komuniteti për Zhvillimin e Afrikës Jugore.

Në nivel ndërkombëtar, me::
- Sekretariatet/Njësitë koordinuese të linjës,
- PKP-të e Shteteve Anëtare të tjera jashtë rajonit të tyre.
- Organizatat ndërkombëtare qeveritare dhe joqeveritare

Për sa i përket shpërndarjes së informacionit, janë zhvilluar shumë mjete nga Sekretariatet/Njësitë Koordinuese dhe janë aktualisht në përdorim. Këto përfshijnë faqet e internetit, buletinet elektronike, mediat sociale si dhe platformën elektronike komunitare. Këto ndihmojnë për t'i mbajtur Shtetet Anëtare dhe grupet e interesit në një hap me progresin në punën e instrumentit; sfidat dhe nevojat; dhe ofrojnë platforma për komunikim dhe shkëmbim pikëpamjesh.



Figura 3.1 Rolet e Komunikimit të PKP-së

KUTI INFORMACIONI 3.1

Lista e Metodave të Komunikimit brenda Familjes CMS

CMS

Faqja e Internetit: http://www.cms.int/

E-Buletini: http://www.cms.int/publications/CMS_Bulletin.htm

Llogaria në Facebook: https://www.facebook.com/bonnconvention

Llogaria në Twitter: https://twitter.com/BonnConvention

Njoftime: http://www.cms.int/news/index.htm

AEWA

Faqja e Internetit: http://www.unep-aewa.org/

Llogaria në Facebook: https://www.facebook.com/unep.aewa

Buletini Informativ: http://www.unep-aewa.org/news/e_newsletter_archive.htm

ASCOBANS

Faqja e Internetit: http://www.ascobans.org/

E-Buletini: http://www.ascobans.org/newsletter.html

EUROBATS

Faqja e Internetit: http://www.eurobats.org/

EUROBATS Chat: http://www.eurobats.org/publications/eurobat_chat

IOSEA

Website: http://www.ioseaturtles.org/

Buletini Informativ: http://www.ioseaturtles.org/electronic_lib2.php?cat_id=8

e-Lajmet (Arkivi): http://www.ioseaturtles.org/archive_enews.php

3.3 Çështjet Financiare

Roli i PKP-ve në lidhje me mobilizimin e burimeve është i dyfishtë:

Kontributet e vlerësuara
Një aspekt i rëndësishëm i punës së PKP-së është mbikëqyrja dhe sigurimi i kryerjes së mënjëhershme dhe të plotë të pagesës së kontributeve vjetore në CMS dhe instrumentet e saj {→ shih Këshilla të Vlefshme 3.1}. PKP-të informohen rregullisht nga Sekretariatet/Njësitë koordinuese në lidhje me statusin e detyrimeve të tyre vjetore dhe do të marrin faturat nga Zyrat Qëndrore të UNEP-it në Nairobi. Është shumë e rëndësishme që kontributet e vlerësuara të paguhen në kohë, për të siguruar funksionimin e rregullt dhe vazhdimësinë e aktiviteteve, personelit, dhe zbatimin e projektit. Cilësia dhe zbatimi efektiv i një programi ose projekti cënohet kur financimi është jo i rregullt.

Kontributet vullnetare
Përveç kontributeve të vlerësuara, kontributet vullnetare si ato financiare ashtu edhe ato në natyrë janë të mirëpritura dhe nevojiten veçanërisht për ta mbështetur zbatimin e CMS-së dhe instrumentave në nivel ndërkombëtar. PKP-të informohen nga Sekretariatet dhe Njësitë koordinuese për nevojat e financimit në plotësimin e burimeve kryesore {→ shih gjithashtu Seksionin 5.2.5 Objektivi 6 dhe Shembulli Praktik 5.2}.

KËSHILLA TË VLEFSHME 3.1

Pagesa e kontributeve për instrumentet e Familjes CMS

Ndërsa përgjegjësia për sigurimin e burimeve të përshtatshme parashikohet të ndahet midis udhëheqësve të ndryshëm të aktiviteteve dhe grupeve të interesit, PKP-ja pritet të luajë një rol proaktiv. Pjesa më e madhe e burimeve financiare do të duhet të gjendet në nivel kombëtar dhe çdo vend do të ketë institucionet dhe proçedurat e veta për t'u marrë me këtë {→shih Seksioni 3.3 dhe 5.2.5}.

PKP-të duhet të sigurohen që kontributet për instrumentat e Familjes CMS të paguhen në kohë. Shumat përcaktohen nga takimet e organeve vendim-marrëse dhe mund të gjenden në rezolutën/vendimet e miratuara mbi buxhetin. Zakonisht në rezolutën/vendimet e buxhetit pasqyrohen të dhënat bankare dhe se si dhe cili do të paguhet.

LISTË KONTROLLI

Veprim që kërkohet nga PKP-ja dhe aktorët e tjerë

Emërimi i PKP-ve të Familjes CMS dhe përfaqësuesve të tjerë

- ❑ PKP: Inicion emërimet e PKP-ve, përfaqësuesve në Komitetin e Përhershëm dhe të ekspertëve të tjerë dhe merr letrën zyrtare të emërimit të nënshkruar nga ministrit përgjegjës ose zyra qeveritare.
- ❑ Ministri Përgjegjës: Plotëson dhe nënshkruan formularin zyrtar të emërimit
- ❑ PKP-ja ose autoriteti përgjegjës i caktuar: Dorëzon letrën zyrtare të emërimit pranë Sekretariatit/Njësisë Koordinuese të linjës
- ❑ PKP: Informon Sekretariatin/Njësinë koordinuese në fjalë për çdo ndryshim në informacionin e kontaktit të PKP-ve

Komunikimi

- ❑ Mbledh informacionin e kontaktit të të gjitha grupeve të interesit përkatëse aktive në fushën e CMS-së dhe instrumenteve të tij
- ❑ Krijon kalim të rregullt të informacionit dhe mundëson komunikimin në mes Qeverisë dhe Sekretariatit/Njësisë Koordinuese, si dhe Shteteve Anëtare të tjera me instrumentet e Familjes CMS.

Përditësimi i vazhdueshëm

- ❑ Rregullisht kontrollon faqet e internetit të Familjes CMS, njoftimin, buletinet elektronike dhe mediat sociale për informacion dhe ofron të dhëna kur është e nevojshme.

PËRSËRITJE KAPITULLI

Pyetja 1: Cili duhet të informohet për të gjitha zhvillimet kryesore në CMS dhe instrumentet e saj për të siguruar mbështetje politike të mjaftueshme për zbatimin e tyre në nivel kombëtar?

Pyetja 2: Cili e mban listën e të gjitha PKP-ve të CMS-së dhe si rrjedhim duhet të informohet menjëherë për të gjitha ndryshimet mbi informacionin e kontaktit të PKP-ve?

Pyetja 3: Si e merr informacionin PKP-ja mbi shumën e kontributit të vlerësuar?

Përgjigjet: *1) Qeveria 2) SekretariatiNjësia koordinuese 3) PKP-të Njoftohen rregullisht nga SekretariatiNjësitë Koordinuese mbi detyrimet vjetore dhe merr faturat financiare nga Zyrat Qëndrore të UNEP në Nairobi.*

Kapitulli pasues ofron informacion se si zhvillohet trendi ciklik i ngjarjeve brenda Familjes CMS dhe se si PKP-ja mund t'i mbështesë autoritetet e veta kombëtare.

SHËNIME

ANEKSI 3.1

Rezoluta 9.15 e Konferencës së Palëve të CMS-së (Romë, 2008)
Përbërja dhe Organizimi i Komitetit të Përhershëm

Miratuar nga Konferenca e Palëve në Takimin e Nëntë të saj (Romë 1-5 Dhjetor 2008)

Duke rikujtuar Rezolutat 1.1, 2.5, 3.7 dhe 6.6 që themelojnë dhe rregullojnë Komitetin e Përhershëm të CMS-së dhe, në veçanti, përbërjen e anëtarëve të tij;

Duke pranuar nevojën për terma reference të qarta, të sakta dhe të konsoliduara për qeverisjen e Komitetit të Përhershëm;

Me dëshirën e mirë për të siguruar që anëtarësimi të reflektojë numrat dhe interesat konservuese të Palëve në çdo rajon gjeografik kryesor dhe, për aq sa është e mundur, pasurinë dhe diversitetin e specieve shtegtare në secilin rajon; dhe

Gjithashtu *shpreh dëshirën* e mirë për të siguruar për aq sa është e mundur një vazhdimësi dhe rotacion efikas në anëtarësinë e Komitetit;

Konferenca e Palëve për Konventën për Ruajtjen e Specieve Shtegtare të Kafshëve të Egra

1. *Vendos* për ta ri-themeluar Komitetin e Përhershëm të Konferencës së Palëve me terma reference të si mëposhtme;

Në kuadër të politikës së dakordësuar nga ana e Konferencës së Palëve, Komiteti i Përhershëm duhet:

(a) Të ofrojë politikën e përgjithshme dhe drejtimin operacional për Sekretariatin;

(b) Të ofrojë këshilla dhe ndihmë për Palët në lidhje me zbatimin e Konventës;

(c) Të kryejë gjatë përiudhës midis takimeve të Konferencës së Palëve aktivitete të tilla të përkohshme në emër të Konferencës, siç mund të jetë e nevojshme ose e përcaktuar në mënyrë të qartë;

(d) Të ofrojë udhëzime dhe këshilla për Sekretariatin për përgatitjen e axhendave dhe kërkesave të tjera të takimeve dhe mbi çdo çështje tjetër të sjellë nga Sekretariati në ushtrimin e funksioneve të tij;

(e) Të mbikëqyrë, në emër të Palëve, zhvillimin dhe zbatimin e buxhetit të Sekretariatit që rrjedh nga Fondi Financiar dhe burime të tjera dhe gjithashtu të gjitha aspektet e mbledhjes së fondeve të ndërmarra nga Sekretariati me qëllim kryerjen e funksioneve specifike të autorizuara nga Konferenca e Palëve, si dhe të mbikëqyrë shpenzimet e aktiviteteve të tilla të mbledhjes së fondeve; dhe do të mbështetet në këtë aktivitet, nga nënkomiteti i ngritur përmes rezolutës 9.14, paragrafi 12;

(f) Të përfaqësojë Konferencën e Palëve, përballë Qeverisë së vendit ku ndodhen zyrat qendrore të Sekretariatit, Programit i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin (UNEP) dhe organizatave të tjera ndërkombëtare për shqyrtimin e çështjeve që lidhen me Konventën dhe Sekretariatin e saj;

(g) Të dorëzojë në çdo mbledhje të rregullt të Konferencës së Palëve një raport me shkrim për punën e tij të kryer që nga mbledhja e kaluar;

(h) Të hartojë rezolutat ose rekomandimet, sipas rastit, për shqyrtim nga Konferenca e Palëve;

(i) Të veprojë si Byro në mbledhjet e Konferencës së Palëve deri në miratimin e Rregullores së

Brendshme të Konferencës; dhe

(j) Të kryejë çdo funksion tjetër që mund t'i caktohet nga Konferenca e Palëve;

2. *Përcakton* rregullat e mëposhtme për Komitetin e Përhershëm:

(a) Për anëtarësimin në Komitetin e Përhershëm do të bihet dakord në çdo takim të Konferencës së Palëve, në përputhje me Rregulloren e Brendshme të Konferencës

(por gjithashtu shih 2 (l) më poshtë) dhe do të përfshijë:

(i) tri palë të zgjedhura nga secili prej rajoneve gjeografike (a) Afrika dhe (b) Europa;
(ii) dy palë të zgjedhura nga secili prej rajoneve gjeografike (a) Azia dhe (b) Amerika e Jugut dhe Qëndrore dhe Karaibet;
(iii) një palë nga secili prej rajoneve gjeografike (a) Amerika e Veriut dhe (b) Oqeania;
(iv) Depozituesin dhe Qeverinë mikpritëse të Sekretariatit; dhe
(v) Kur është e përshtatshme, Qeverinë mikpritëse të takimit të ardhshëm dhe të mëparshëm të Konferencës së Palëve.

(b) Çdo mbledhje e Konferencës së Palëve (KP) po ashtu do të zgjedhë dymbëdhjetë përfaqësues rajonalë që për të shërbyer si anëtarë zëvendësues dhe, në veçanti, për të marrë pjesë në mbledhjet e Komitetit të Përhershëm në mungesë të anëtarit të rajonit për të cilin ata janë zgjedhur anëtar zëvendësues.

(c) Mandati i anëtarëve dhe zëvendësve rajonalë do të përfundojë në fund të takimit të zakonshëm të radhës të KP-së që pason takimin në të cilën janë zgjedhur fillimisht. Anëtarët rajonalë nuk mund të shërbejnë më shumë se dy mandate të njëpasnjëshme.

(d) Nëse një takim i jashtëzakonshëm ose një takim i veçantë i Konferencës së Palëve zhvillohet në mes dy mbledhjeve të zakonshme, Pala organizatore e asaj mbledhje do të përfshihet në punën e Komitetit për çështjet që kanë të bëjnë me organizimin e mbledhjes.

(e) Palët jo Anëtare të Komitetit kanë të drejtë të përfaqësohen në mbledhjet e Komitetit përmes një vëzhguesi, i cili do të ketë të drejtën e pjesëmarrjes, por jo të votimit.

(f) Kryetari i Këshillit Shkencor ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Komitetit të Përhershëm, si vëzhgues pa të drejtë vote.

(g) Kryetari mund të ftojë çdo person ose përfaqësues të një vendi ose organizate tjetër që të marrë pjesë në mbledhjet e Komitetit si vëzhgues pa të drejtë vote.

(h) Sekretariati do t'i informojë të gjitha palët për datën dhe vendin e mbledhjeve të Komitetit të Përhershëm.

(i) Komiteti, me konsensus, do të miratojë rregulloren e vet të brendshme.

(j) Sekretari për Komitetin do të sigurohet nga Sekretariati i Konventës.

(k) Anëtarësia e Komitetit do të ripërtërihet në çdo takim të zakonshëm të Konferencës së Palëve.

(l) Në qoftë se një përfaqësues rajonal ose zëvendës jep dorëheqjen nga Komiteti i Përhershëm, Sekretariati do të organizojë një votim mes të gjitha Palëve nga ai rajon për të zgjedhur një pasues, sipas sistemit të votimit të përshkruar në Rezolutën *mutatis mutandis* të miratuar në Konferencën e Palëve.

3. *Kërkon* nga anëtarët e Komitetit të bëjnë çdo përpjekje për t'i paguar shpenzimet e tyre të udhëtimit;

4. *Kërkon* nga Sekretariati të bëj parashikime në buxhete për mbulimin, sipas kërkesës, të shpenzimeve të arsyeshme dhe të justifikueshme të udhëtimit të përfaqësuesve të emëruar nga grupi i vendeve të cilat janë identifikuar nga organet përgjegjëse të Konventës si vende me të drejtë pagese të udhëtimit dhe nga Pala pritëse e ardhshme (nëse edhe kjo kualifikohet për financim).

Në kuadër të politikës së dakordësuar nga ana e Konferencës së Palëve, Sekretariati:

(a) Duhet të parashikojë pagesën e shpenzimeve të udhëtimit për anëtarët rajonalë nga grupi i vendeve në zhvillim dhe vendeve me ekonomi në tranzicion (ose anëtarët zëvendësues që marrin pjesë në emër të tyre) për të marrë pjesë të shumtën në një Komitet të Përhershëm për çdo vit kalendarik;

(b) Do të kompensojë shpenzimet e udhëtimit, sipas kërkesës, për jo më shumë se një përfaqësues të një Pale në çdo takim të Komitetit të Përhershëm;

(c) Mund t'i kompensojë Kryetarit të Komitetit të Përhershëm të gjitha shpenzimet e udhëtimit të arsyeshme dhe të justifikueshme për udhëtime të ndërmarra në emër të Konferencës së Palëve ose në emër të Sekretariatit;

(d) Rimbursimet mund t'i paguajë në Dollarë Amerikanë ose Euro;

(e) Do të pranojë kërkesa për rimbursim, të mbështetura me fatura, të cilat duhet të dorëzohen pranë Sekretariatit brenda tridhjetë ditëve kalendarike nga përfundimi i udhëtimit; dhe

(f) Do të përpiqet, për sa është e mundur, të sigurojë fonde të jashtme për shpenzimet e udhëtimit;

5. *Vendos* që detyrat e Përfaqësuesit Rajonal në Komitetin e Përhershëm do të jenë si më poshtë:

(a) të mbaj një komunikim të rrjedhshëm dhe të përhershëm me Palët e rajonit të tyre dhe Sekretariatin;

(b) kudo që të jetë e mundur, të kërkojë mendime nga Palët e rajoneve të tyre për çështje në shqyrtim nga ana e Komitetit të Përhershëm; dhe

(c) të raportojë për aktivitetet dhe komunikimet e tyre në takimet e Komitetit, dhe në të gjitha mbledhjet rajonale që ndodhin gjatë Konferencës së Palëve ose ndërmjet sesioneve; dhe

6. *Vendos* që Rezolutat 2.5, 3.7 dhe 6.6 të shfuqizohen

ANEKSI 3.2

Rezoluta 2.6 e Takimit të Palëve të Memorandumit AEWA (Bon, 2001) Organizimet Institucionale: Komiteti i Përhershëm

Duke rikujtuar se, në bazë të nenit VI paragrafi 9 (e) të Marrëveshjes, Mbledhja e Palëve mund të krijojë organe të tilla vartëse, që i konsideron të nevojshme për të ndihmuar në zbatimin e Marrëveshjes, në veçanti për koordinim me organet e themeluara në bazë të traktateve, konventave dhe marrëveshje të tjera ndërkombëtare me mbulim të dyfishtë gjeografik dhe taksonomik,

Duke rikujtuar më tej se, në sesionin e saj të parë, Mbledhja e Palëve ka themeluar një Komitet Teknik për të dhënë këshilla shkencore dhe teknike dhe informacion për Mbledhjen e Palëve dhe, nëpërmjet Sekretariatit të Marrëveshjes, për Palët,

Duke pranuar se Drejtori Ekzekutiv i Programit të Kombeve të Bashkuara për Mjedisin është përgjegjës për administrimin e Sekretariatit,

Duke vënë në dukje se nuk janë ofruar dispozita për të siguruar udhëzime dhe këshilla për Sekretariatin mbi politikën, çështjet financiare dhe administrative, të cilat Sekretariati mund të duhet t'i ngrejë ndërmjet sesioneve të Mbledhjes së Palëve,

Duke konsideruar dobinë e një komiteti të vogël të përhershëm për çështjet që lidhen me organizimin e mbledhjeve dhe zbatimin e vazhdueshëm të Marrëveshjes,

Mbledhja e Palëve:

1. *Vendos* të themelojë një Komitet të Përhershëm, i cili, brenda politikës së dakordësuar nga Mbledhja e Palëve duhet;

(a) Të kryejë në mes të sesioneve të Takimit të Palëve aktivitetet e tilla të përkohshme në emër të Takimit, siç mund të jetë e nevojshme;

(b) Të bëj rekomandime për t'u shqyrtuar në sesionin e radhës të Takimit të Palëve;

(c) Të mbikqyrë, në emër të Palëve, zhvillimin dhe zbatimin e buxhetit të Sekretariatit që rrjedh nga Fondi Financiar dhe burime të tjera dhe gjithashtu të gjitha aspektet e mbledhjes së fondeve të ndërmarra nga Sekretariati për të kryer funksionet specifike të autorizuara nga Mbledhja e Palëve;

(d) Të mbikqyrë, si përfaqësues i Mbledhjes së Palëve, zbatimin e politikës nga Sekretariati dhe të drejtojë programet e Sekretariatit;

(e) Të ofrojë udhëzime dhe këshilla për Sekretariatin mbi zbatimin e Marrëveshjes, për përgatitjen e mbledhjeve, dhe për çështje të tjera që lidhen me ushtrimin e funksioneve të Sekretariatit që sillen tek ai nga Sekretariati;

(f) Të përfaqësojë Takimin e Palëve, përballë Qeverisë së vendit ku ndodhen selitë qëndrore të Sekretariatit, Programit i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin dhe organizatave të tjera ndërkombëtare për shqyrtimin e çështjeve që lidhen me Marrëveshjen dhe Sekretariatin e saj;

(g) Të veproj si Byro në sesionet e Takimit së Palëve, në përputhje me rregulloren e brendshme të Takimit të Palëve;

(h) Raporton në Takimin e Palëve për aktivitetet që janë kryer në mes të sesioneve të zakonshme të Mbledhjes së Palëve;

(i) Kryen çdo funksion tjetër që mund t'i caktohet nga Takimi i Palëve;

2. *Përcakton* parimet e mëposhtme për përbërjen dhe proçedurat që duhet të ndiqen nga Komiteti i Përhershëm:

(a) Komiteti do të përbëhet nga jo më shumë se shtatë Palë Kontraktuese, të cilat do të emërohen nga Takimi i Palëve. Për të paktën pesë prej këtyre anëtarëve, emërimi do të mbështetet në parimin e një shpërndarje gjeografike të balancuar, duke pasqyruar dy përfaqësues nga rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore, një përfaqësues nga rajoni i Lindjes së Mesme dhe Afrikës së Veriut, një përfaqësues nga rajoni i Afrikës Perëndimore dhe Qendrore, dhe një përfaqësues nga rajoni i Afrikës Lindore dhe Jugore. Dy anëtarët e tjerë të mbetur do të përfshijnë një përfaqësues nga vendi organizator i sesionit të radhës të Takimit të Palëve dhe një përfaqësues nga Qeveria Depozituese;

(b) Takimi i Palëve do të caktojë anëtarin zëvendësues për një anëtar të përshkruar në nënparagrafin 2 (a) si më sipër. Çdo zëvendës i tillë do të marrë pjesë në mbledhje, si anëtar rajonal vetëm në mungesë të përfaqësuesit të anëtarit për të cilën ai është zëvendës;

(c) Nëse një sesion i jashtëzakonshëm i Takimit të Palëve mbahet në mes dy sesioneve të zakonshme, Pala pritëse e atij sesioni të jashtëzakonshëm do të marrë pjesë si vëzhguese në punën e Komitetit për çështjet që kanë të bëjnë me organizimin e sesionit të jashtëzakonshëm;

(d) Palët Kontraktuese që nuk janë anëtare të Komitetit të Përhershëm kanë të drejtë të përfaqësohen në mbledhjet e Komitetit nga një vëzhgues që do të ketë të drejtën e pjesëmarrjes me shpenzimet e veta, por jo të votimit;

(e) Kryetari mund të ftojë çdo person ose përfaqësues të një vendi ose organizate tjetër dhe Kryetarin e Komitetit Teknik që të marrë pjesë në mbledhjet e Komitetit si vëzhgues pa të drejtë vote;

(f) Anëtarësimi i Komitetit do të shqyrtohet në çdo sesion të rregullt të Takimit të Palëve, në përputhje me rregulloren e brendshme të takimit. Mandati i anëtarëve të emëruar mbi baza gjeografike përfundon në fund të sesionit të dytë të rregullt të Mbledhjes së Palëve pas asaj në të cilën ata janë emëruar;

(g) Komiteti duhet të mblidhet të paktën një herë në mes të Mbledhjeve të Palëve, zakonisht në selinë e Sekretariatit;

(h) Sekretari për Komitetin do të sigurohet nga Sekretariati i Marrëveshjes;

(i) Sekretariati do t'i informojë të gjitha Palët për datën dhe vendin e mbledhjeve të Komitetit të Përhershëm;

(j) Komiteti do të hartojë dhe miratojë rregulloren e vet të brendshme.

3. *Kërkon* nga Sekretariati të parashikojë në buxhetet e ardhshme, sipas kërkesës, pagesën e shpenzimeve të arsyeshme dhe të justifikueshme të udhëtimit të anëtarëve të emëruar të Komitetit të Përhershëm nga vendet në zhvillim dhe vendet me ekonomi në tranzicion, brenda politikës së dakordësuar nga Mbledhja e Palëve. Në këtë aspekt:

(a) Anëtarët duhet të bëjnë çdo përpjekje për t'i paguar shpenzimet e tyre të udhëtimit;

(b) Sekretariati mund t'i kompensojë Kryetarit të Komitetit të Përhershëm të gjitha shpenzimet e arsyeshme dhe të justifikueshme të udhëtimit për udhëtime të ndërmarra në emër të Mbledhjes së Palëve ose në emër të Sekretariatit;

(c) Organizimet e udhëtimit për anëtarët e sponsorizuar të Komitetit të Përhershëm do të bëhen nga Sekretariati në përputhje me rregullat dhe rregulloret e Kombeve të Bashkuara dhe, kur është e zbatueshme, kërkesat për rimbursim duhet të mbështeten me fatura, dhe të dorëzohen në Sekretariat brenda 30 ditëve pas përfundimit të udhëtimit;

4. *Kërkon* nga Palët Kontraktuese të sigurojnë ndihmë financiare për vendet në zhvillim dhe vendet me ekonomi në tranzicion që janë Palë në këtë Marrëveshje që të përfaqësohen në mbledhjet e Komitetit të Përhershëm me një vëzhgues.

ANEKSI 3.3

Rezoluta 5.8 e Takimit të Palëve të Memorandumit EUROBATS (Lubjanë, 2006) Krijimi i një Komiteti të Përhershëm të Marrëveshjes

Mbledhja e Palëve të Marrëveshjes për Mbrojtjen e Popullatave të Lakuriqëve të Natës në Europë (këtej e tutje "Marrëveshja"),

Duke vënë në dukje se me zgjerimin e konsiderueshëm të Marrëveshjes, për Komitetin Këshillimor të Marrëveshjes është bërë i vështirë trajtimi i çështjeve administrative dhe shkencore me një kosto dhe punë efektive,

Duke konsideruar dobinë e një organi të vogël të përhershëm këshillues për çështje buxhetore dhe çështje të tjera administrative që kanë të bëjnë me zbatimin e vazhdueshëm të Marrëveshjes,

Duke theksuar nevojën për transparencë në funksionimin e një organi të tillë,

1. Vendos të themelojë një Komitet të Përhershëm të Takimit të Palëve, i cili, në emër të Takimit të Palëve, dhe brenda politikës së dakordësuar nga Takimi i Palëve, duhet:

   (a) Të kryejë, ndërmjet një mbledhjeje të Takimit të Palëve dhe mbledhjes së ardhshme, aktivitete të përkohshme që mund të jenë të nevojshme për të zbatuar vendimet e Mbledhjes;

   (b) Të monitorojë zbatimin e buxhetit të Sekretariatit;

   (c) Të mbikqyrë zbatimin e politikave nga ana e Sekretariatit;

   (d) Të ofrojë udhëzime dhe këshilla për Sekretariatin në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes, përgatitjen e mbledhjeve, dhe çështje të tjera të sjella tek ai nga Sekretariati;

   (e) Të përfaqësojë, kur duhet, interesat e Takimit të Palëve përballë Qeverisë së vendit ku ndodhen selitë qendrore të Sekretariatit, PKBM-s dhe organizatave të tjera ndërkombëtare për shqyrtimin e çështjeve që lidhen me Marrëveshjen dhe Sekretariatin e saj;

   (f) Të kryejë çdo funksion tjetër që mund t'i caktohet nga Takimi i Palëve; dhe

   (g) Të dorëzojë nëpërmjet Kryetarit të saj në çdo takim të zakonshëm të Takim të Palëve një raport për punën e vet të kryer që nga takimi i mëparshëm i zakonshëm, duke përfshirë rekomandimet në lidhje me rolin dhe funksionimin efektiv të saj;

   (h) Të japë rekomandime, siç duhet, për shqyrtim në takimin e ardhshëm të Palëve.

2. Përcakton parimet e mëposhtme për funksionimin e Komitetit të Përhershëm;

   (a) Komiteti do të përbëhet nga jo më shumë se shtatë Palë, dhe do të përfshijë një përfaqësues nga Qeveria Depozituese, Qeveria Pritëse e Sekretariatit dhe pesë anëtarë të zgjedhur, të cilët do të emërohen nga çdo Mbledhje e Palëve, duke marrë në konsideratë shpërndarjen gjeografike;

   (b) Palët që nuk janë anëtare të Komitetit të Përhershëm mund të marrin pjesë në takim, dhe mund të marrin pjesë në diskutime në çfarëdo mënyre të kërkuar, por nuk mund të votojnë;

   (c) Komiteti mund të ftojë çdo organ ose organizatë që e konsideron që ka lidhje me funksionet

e saj, të marrë pjesë në mbledhjet e saj në mënyrë të vazhdueshme ose për çështje të caktuara, si vëzhgues.

(d) Komitetit do të krijojë rregulloren e vet të brendshme, e cila duhet të aprovohet nga një shumicë prej të paktën 2/3 e Palëve;

(e) Sekretari i Komitetit do të sigurohet nga Sekretariati i Marrëveshjes.

3. Udhëzon Sekretariatin:

(a) Të informojë të gjitha Palët mbi datën dhe vendin e mbledhjes së Komitetit të Përhershëm dhe aktivitetet e tjera, dhe të sigurojë shpërndarjen e dokumenteve të punës të gjitha Palëve në të njëjtën kohë me Komitetin e Përhershëm për t'u shqyrtuar prej tyre;

(b) Të bëjë përpjekje, sa të jetë e mundur, për të marrë fonde të jashtme për shpenzime udhëtimi të justifikueshme dhe të arsyeshme për anëtarët e zgjedhur nga Palët me ekonomi në tranzicion dhe për jo më shumë se një përfaqësues nga një Palë e tillë për vetëm një takim të Komitetit të Përhershëm;

(c) T'i rimbursojë Kryetarit të Komitetit të Përhershëm të gjitha shpenzimet e udhëtimit të arsyeshme dhe të justifikueshme për ato udhëtime të ndërmarra në emër të Konferencës së Palëve ose në emër të Sekretariatit;

4 Takimet e Organeve Vendim – marrëse të Familjes CMS

"Gjatë Takimeve të Familjes CMS unë për-jetoj fuqinë frymëzuese të bashkëpunimit ndërkufitar. Atë ndjesi dua t'ua përcjell kolegëve të mi në shtëpi."

Nancy Céspedes si Kryetare e Delegacionit në Mbledhjet e CMS-së

Ky Kapitull synon të mbështesë PKP-të në përmbushjen e roleve dhe përgjegjësive të tyre në lidhje me Konferencën e Palëve (KP), Mbledhjen e Palëve (MP), Mbledhjen e Firmëtarëve (MF), organet vendim-marrëse dhe mbledhjet ku negociohen instrumente të reja.

Specifikisht, ky kapitull reflekton çfarë duhet të bëhet:

- Para Takimit (Paragrafi 4.1)
- Gjatë Takimit (Paragrafi 4.2)
- Ndjekja (Paragrafi 4.3)
- Takimet Negociuese (Paragrafi 4.4)

Teksa Shtetet Anëtare krijojnë organet vendim-marrëse, janë përfaqësuesit e tyre të cilët marrin pjesë në këto proçese, së bashku me vëzhguesit pa të drejtë vote (p.sh përfaqësues nga shtete jo Palë dhe OJQ-ve).

Mbledhjet e organeve vendim-marrese përcaktojnë rrugetimin e instrumentit për vitet e ardhshme – cikli i mbledhjeve është zakonisht tre ose katër vjet. Detyrat e këtyre mbledhjeve mund të përfshijnë marrëveshjet për buxhetet, ndryshimin e listave të specieve, marrëveshjet mbi rezolutat e politikave dhe miratimin e planeve të mbrojtjes dhe atyre strategjike. Vendimet e marra kanë një ndikim të madh në drejtimin e ardhshëm të instrumenteve dhe mund të kenë pasoja të konsiderueshme për Shtetet Anëtare, dhe në veçanti për zyrtarët që janë përgjegjës për zbatimin e politikave.

Në fund të fundit, PKP-të thjesht do të informohen për mbledhjet; por është gjithashtu e mundshme që ata të kenë një rol më aktiv. Në përgjithësi, është detyra e tyre për të qenë të përditësuar me aktivitetet e organeve dhe për t'u koordinuar, sipas rastit, me kolegët brenda administratës së tyre kombëtare, para mbledhjes dhe të ndjekin hap pas hapi dhe të shpërndajnë rezultatet e mbledhjeve të tilla.

Përfaqësues nga jo-Palët mund të marrin pjesë në mbledhjet e organeve vendim-marrëse si vëzhgues, në shumë raste si një pararendje e aderimit.

4.1 Përpara Takimit

4.1.1 Përgatitja për Thelbin

Një takim i suksesshëm mund të arrihet përmes përgatitjeve të duhura të ndërrmara nga organizatorët e takimit si dhe pjesëmarrësit, përgjatë gjithë proçesit.

Në varësi të ciklit të takimit të çdo instrumenti, Sekretariati/Njësia Koordinuese njofton Shtetet Anëtare të saj për detajet e çdo mbledhje me anë të një ftese, si dhe duke shpërndarë një draft axhendë dhe informacione të tjera përkatëse.

Formulimi i draft axhendës është një element shumë i rëndësishëm në përgatitjen e takimit sepse ai përcakton objektivat. Proçesi i këshillimit mbi axhendën, i cili është lehtësuar si rregull përmes Komitetit të Përhershëm ose organit ekuivalent, u ofron Shteteve Anëtare mundësinë për të sjellë çështje në vëmendjen e komunitetit ndërkombëtar.

Përparësitë e Shteteve Anëtare për sa i përket specieve, çështjeve të reja mbi mbrojtjen dhe politikat e ardhshme të lidhura me to, duhet të përcaktohen me anë të një rishikimi të planit kombëtar të zbatimit (PKZ) në përgatitjen e raportimeve në mbledhje {→ shih Paragrafin 5.2.4}. Raportet kombëtare duhet në fakt të përgatiten dhe të dorëzohen përpara takimeve, të tilla si KP-ja * {→ shih Kapitullin 6 për më shumë hollësi mbi proçesin e Raportimit Kombëtar.}

Në varësi të instrumentit, statusit dhe proçedurat e tij ligjore, këto përparësi mund të formulohen dhe të paraqiten ose nëpërmjet propozimeve formale (p.sh ndryshimin e fushëveprimit të instrumentit përsa i përket specieve/hapësirës gjeografike ose çështjeve proçeduriale dhe prioritizimin e planit të tij të punës) ose thjesht duke informimuar Sekretariatet ose Njësitë Koordinuese. Nëse ekziston një problem mbi të cilin një Shtet Anëtar ka një interes të veçantë, atëherë kjo do të merret në konsideratë përmes mbajtjes së një mbledhjeje.

Është i rëndësishëm të qënit i mirë informuar në lidhje me rregullat mbi të cilat drejtohet takimi – Rregullat Proceduriale – të tilla si afatet për dorëzimin e amendamenteve në tekstin e instrumentit dhe anekseve ose shtojcave të tij dhe projekt vendimet mbi çështjet e reja që dalin. Për shembull, propozimet për amendimet në tekst dhe shtojcat e CMS-së duhet të dorëzohen në sekretariat 150 ditë para Konferencës së Palëve ndërsa për projekt-rezolutat afati është 60 ditë. Dispozita dhe afate të ngjashme ekzistojnë gjithashtu për shumicën e Marrëveshjeve në kuadrin e CMS-së dhe Takimit të Palëve – me disa përjashtime: sepse në rastin e Memorandumit mbi Mbrojtjen e Shpendëve Shtegtarë Afrikano-Euroaziatikë (AEWA), për shembull, afati komunikohet para çdo takimi përmes një njoftimi nga Sekretariati.

* Në rast se një raport nuk është dorëzuar, Sekretariatet / Njësia Kordinuese e Familjes CMS do të dërgojë rikujtesa. Një përmbledhje e raportit të dorëzuar (ose jo) do të publikohet më tej në analizën e raporteve kombëtare në CMS, shih psh atë vitit 2011, f 2-3 (Analiza e Raporteve Kombëtare për CMS 2011 - UNEP / CMS / CONF.10.11, Aneksi I).

4.1.1.1 Këshillimi Kombëtar

Këshillimi në nivel kombëtar, në kontekstin e një Proçesi Kombëtar Këshillimi të përcaktuar (atje ku ekziston) dhe/ose përtej faktit nëse konsiderohet i nevojshëm, është jetik gjatë gjithë proçesit përfshirë shqyrtimi i axhendës dhe deri në formulimin e dokumenteve mbi qëndrimet në mbledhje {→ shih Paragrafin 5.2.3}. Eshtë shumë e rëndësishme për të siguruar një pjesëmarrje efektive të të gjithë grupeve të interesit në nivel kombëtar veçanërisht në formulimin e projekt rezolutave dhe propozimeve të specieve. {→ shih Shembullin Praktik 4.1}

Pasi është arritur një qëndrim kombëtar mbi një çështje të caktuar, rekomandohet që proçesi i këshillimit të zgjerohet në mënyrë që të përfshihen aktorë të tjerë të përshtatshëm të nivelit rajonal dhe ndërkombëtar. Përgatitjet rajonale bashkëpunuese me shtetet dhe organizatat që punojnë për të njëjtën çështje, shpesh ndihmojnë që të prodhojnë moment politik pozitiv, shtojnë ndikimin mbi përpjekjet dhe shmangin një punë të panevojshme të dyfishtë.

Nxitja e një shpërndarjejë më të gjerë dhe kërkimi i komenteve dhe rekomandimeve nga Komitetet e Përhershme të instrumentit dhe organeve të tyre këshillimore do të ndihmonte në informimin e asaj pjese të interesuar të mbi instrumentin, dhe delegati ose delegacioni do te ketë një propozim të mirë negociuar i cili do të kërkonte më pak diskutim dhe përpunim gjatë mbledhjes.

4.1.1.2 Propozimi i Specieve

Disa nga instrumentet e CMS-së kanë zhvilluar modelet e tyre për propozimin e specieve të cilat janë përgjithësisht në përputhje me atë të CMS-së. Elementet kryesore të propozimit janë një përshkrim i përhapjes gjeografike, përfshirë sjelljen dhe rrugët e shtegtimit, të dhënat sasiore dhe cilësore të popullsisë, habitatet dhe kërcënimet. Një komponent i rëndësishëm i propozimit është një përmbledhje e shkurtër e komenteve të ofruara nga ekspertët dhe autoritetet e Shteteve Shtrirëse. Modeli-Tip i CMS-së mund të gjendet në {→ Aneksi 4.1}.

4.1.1.3 Vendimet

Rezolutat apo vendimet janë të strukturuara në paragrafët hyrës, paragrafët operative dhe Anekset. Paragrafët hyrës ofrojnë informacion mbi temën dhe lidhin vendimin me dispozitat ekzistuese dhe proçeset mbi të njëjtën çështje ose mbi një të ngjashme.

Një shembull i saktë i një Rezolute Konference CMS është bashkangjitur në {→ Aneksi 4.2}.

SHEMBULL PRAKTIK 4.1

Paraqitja me sukses e një rezolute para KP-së të CMS-së – Rezoluta e Australisë 10.4

Paraqitja e suksesshme e Rezolutës së Australisë 10.4 për Mbetjet e Ngurta Detare paraqet një proçes zhvillimi, efektiv dhe hap-pas-hapi, të propozimit dhe paraqitjes së një rezolute para Konferencës së Palëve të CMS-së.

Si hap të parë, Australia filloi duke mbledhur mbështetje kombëtare dhe ndërgjegjësimi përmes një plani kombëtar veprimi në adresimin e çështjes; përmes zhvillimit të Planit 2008 *Mbi uljen e rrezikut të ndikimeve të mbetjeve te ngurta detare në jetën e specieve vertebrore detare.*

Pas fillimit të një reagimi kombëtar, Australia kërkoi një qasje ndër-kufitare duke bërë të njohur faktin se mbetjet e ngurta detare kërcënojnë jetën detare dhe speciet shtegtare të tilla si breshkat, cetacetë, peshkaqenët dhe shpendët. Ajo vazhdoi duke paraqitur vullnetarisht një projekt-rezolutë në dy takime, në takimin e 16të të Këshillit Shkencor të CMS-së në Qershor 2010 dhe në takimin e 37të të Komitetit të Përhershëm në Nëntor 2010. Këshillimi me Komitetin e Këshillit Shkencor dhe Komitetin e Përhershëm ishte i volitshëm për të mundësuar njësitë e Familjes së CMS-së të njiheshin me tekstin, të diskutonin çështjen dhe të bënin komente dhe rekomandime shumë kohë përpara Konferencës së Palëve.

Dy muaj para Konferëncës së 10të të Palëve, Australia paraqiti Rezolutën e rishikuar e cila kaloi me sukses. Rezoluta tashmë kishte marrë përkrahjen dhe kontributin e Sekretariatit CMS dhe organeve të linjës të CMS-së, dhe Australia demonstroi aftësinë e saj për të udhëhequr në mënyrë të kordinuar mbi këtë çështje.

Një mësim i përftuar nga ky rast studimi është rëndësia e zhvillimit të një këshillimi të gjerë që përfshin edhe organet që kanë lidhje me CMS-në. Pjesëmarrja e këtyre organeve do të thotë se rezoluta merr më pak diskutim dhe përpunim gjatë vetë Konferencës së Palëve, dhe përfshin në mënyrë strategjike organe të ndryshme të CMS-së në proçesin e zhvillimit dhe mbështetjes së nismës.

Shtetet e tjera Anëtare në mënyrë të ngjashme mund të propozojnë çështje dhe specie të reja për t'u diskutuar në mbledhje. Më tej, tema të caktuara si çështjet buxhetore dhe financiare janë gjithmonë në axhendën e këtyre takimeve dhe projekt-vendimet përgatiten normalisht nga Sekretariatet/Njësitë Koordinuese.

Prandaj është e rëndësishme që PKP-të të familjarizohen me të gjitha çështjet në proçes negocimi, përtej atyre që propozojnë vetë, dhe për këtë arsye të kontrollojnë dokumentacionin e gatshëm të mbledhjes të postuar në faqet e internetit të instrumenteve.

Përcaktimi i qëndrimit të një Shteti Anëtar për të gjitha çështjet nën diskutim në një mbledhje përfshin si rregull një proçes koordinues gjithëpërfshirës në varësi të strukturës së tij qeveritare dhe proçedurave kombëtare. Kjo shpesh konsumon shumë kohë dhe për këtë arsye rekomandohet që PKP-ja ta mbikëqyrë këtë proçes dhe të sigurojë që të fillojë mjaft kohë përpara mbledhjes.

4.1.1.4 Këshillime Rajonale

Është e rekomandueshme parapërgatitja e letrave të pozicionimit, të cilat janë mjete shumë të dobishme për delegatët në këtë mbledhje pasi ata duhet të deklarojnë qartësisht propozimet për veprimet që duhet të ndërmerren. Qëndrimet e koordinuara në nivel rajonal, si nëpërmjet deklaratave apo propozimeve të përbashkëta, mund të jenë gjithashtu të vlefshme. Një qëndrim rajonal i dakordësuar mund të ketë më shumë peshë në negociata dhe mundëson Shtetet Anëtare të marrin pjesë në mënyrë më frytdhënëse. Koordinimi Rajonal kërkon që letrat e pozicionimit të ndahen dhe konsultimet të mbahen kohë përpara takimeve. Dallimet gjuhësore brenda rajoneve duhet të merren parasysh. Mbledhjet rajonale koordinuese financohen në përgjithësi nga vetë rajonet dhe për këtë arsye varen nga mundësimi i fondeve. Ndonjëherë, këto takime organizohen me mbështetjen e Sekretariatit/Njësisë Koordinuese. Megjithatë, një përdorim më i plotë i mjeteve elektronike të komunikimit, mund të bëjë që këshillimet të realizohen në distancë. Megjithatë, me një qasjen më të madhe në mjetet elektronike të komunikimit, konsultimet mund të realizohen në distancë.

Përfaqësimi i qeverisë në takim duhet të përzgjidhet në mënyrë strategjike në varësi të çështjeve që do të negociohen dhe nivelin e përvojës së kërkuar për të lobuar mbi qëndrime të caktuara.

4.1.2 Përgatitja për Logjistikën

Roli i PKP-ve përfshin lehtësimin e proçesit organizativ, në aspektin e përgatitjes logjistike, në një mbledhje ku marrin pjesë delegacionet. Ftesa zyrtare nga Sekretariati/Njësia Koordinuese që njofton Shtetet Anëtare mbi mbledhjen, përmban informacione në lidhje me datën dhe vendin e takimit, si dhe hollësi të tjera, si afatet dhe proçedurat e regjistrimit.

Përgatitja në kohë mund të sigurojë respektimin e afateve të mundshme të financimit dhe përgatitjen e dokumenteve të nevojshme, si dhe mund të garantojë pjesëmarrjen e plotë të delegacionit, duke përfshirë ushtrimin e të drejtës së votës.

4.1.2.1 Përbërja e Delegacioneve

Një delegacion mund të përshkruhet si personi ose personat që përfaqësojnë zyrtarisht një vend në një takim. Ai mund të përbëhet nga një përfaqësues i vetëm prej një Shteti Anëtar, por mund të përfshijë edhe përfaqësues alternativë dhe këshilltarë. Çdo vend do të ketë proçedurat e veta në përzgjedhjen e individëve për delegacionin e tij. Si personi me njohjen më të thellë dhe më i përditësuari mbi instrumentin, PKP-ja zakonisht përfshihet në delegacionin kombëtar, ndonëse një koleg me pozicion më të lartë mund të emërohet "Kryetar i Delegacionit" kur këto takime trajtojnë politikat e përgjithshme. Për më tepër, PKP-ja është mjaft i rëndësishëm në këshillimin e pjesës tjetër të delegacionit. PKP-ja duhet të shqyrtojë në një fazë të hershme nëse delegatëve u takon e drejta e financimit për pjesëmarrje në mbledhjen në fjalë. Rekomandohet që PKP-ja të fillojë të koordinojë shumë kohë përpara mbledhjes se kush duhet të jetë në delegacion.

Duke pasur parasysh përbërjen e delegacionit, PKP-ja duhet të marrë në konsideratë:

- Llojin dhe nivelin e ekspertizës së kërkuar për shqyrtimin e temave të axhendës dhe prioritetet e tyre për Shtetin Anëtar;
- Ministritë të cilat, në përputhje me politikat kombëtare, mund të kenë nevojë për t'u përfaqësuar në mbledhje.

Koordinimi i nevojave organizative të Delegacionit përfshin disa aspekte, siç tregohet më poshtë në {→ Figura 4.1}

Figura 4.1 Përgatitja e Takimit

4.1.2.2 Financimi

PKP-ja duhet të kontrollojë paraprakisht në kohë nëse vendi i tyre përfiton të drejtën e financimit që një përfaqësues të marrë pjesë në një takim. Kriteret e përfitimit të financimit përcaktohen zakonisht nga vendimet buxhetore të organit vendim-marrës. Sidoqoftë, mund të aplikohen dhe kritere të mëtejshme dhe për këtë arsye, PKP-të kanë një shans më të madh suksesi në qoftë se ata përgatisin kriteret e aplikueshme për financim para çdo takimi.

Sekretariati/Njësia Koordinuese si rregull do të marrin masa që delegatët e sponsorizuar të pajisen me një biletë vajtje-ardhje për të marrë pjesë në mbledhje si dhe me pagesën e një "Diete Ditore" për të mbuluar fjetjen dhe ushqimin. Nivelet e dietave ndryshojnë nga qyteti në qytet dhe nga shteti në shtet.

Delegatët jo-të sponsorizuar janë vetë përgjegjës për marrjen e masave të udhëtimit të tyre dhe rezervimeve për fjetje, por Sekretariati /Njësia Koordinuese shpesh do të ofrojë një listë hotelesh të përshtatshme.

Informacioni përkatës mbi detajet e çdo mbledhje përfshihet në njoftimin zyrtar i cili i dërgohet Shtetit Anëtar prej Sekretariatit/Njësisë Koordinuese.

4.1.2.3 Regjistrimi Paraprak

Regjistrimi paraprak i pjesëmarrësve zakonisht nuk ndjek një afat strikt. Megjithatë regjistrimi i hershëm vlerësohet nga organizatorët e takimit. Sidoqoftë për pjesëmarrësit që kërkojnë financim ka afate fikse. Pas këtij afati, regjistrimi për delegatë të tillë është ende i mundur, por financimi mund të mos jetë më i mundur. Sekretariati i CMS-së ka krijuar një sistem online të regjistrimit paraprak për të mbuluar të gjitha mbledhjet e organizuara nga Familja* e CMS-së. Këtu PKP-së i kërkohet të përzgjedhë takimin e saktë nga një listë e dhënë dhe të regjistrojë informacione, të tilla si emri, disa të dhëna personale (data e lindjes, numri i pasaportës dhe data e skadimit), detaje të kontaktit, dhe përkatësinë e delegatëve.

Një risi e fundit është një sistem online i regjistrimit. Delegatët duhet të kenë akses të qëndrueshëm në internet që të jenë në gjendje ta përdorin sistemin.

4.1.2.4 Kredencialet

Kredencialet për delegacionet kombëtare në Konferencat e Palëve dhe Mbledhjet e Palëve duhet të nënshkruhen nga Kreu i Shtetit, Kreu i Qeverisë ose Ministri i Punëve të Jashtme, ndërsa kredencialet për Mbledhjen e Shteteve Nënshkruese mund të siglohen nga ministri i linjës (për delegacionet që përfaqësojnë organizata të integrimit ekonomik rajonal ekzistojnë marrëveshje të veçanta). Kredencialet duhet të nënshkruhen dhe të vulosen dhe të përmbajnë emrat e delegatëve zyrtarë të Palës, të cilët do të përfaqësojnë qeverinë (ku të specifikohet kryesuesi i delegacionit). Kredencialet i japin fuqi delegacionit të marrë pjesë aktive në mbledhje dhe të diskutojë mbi të gjitha çështjet dhe të votojë në emër të Ministrisë përkatëse. Një kopje e letrës së kredencialeve mund të kërkohet para kohe nga delegatët që kërkojnë financim për pjesëmarrje. Origjinali duhet të dorëzohet pranë Sekretariatit/Njësisë Koordinuese në fillim të mbledhjes, i hartuar në një nga gjuhët e instrumenteve (ose në një gjuhë tjetër shoqëruar me përkthim zyrtar), i cili më pas do të rishikohet ose nga Sekretariati/Njësia Koordinuese ose nga një komitet kredencialesh i përbërë nga përfaqësues shtetesh. Sekretariati/Njësia Koordinuese ofron zakonisht modele për një letër kredencialesh.

Është e rëndësishme që PKP-ja të lehtësojë proçesin e pajisjes së delegacionit me kredencialet e duhura. Përndryshe, përfaqësuesit do të njihen vetëm si vëzhgues në mbledhje.

* http://www.unep-cms.com/cms_v2/default.aspx

Akte formale për negocimin apo nënshkrimin e instrumenteve të reja, të tilla si Memorandume Mirëkuptimi ose Marrëveshjet, kërkojnë autorizim shtesë të njohur si "fuqi plotë", që tregon se personi është i autorizuar për të nënshkruar dhe/ose për të negociuar instrumentin. Është e rëndësishme të theksohet dallimi midis "kredencialeve" dhe "fuqiplotshmërisë".

Kompetenca të plota:

- të emërojë një përfaqësues i cili do të nënshkruajë ose do të negociojë instrumentin, **dhe**
- për instrumente ligjërisht të detyrueshme - duhet të jetë lëshuar dhe nënshkruar nga Kreu i Shtetit ose i Qeverisë ose Ministri i Punëve të Jashtme, **ose**
- për instrumenta pa detyrime ligjore - duhet të lëshohet dhe nënshkruhet nga ministri përkatës.

4.1.2.5 Vizat

Ftesat nga Sekretariatet/Njësitë Koordinuese gjithashtu japin informacion në lidhje me kërkesat për t'u pajisur me vizë për të hyrë në vendin ku mbahet mbledhja. Çdo anëtar i delegacionit ftohet të aplikojë për vizë në kohën e duhur dhe është e rëndësishme që PKP-ja të lehtësojë proçesin. Sekretariatet/Njësitë Koordinuese lehtësojnë lëshimin e vizave, duke u dhënë delegacioneve të vendeve dokumente mbështetëse për pajisjen me viza dhe duke informuar autoritetet përkatëse.

KËSHILLA TË VLEFSHME 4.1

- Delegatët mund të dëshirojnë të mbajnë me vete kopje të dokumenteve më të rëndësishme të tyre, sepse kopjet fizike të të gjitha dokumenteve përkatëse mund të mos jenë të disponueshme në çdo mbledhje. Rekomandohet që takimet të jenë sa më "pa letër" që të jetë e mundur , dhe të punohet me dokumente online, të arritshme me anë të WIFI që sigurohet në ambientet e takimit për të gjithë pjesëmarrësit.
- Njohuri të forta të Rregullave të Procedurës mund të nxisin pjesëmarrjen efektive në një mbledhje.
- Disa organizata sigurojnë gjatë negociatave një shërbim raportimi që mund të ndihmojë delegatët të jenë të përditësuar me të gjitha çështjet në proçes negocimi (p.sh. Buletini Negociatave IISD të Tokës- http://www.iisd.ca).
- Palët mund të angazhojnë ekspertë ose konsulentë për të dhënë këshilla teknike për çështje të veçanta në delegacionin e tyre.
- Mund të frekuentohen mbledhje të njëpasnjëshme të instrumenteve të ndryshme ose CMS-së, por kjo kërkon përgatitje dhe koordinim të mëtejshëm nga PKP-të përkatëse dhe zyrtarëve të tjerë që marrin pjesë.

4.2 Në Takim

4.2.1 Regjistrimi dhe Kredencialet

Në ditët e para të mbledhjes, normalisht në hollin e vendit të punës, organizatorët do të krijojnë një Këndi Pritje, ku delegatët që janë regjistruar paraprakisht për pjesëmarrje në mbledhje, mund të tërheqin paketat dhe distinktivat e tyre si delegatë. Delegatët e Shteteve Anëtare duhet gjithashtu të dorëzojnë kredencialet e tyre (dokumentet që provojnë autoritetin e delegatëve për të përfaqësuar vendin e tyre në mbledhje), të cilat shqyrtohen më pas.

4.2.2 Gjatë Takimit (në sesion)

Meqënëse mbledhja e organit vendim-marrës është faza e fundit e negociatave, delegatëve u kërkohet gjatë këtyre mbledhjeve të kontribuojnë aktivisht në të gjitha forumet negociuese. Negociatat gjatë mbledhjeve të organeve vendim-marrëse synojnë të arrijnë marrëveshje pozitive në lidhje me probleme që lindin midis Shteteve Anëtare. Po kështu, mbledhja e organit vendim-marrës ofron një mundësi për të shprehur, mbështetur, kundërshtuar apo për të propozuar ndryshime në projekt-rezoluta dhe vendime. Gjatë mbledhjes së organit vendim-marrës Shtetet Anëtare shkëmbejnë mendime dhe përpiqen të zhvillojnë një tekst të projekt-rezolutës /vendimit për të cilin bien dakord të gjithë pjesëmarrësit.

4.2.2.1 Kryerja e Ndërhyrjeve dhe Deklaratave gjatë Takimeve

Gjatë një mbledhjeje, delegatët ftohen të japin deklarata dhe të bëjnë ndërhyrje {→ shih Shembullin Praktik 4.2}. Në kontekstin e këtij Manuali, deklaratat janë konceptuar si "raporte" që përshkruajnë përparësitë e plota të çështjeve kyçe dhe që ofrojnë një tregues të përgjithshëm të temave mbi të cilat do të kryhet një debat thelbësor. Ndërhyrjet nga ana tjetër janë reagimet ndaj një diskutimi që ndodh gjatë mbledhjes dhe që paraqesin qëndrimin e qartë të delegacionit së bashku me një arsyetim bindës. Është e rëndësishme që ndërhyrjet në një mbledhje të bëhen vetëm sa herë është e nevojshme për të arritur një rezolutë ose një vendim lidhur me një çështje në përputhje me mandatin e delegacionit.{→ shih Këshilla të Vlefshme 4.2 dhe 4.3}

KËSHILLA TE VLEFSHME 4.2

Për të dhënë një deklaratë të kënaqshme:

- Formulojeni të shkurtër dhe të qartë. Jini të sjellshëm, por tregohuni të qartë në pikat tuaja. Nëse në mbledhje ka përkthim, atëherë flisni ngadalë mjaftueshëm që përkthyesit të mbajnë të njëjtin ritëm me ju. Nëse ka një afat kohor për deklaratat, përmbajuni këtij afati.
- Shmangni deklaratat e përgjithshme. Përmbajuni pikës së axhendës. Synoni propozim konkret për veprim.
- Përgatisni kopje të deklaratës tuaj dhe vendosini në dispozicion të delegatëve, përkthyesve dhe Sekretariatit/ Njësisë Koordinuese.
- Mendoni për avantazhet dhe disavantazhet e bërjes së një deklarate. Shpesh herë mund të bisedosh me delegatët.

Paraqitja e deklaratave të përbashkëta në mbledhje ose qarkullimi i dokumenteve mbi qëndrime të përbashkëta, mund të ketë ndikim në negociata dhe është një formë për shprehje solidariteti.

KËSHILLA TE VLEFSHME 4.3

Një ndërhyrje e mirë:

- është konçize dhe me fjalë të ngadaltë
- ofron qëndrimin e delegacionit tuaj në mënyrë të qartë sikurse me një arsyetim bindës;
- siguron gjuhë të saktë në formulime në termat më të thjeshta të mundshme;
- punon në masën më të mundshme me gjuhën aktuale; dhe
- shmang ri-hapjen e çështjeve që janë lënë mënjanë

SHEMBULL PRAKTIK 4.2

Deklarata e Armenisë në Seancën Plenare të Konferencës së Palëve të CMS-së, Bergen, 2011

I nderuar Kryetar, Të nderuar pjesëmarrës në Konferencën e 10të të Palëve,

Në emër të Qeverisë së Republikës së Armenisë, unë e mirëpres këtë mbledhje të përfaqësuesve në Konferencën e 10të të Palëve. Unë jam i lumtur t'ju informoj se në vitin 2010 vendi ynë ka ratifikuar Konventën për Mbrojtjen e Specieve Shtegtare të Kafshëve të Egra, e cila ka hyrë në fuqi në Armeni më 1 Mars 2011.

Armenia si pjesë e rajonit Euro–Kaukazian, që karakterizohet nga një përfaqësim i lartë i diversitetit biologjik, thekson rëndësinë e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar dhe në këtë kuptim të gjitha mbledhjet dhe aktivitetet, të cilat kontribuojnë në rritjen e efikasitetit në mbrojtjen e mjedisit dhe ruajtjen e biodiversitetit përfshirë speciet e egra shtegtare.

Me anë të kësaj deklarate unë konfirmoj gatishmërinë dhe interesin e Republikës së Armenisë për të mbështetur mbrojtjen e specieve shtegtare të kafshëve të egra në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, si dhe për të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet e filluara në këtë kuadër.

Në emër të Qeverisë së vendit tim dhe njëherë do të doja të mirëprisja këtë takim të rëndësishëm dhe t'i uroj punë të frytshme, jo vetëm në lidhje me këtë, por edhe për aktivitete të tjera të mëtejshme që do të organizohen në kuadër të Konventës mbi Speciet Shtegtare.

Përfaqësuesi i Republikës së Armenisë

Pika Përfaqësuese e Konventës në Armeni

Z. Nalbandyan .....

Norvegji, Bergen

20 Nëntor 2011

.....

.....

Për të marrë fjalën në një mbledhje, një delegat duhet të ketë lejen nga Kryetari i saj. Një delegat ngre kartën me emrin e vendit të tij/të saj (nganjëherë quhet "flamuri"), për të kërkuar leje nga Kryetari për të marrë fjalën. Rregullorja Proçeduriale ndonjëherë parashikon që Kryetari i jep përparësi delegatëve të Palëve që dëshirojnë të flasin, pastaj jo-Palëve dhe në fund vëzhguesve të tjerë (p.sh. përfaqësuesve të OJQ-ve). Bazuar në një propozim nga një Shtet Anëtar ose Kryetari, organi vendim-marrës mund të vendosë të kufizojë kohën e lejuar për secilin folës, si dhe numrin e ndërhyrjeve që një përfaqësues mund të kryej.

Është kritike që delegatët t'i dëgjojnë me kujdes ndërhyrjet e të tjerëve dhe, sa më shumë të jetë e mundur, t'i mbështetësin ndërhyrjet që janë përgjithësisht në përputhje me qëndrimin e tyre në mënyrë që të arrihet mbështetje lidhur me propozimet e delegacionit të tyre. Në çdo ndërhyrje, është strategjike që të tregohet mbështetje për vendet e veçanta që kanë një qëndrim të përbashkët dhe, me anë të kësaj, të përmenden ku është e mundur vende nga rajone të ndryshme.

Delegatët duhet gjithmonë të jenë të përgatitur që do të thotë të njohin ndërhyrjen e tyre me imtësi, përfshirë

të gjitha qëndrimet ku mund të bëjnë lëshime, dhe të jenë të gatshëm t'u përgjigjen pyetjeve, formale apo informale, nga delegacionet e tjera. Ata duhet të këshillohen rreth temës me anëtarët e tjerë më të interesuar të delegacionit/ve dhe të marrin pikëpamjet e tyre mbi ndërhyrjen. Për më tepër, ndryshimet e mëdha në tekst kane nevojë për aprovim nga qeveria në vend. Për ndërhyrjet në formë reagimi në mes të një debati të nxehtë, është e rëndësishme të mbahen shënim pikat kryesore që duhet të trajtohen para se të ndërhyhet. Delegatët duhet gjithmonë të mbajnë me vete udhëzimet negociuese dhe shënimet sqaruese. Ata duhet të mësojnë mbi një forum të caktuar para se të vijnë (p.sh. objektivat, historinë dhe strukturat, aktorët kyç), dhe të kenë qasje në Rregulloren Proçeduriale në rast se janë të nevojshme. Nëse është e mundur, një delegat duhet të ketë edhe një anëtar të delegacionit me të cilin të konsultohet, dhe që mund të çojë shënime dhe projekt propozime në delegacionet e tjera {→ shih Këshilla të Vlefshme 4.1}

Kur paraqitet një deklaratë apo kryhet një ndërhyrjeje, e përbashkët ose jo, delegatët nuk duhet të pretendojnë që po flasin në emër të të gjithë Shteteve Anëtare në mbledhje nëse nuk është plotësisht e sigurtë që deklarata

mbështetet nga çdo Shtet Anëtar. {→ shih Paragrafin 4.1 Para Takimit dhe Paragrafin 2.3.1 Organet Vendim-marrëse}

4.2.3 Koordinimi Rajonal

Një veçori e KP-së të CMS-së, si një forum global, dhe e TP-vë të AEWA-s me mbulimin e vet të gjerë gjeografik, është koordinimi rajonal, që u jep mundësinë vendeve të të njëjtit rajon të cilët perballen me të njëjta probleme mjedisore dhe që preken nga të njëjtat specie shtegtare, për të krahasuar shënimet, shkëmbyer idetë, për të provuar të marrin qëndrime të përbashkëta dhe për të rënë dakord mbi përpjekje të bashkërenduara për të siguruar aprovimin e politikave përfituese. Veçanërisht delegacionet e vogla mund të përdorin koordinimin rajonal si një mjet për ndarjen e punës mes dy delegatëve që bien dakord të ndjekin Grupe Pune të ndryshme por që marrin përsipër të përfaqësojnë interesat e njëri tjetrit. Kjo nuk do të thotë që delegatët mund të bashkëpunojnë vetëm me delegatët e tjerë nga i njëjti rajon {→ shih Paragrafin 4.2.5 tek Grupet e Punës si më poshtë}.

Një rast i veçantë është Bashkimi Europian, e vetmja organizatë për integrim ekonomik rajonal (REIO) që është një Shtet Anëtar në një numër të instrumenteve të Familjes CMS. Delegacionet e vendeve të BE-së takohen rregullisht gjatë mbledhjeve që frekuentojnë për të koordinuar qëndrimet e tyre mbi çështjet në diskutim.

4.2.4 Komitetet

Përgjithësisht nuk është e mundur që Seanca Plenare (mbledhja e plotë) të merret me çdo aspekt të axhendës së mbledhjes. Është praktikë normale që t'u caktohen përgjegjësi për çështje të veçanta grupeve më të vogla që raportojnë gjetjet e tyre dhe japin rekomandime. Është praktikë e zakonshme krijimi i një Komiteti për të shqyrtuar "Kredencialet", dokumentet e siguruara nga Qeveritë e tyre si provë e autoritetit të delegatit për të përfaqesuar vendin në mbledhje {→ shih Paragrafin 4.1.2.4 dhe 4.2.1} dhe një Komitet tjetër për të shqyrtuar propozimet e buxhetit.

Siç shpjegohet më sipër {→ shih Paragrafin 2.3.1} Konferenca e Palëve të CMS-së vepron nëpërmjet një Seance Plenare vendim-marrëse e ndjekur nga të gjithë delegatët (me seancat në fillim të Konferencës së Palëve për zgjedhjen e nënpunësve dhe ngritjen e komiteteve dhe një seancë në fund për miratimin e Rezolutave) dhe një Komiteti të Përgjithshëm ku diskutohet në detaj aktiviteti i përgjithshëm i Konferencës dhe që mblidhet paralelisht me Komitetet dhe Grupet e tjera të Punës.

4.2.5 Grupet e Punës

Këto grupe pune zakonisht ngrihen për të shqyrtuar çështje të veçanta kyçe të axhendës. Pasi është prezantuar një çështje dhe i është dhënë mundësia delegacioneve për të deklaruar qëndrimin fillestar mbi këtë çështje, Kryetari mund të sugjerojë, me iniciativën e tij ose të saj, apo me kërkesën e një apo me shumë Shteteve Anëtare, që çështja në fjalë të analizohet më në hollësi në një grup pune. Kjo siguron që çështjet e rëndësishme të trajtohen me kujdes nga një grup i Shteteve Anëtare të interesuara dhe në të njëjtën kohë e lejon Kryetarin të kalojë në pikën tjetër të axhendës me mirëkuptimin që ai ose ajo t'i kthehet përsëri çështjes së prekur sapo grupi i punës të jetë gati t'i raportojë përsëri organit vendim-marrës ose organit vartës në fjalë.

Ndërsa grupet e punës janë pa një numër të përcaktuar, numri i pjesëmarrësve në grup, praktikisht, varion në varësi të numrit të Shteteve Anëtare të interesuara. Kryetari i Seancës Plenare shpesh emëron një Kryetar ose një Bashkë-Kryetar, nëse bëhet fjalë për një grup të madh apo një grup që merret me një çështje veçanërisht të vështirë, por ndonjëherë vetë Grupi e zgjedh një Kryetar nga vetë anëtarët e grupit. Nganjëherë anëtarësia e Grupeve është e kufizuar (si ato që merren me buxhetet); nganjëherë mund të marrë pjesë çdokush që ka interes mbi çështjen. Kryetari normalisht do të vendosë nëse Komitetet janë të hapura për vëzhguesit si edhe për delegatët votues.

Grupet e Punës përgjatë sesionit veprojnë vetëm brenda kohëzgjatjes së mbledhjes së organit vendim-marrës. Përveç një Kryetari, një anëtar i grupit caktohet si "raportues" për të prezantuar gjetjet dhe rekomandimet e Grupit në Seancën Plenare.

Disa çështje të rëndësishme nuk është e nevojshme të zgjidhen gjatë mbledhjes, dhe politikat mund të zhvillohen dhe zgjidhjet të gjenden gjatë një periudhë kohore më të gjatë. Në raste të tilla, mund të ngrihet një Grup Pune Ndërsesional që të punojë ndërmjet sesioneve të organit vendim-marrës.{→ shih Këshilla të Vlefshme 4.4}.

Atje ku nuk mund të arrihet konsensusi mbi një çështje të rëndësishme, thirren së bashku ato delegacione me qëndrime të kundërta të theksuara që të përpiqen të gjejnë një kompromis. Grupe të tilla njihen ndonjëherë si "Grupe Kontakti".

Për takimet e mëdha është krejt e mundur që disa Komitete dhe Grupe Pune që të mblidhen njëkohësisht.

KËSHILLA TË VLEFSHME 4.4

Debatet Ndërsesionale

Shpesh delegatëve do t'u kërkohet të punojnë gjatë mbledhjeve në kushte ku iu mungon gjumi, ushqimi, uji dhe komoditete të tjera. Sesionet gjatë gjithë natës janë tipike në prag të sesionit negociues përfundimtar, të cilat gjithashtu zhvillohen gjatë një takimi. Strategjia e vetme është të vish i përgatitur. Fillojeni ditën me një mëngjes të bollshëm sepse ky mund të jetë vakti juaj i vetëm i ditës. Gjithmonë duhet të jeni i pajisur me ushqime, pije, ilaçe, shami letre, monedha për automate ushqimi, dhe gjëra të ngjashme. Nëse nuk jeni i zënë në ndonjë grup pune të orëve të vona të natës, përpiquni të ndihmoni anëtarët e tjerë të delegacionit tuaj duke iu bashkuar atyre për t'iu dhënë mbështetje morale, si dhe ndihmë për përpilimin e drafteve dhe sjelljen e ushqimit. Gjithashtu kujtohuni të sillni një zyrë portative në takim. Ndonëse në takime delegatëve iu mundësohet qasje e limituar në pajisje dhe kompjuterë, ju mund të keni nevojë për kapacitete shtesë.

Kjo përbën një dilemë për vendet me delegacione të vogla ose me vetëm një përfaqësues, pasi është e pamundur për ta që t'i ndjekin të gjitha takimet. Në raste të tilla, është e rëndësishme të caktohen prioritete për të vendosur se cili Grup Pune përbën më shumë interes. Gjithashtu mund të jetë me vlerë të punohet në bashkëpunim me një vend tjetër që ndan të njëjtin qëndrim – jo domosdoshmërisht nga i njëjti rajon – ku delegati i një vendi të ndjekë Grupin e Punës X dhe delegati i një vendi tjetër të ndjekë Grupin e Punës Y, me të dy delegatët që mbrojnë interesat e njëri tjetrit {→ shih Paragrafin 4.2.3 Kordinimi Rajonal}.

4.2.6 Aktivitete Dytësore

Një tipar i rëndësishëm i mbledhjeve të organeve vendim-marrëse jashtë kuadrit të Seancës Plenare, Komiteteve dhe Grupeve të Punës janë aktivitetet dytësore më pak formale, që mbahen shpesh gjatë pushimeve të drekës apo në mbrëmje. Organizata të ndryshme bëjnë prezantimet e punës së tyre ose të kërkimeve dhe aktivitete të tilla japin mundësi për shkëmbim informacioni, për të drejtuar pyetje dhe për të vendosur kontakte. Çdokush mund të mësojë shumë duke ndjekur mbledhje të tilla si spektator por organizimi i një aktiviteti dytësor paraqet mundësinë për të shpalosur një projekt ose një problem dhe të sigurojë mbështetjen e një donatori të mundshëm apo OJQ-ve. Këto mbledhje janë mjete të shkëlqyera për të zbuluar se kush tjetër është i interesuar në çështje të ngjashme.

4.2.7 7 Koordinimi brenda Delegacionit

Gjatë mbledhjes së organeve vendim-marrëse, delegati duhet të përgatitet t'i raportojë pjesës tjetër të delegacionit, në mënyrë të qartë dhe konçize, mbi çdo zhvillim që rrjedh nga diskutimet e mbajtura në Koordinimin Rajonal, Komitetet, Grupet e Punës ose dhe në aktivitetet dytësore. Prandaj delegati duhet të mbajë shënime të detajuara, veçanërisht mbi negocimet për ndryshimet në tekst. Mbajtja e një informacioni të detajuar mbi çfarë ka ndodhur, e ndihmon delegatin të verifikojë saktësinë e versionit tjetër dhe të raportit final të takimit. Gjithashtu, mbajtja shënim se cilët delegacione dhe rajone kanë pasur pikëpamje të veçanta në mbështetje ose në kundërshtim me qëndrimin e vetë delegatit do të ndihmonte të dallohen me efektivitet ato delegacione që duhet të binden apo që mund të ofrojnë mbështetje. Këtu mund të bëhet një punë shumë e rëndësishme pa qenë fizikisht i pranishëm në mbledhje. {→ shih Paragrafin 4.3 Ndjekja}.

4.3 Ndjekja

Për shumicën e mbledhjeve zyrtare të instrumenteve të Familjes CMS, do të përgatitet një raport nga Sekretariati apo Njësia Koordinuese përkatëse dhe do të publikohet në faqen e saj të internetit. Raportet e mbledhjes duhet të shqyrtohen me kujdes. Sidoqoftë, raporti mund të kërkojë kohë të përfundohet, ndaj dhe PKP-të nuk duhet të presin publikimin e raporti që pastaj të fillojnë me proçesin e zbatimit. {→ shih Këshilla të Vlefshme 4.5}.

Si ndjekje e menjëhershme, madje dhe përpara publikimit të raportit, Shtetet Anëtare duhet të fillojnë zbatimin efikas të vendimeve të marra në mbledhje {→ shih gjithashtu Paragrafin 5.2}. Në rastin e Konferencës së Palëve të CMS-së, drafti i parë i raportit formulohet në sesione ditore dhe Rezolutat e miratuara shfaqen në faqen e internetit të CMS-së menjëherë pas përfundimit të Konferencës, sapo të përfundojë redaktimi final dhe të bëhen përkthimet në gjuhët e tjera zyrtare.

CMS-ja u lejon Palëve të përfshijnë rezervat e tyre në lidhje me mbrojtjen që u ofrohet specieve të listuara në Shtojcat. Ndryshimet në Shtojcat hyjnë në fuqi 90 ditë pasi KP-ja t'i ketë miratuar dhe Palët këtë periudhë e kanë në dispozicion për të paraqitur vërejtjet e tyre tek Depozituesi (Qeveria Gjermane). Në mënyrë të ngjashme, Palët në AEWA kanë 90 ditë kohë për të njoftuar Depozituesin (Qeverinë e Hollandës) mbi çdo rezervë që dëshirojnë të paraqesin për ndryshimet në anekset e Marrëveshjes. Mbledhja e parë e Shteteve

KËSHILLA TË VLEFSHME 4.5

Puna me Median

Gazetarë nga gazeta kombëtare dhe ndërkombëtare, televizione, dhe radio, si dhe përfaqësues nga media alternative, marrin pjesë në mbledhjet e mëdha ndër-qeveritare. Puna me Medianë (komunikatat për shtyp. kontaktet me ëgazetarët) mund të integrohen në strategjinë e përgjithshme të organizatës tuaj për të marrë pjesë në mbledhje dhe për të mobilizuar mbështetje publike mbi qëndrimin tuaj.

Nënshkruese të Memorandumit të Mirëkuptimit mbi Peshkaqenët miratoi një proçedurë për modifikimin e listës së specieve. (Aneksi 1).

Për të siguruar zbatim të plotë dhe në kohë të vendimeve të marra në mbledhje, rezultatet duhet t'u komunikohen autoriteteve përkatëse në nivel kombëtar gjatë ose direkt pas mbledhjes{→ shih Këshilla të Vlefshme 4.5}. Është gjithashtu e rëndësishme të përfshihen ministri dhe agjenci të tjera nëse ato do të përfshihen në zbatimin e vendimeve. Për shembull, një rezultat do të ishte nevoja për ndryshime në tekstin e legjislacionit përkatës të tillë si legjislacioni i rregulloreve të planifikimit dhe legjislacioni i peshkimit.

4.4 Takimit Negociuese

Ndër vite palët e konventës CMS kanë mbështetur zhvillimin, dhe nëpërmjet negociatave, kanë arritur në 7 Marrëveshje ligjore dhe 19 Memorandume të Mirëkuptimit {→ shih Shembullin Praktik 4.3}. Shpeshherë COP-i (Konferenca e Palëve) ka identifikuar se lloje apo grup llojesh përballen me probleme të caktuara dhe përqasja më e mirë në këto raste është koordinimi ndërkombëtar, në formën e Marrëveshjes, nën Nenin IV.

Fazat e procesit që çojnë në negocimin e një instrumenti janë si më poshtë:

- Palët identifikojnë një lloj me status të paqartë të ruajtjes dhe që i nevojitet një marrëveshje ndërkombëtare për ruajtje dhe manaxhim

- Njësia e Sekretarisë/Koordinimit dhe/ose një nga Palët, merr drejtimin për mbajtjen e një mbledhjeje midis shteteve që janë pjesë e kësaj fushe dhe organizatave të tjera të interesuara, dhe më përpara qarkullon një draft të tekstit

- PKP-së (Pikës Kombëtare të Përfaqësimit) i duhet të sigurohet nëse Pala e tij, apo e saj, dëshiron të nënshkruajë ndonjë instrument në të ardhmen, dhe nëse do të ishte e këshillueshme të merrnin pjesë në negociata.

Për të marrë pjesë në takimet negociuese dhe për të pasur të drejtën e nënshkrimit të instrumentit, delegatit të vendit (nëse është PKP apo zyrtar tjetër) do t'i nevojiten "Fuqi të Plota", të ngjashme me letrën e kredencialeve dhe të nevojshme për ndjekjen e një mbledhjeje të organit vendimarrës. Normalisht, nënshkrimi i delegatit nuk do të ndikojë plotësisht në angazhimin e vendit në Marrëveshjen ligjore; vetëm dëshmon konfirmimin e vendit se teksti i paraqitur është ai për të cilin është rënë dakord në mbledhje. Proçedurat kombëtare zakonisht kanë për qëllim të tregojnë se nënshkrimi është bërë "në varësi të ratifikimit"; që do të thotë se presidenti ose parlamenti, për të qenë brenda kushteve, duhet të konfirmojnë qëllimin e vendit. Normalisht një nga Shtetet Anëtare bie dakord të shërbejë si "depozituesi", që do të thotë se merr të gjithë dokumentet e ratifikimit dhe mban listën zyrtare të atyre vendeve që i janë bashkëngjitur procesit.

4.4.1 Pyetje Parashtrim

- A duhet të jetë instrumenti një "Marrëveshje e detyrueshme ligjore"? Ose një Memorandum Mirëkuptimi? (një Marrëveshje e detyrueshme ligjore e nevojshme për t'u ratifikuar)

- Çfarë llojesh duhet të mbulohen? Instrumentet mund të mbulojnë vetëm një lloj (p.sh. Pula me mjekër), disa lloje (llojet e peshkaqenëve sipas MOU-së - Memorandumit të Mirëkuptimit) apo shumë lloje nga një gamë e gjerë e grupeve taksonomike (p.sh. AEWA).

- Çfarë shtrirje gjeografike duhet të mbulojë instrumenti? Disa instrumente të konventës CMS mbulojnë vetëm dy vende (Memorandumet e Mirëkuptimit për Patën koke-kuqe dhe për Drerin e Andeve te jugut), disa mbulojnë një nën-zonë (p.sh. Shpendët e kullotave të pjesës jugore të Amerikës së Jugut dhe ASCOBANS), disa instrumente te tjerë mbulojnë disa kontinente (p.sh. AEWA) dhe të tjerë instrumente veprojnë në nivel global (p.sh. Memorandumet e Mirëkuptimit per Peshkaqenët).

- Për çfarë masash të ruajtjes së tyre duhet të bihet dakord nën këtë instrument? Këtu PKP-ja do të duhet të këshillohet me ministritë e tjera, pasi mund të preken aktivitete për të cilat ata janë përgjegjës (peshkimi dhe uji, pyjet, planifikimi dhe zhvillimi, bujqësia, nxjerrja e mineraleve).

4.4.2 Logjistika

Proçedurat për marrjen e vizave dhe sigurimin e mbështetjes financiare për delegatët e vendeve me të drejtën e pjesëmarrjes, janë të njëjta me ato proçedura që ekzistojnë për mbledhjet e organeve vendimarrëse të përshkruara sa më sipër {→ shih Paragrafin 4.1.2 Përgatitja për Logjistikën}.

SHEMBULL PRAKTIK 4.3

Negociatat e Memorandumit të Mirëkuptimit për Peshkaqenët

Rekomandimi 8.16, i pranuar nga Palët në KP-8 (Nairobi, Nëntor 2005), u sjell në mendje Shteteve Shtrirëse të peshkaqenëve shtegtarë, të listuar në Shtojcën I ose II , që të zhvillojnë një instrument ndërkombëtar për ruajtjen e tyre, në përputhje me Nenin III dhe V të Konventës.

Grupi Specialist i IUCN-së për llojet e Peshkaqenëve, përgatiti një raport që tregon situatën dhe rrugën e mundshme drejt një instrumenti ndërkombëtar (global), sipas konventës CMS.

U mbajtën tre takime për të arritur në negociata mbi kushtet e instrumentit të CMS:

1. Mahé, Seishell 11-13 Dhjetor 2007
2. Romë, Itali 6 -8 Dhjetor 2008
3. Manila, Filipine 10-12 Shkurt 2010

Për tekstin e MOU (Memorandumit të Mirëkuptimit) është rënë dakord në Manila dhe Takimi i Parë i Palëve Nënshkruese u zhvillua në Bon, Gjermani, më 24 - 27 Shtator 2012.

LISTË E PLOTË

Veprime për t'u kryer/ndjekur:

Përgatitja për mbledhje:

- ❑ Filloni nominimin e delegacionit brenda vendit dhë regjistrojini paraprakisht nëpërmjet sistemit të regjistrimit online
- ❑ Bëni një kërkesë për kredenciale dhe fuqi të plota, aty ku kërkohet, nga Ministria e Punëve të Jashtme apo Kryeministria
- ❑ Pyet mbi kërkesat për vizë dhe merrni vizën

Para mbledhjeve:

- ❑ Shkoni i përgatitur në mbledhje. Njihuni vetë me çështjet kryesore të axhendës, dhe filloni të mbani qëndrimin tuaj për çështjet kombëtare (dhe, mundësisht rajonale).
- ❑ Përgatitni, siç kërkohet, draftin e rezolutave dhe vendimeve, dhe paraqitini ato brenda afatit tek Njësia e Koordinimit/Sekretaria, për t'i qarkulluar më pas
- ❑ Rishikoni dokumentet e mbledhjes dhe përgatitni komentet dhe qëndrimet tuaja mbi paraqitjen e komenteve të tjera

Gjatë mbledhjeve:

- ❑ Njihuni mirë me Rregullat që zbatohen për Proçedurën dhe merrni pjesë aktive në mbledhje
- ❑ Shkëmbeni pikëpamjet dhe përpiquni të përgatisni një draft- tekst të rezolutës/vendimit, për të cilin të bien dakord të gjithë pjesëmarrësit

Pas mbledhjeve:

- ❑ Rishikoni dokumentacionin e mbledhjes
- ❑ Nisni procedurën e ratifikimit atje ku është e zbatueshme
- ❑ Shpërndani gjerësisht informacionin mbi mbledhjen gjerësisht tek palët e interesuara
- ❑ Identifikoni aktivitetet prioritare për zbatimin kombëtar

PËRSËRITJE KAPITULLI

Pyetja 1: Çfarë dokumenti i duhet një përfaqësuesi të një Pale që të marrë pjesë zyrtarisht në një mbledhje të organit vendimarrës?

Pyetja 2: Çfarë dokumenti i duhet një përfaqësuesi të një Pale që të marrë pjesë zyrtarisht në një mbledhje për të negociuar mbi një instrument të ri?

Pyetja 3: Çfarë dokumenti rregullon procesin e mbledhjes?

Pyetja 4: Si quhen vendimet e KP - Konferencës së Palëve?

Përgjigjet: *1) Kredencialet 2) Fuqi të Plotë 3) Rregullat e Procedures 4)Rezolu-tat*

Në kapitullin tjetër për zbatimit, do të prezantohen elementët e lidhur me tendencën ciklike të eventeve të sapo përshkruara.

SHENIME

ANEKSI 4.1

Rezoluta 1.5 e Konferencës së Palëve të CMS-së (Bon,1985)
Formati i Propozimeve për Amendimit e Shtojcave

Konferenca e Palëve mbi Konventën e

Ruajtjes së Llojeve Shtegtare të Kafshëve të Egra,

Duke marrë në konsideratë nevojën për t'u siguruar se listimi i llojeve migratore në shtojcat e Konventës, duhet të bazohet në evidencat më të mira shkencore që janë të disponueshme,

Rekomandohet formati i mëposhtëm, për të hartuar propozimet zyrtare, për përfshirjen e llojeve individuale në shtojcat I ose II të Konventës:

A. PROPOZIMI

B. MBROJTËSI

C. DEKLARATA MBËSHTETËSE

1. Taksoni

1.1 Klasa
1.2 Rendi
1.3 Familja
1.4 Gjinia ose lloji përgj. Nënlloji, përfshirë autorin dhe vitin
1.5 Emri (at) i zakonshëm, kur ka të tillë

2. Të dhënat biologjike

2.1 Shpërndarja (e tanishme dhe historike) – shih gjithashtu 5
2.2 Popullata (vlerësimi dhe tendencat)
2.3 Habitati (përshkrimi i shkurtër dhe tendencat)
2.4 Shtegtimet (llojet e lëvizjeve, distancat, raporti i popullatës që shtegton).

3. Të dhënat mbi rrezikun

3.1 Rrezik direkt në kërcënimin e popullatës (faktorët, intensiteti)
3.2 Shkatërrimi i habitatit (cilësia e ndryshimeve, sasia e humbjeve)
3.3 Rrezik indirekt (p.sh. reduktimi i suksesit të riprodhimit nga përdorimi i pesticideve)
3.4 Rrezik i lidhur veçanërisht me shtegtimet
3.5 Përdorimi kombëtar dhe ndërkombëtar

4. Statusi i Mbrojtjes dhe nevojat

4.1 Statusi kombëtar i mbrojtjes
4.2 Statusi ndërkombëtar i mbrojtjes
4.3 Nevojat shtesë të mbrojtje;

5. Shtetet e Shtrirjes

6. Komentet nga Grupi i Shteteve

7. Vërejtje shtesë

8. Referencat

Shënime shpjeguese

A. Përcaktimi i propozimit (lloj ose nën-lloj; nëse e gjitha apo vetëm një pjesë e popullatës duhet të përfshihet; nëse është propozuar përfshirja në shtojcat I ose II ose në të dyja shtojcat)

B. Emri zyrtar i Palës Kontraktuese që paraqet propozimin

C. Seleksionim i shpejtë i të dhënave shkencore më të rëndësishme, të cilat shpjegojnë dhe provojnë propozimin; këto të dhëna mund të mblidhen nga literatura teknike, ose nga raportet që nuk janë publikuar deri më tani (indikacioni i burimit). Propozimet duhet të përmbajnë detajet e mëposhtme:

1. Taksonomia: emrat shkencorë përkatës si dhe emrat në ato gjuhë në të cilat është hartuar teksti zyrtar i Konventës;

2. Të dhënat biologjike

2.1 Përshkrimi i zonës, përfshirë ndryshimet në periudhat historike, si dhe ndarja e zonës së përgjithshme: në zonat e riprodhimit, shtegtimit dhe dimërimit (qëndrimit); shto një hartë nëse nevojitet;

2.2 Karakteristikat sasiore të popullatës (numri, madhësia, të dhënat sasiore nga zonat e testit) dhe ndryshimet e saj, përfshirë tendencën e popullatës (zgjerimi dhe norma);

2.3 Karakteristikat ekologjike të habitateve të cilët përdoren nga një ose më shumë lloje kafshësh; indikacioni i strukturave më të rëndësishme të habitateve, që janë përgjegjës për mbijetesën e llojeve gjatë shtegtimit dhe në zonat e tyre të dimërimit (qëndrimit);

2.4 Përshkrimi i karakterit të shtegtimeve të rregullta, duke treguar shtrirjen gjeografike të lëvizjeve të popullatës dhe përfshirjen e informacionit, nëse e gjitha apo vetëm një pjesë (cila?) e popullatës ndërmerr shtegtime të rregullta.

3. Të dhënat mbi rrezikun: Listimi i faktorëve – të ndarë në katër grupe – të cilat janë përgjegjës për llojet në rrezik apo për statusin jo të qartë të ruajtjes së tyre; përsa kohë faktorët 1 dhe 3 janë të përfshirë, duhet gjithashtu të specifikohet nëse këta faktorë veprojnë në zonat e folezimit, shtegtimit apo të qëndrimit.

4. Pavarësisht nga statusi ligjor i ruajtjes, nga Shtete të ndryshme të Shtrirjes dhe me informacionin mbi statusin, në nivel ndërkombëtar (nën Konventat e tjera), duhet të listohen kërkesa të tjera, konkrete për ruajtjen e llojeve (4.3), të cilat duhet të plotësohen me qëllim që të përmirësohet statusi i ruajtjes së këtyre llojeve. Pavarësisht ruajtjes direkte të popullatës, duhet të listohen dhe shpjegohen propozimet nga fusha e ruajtjes të biotopit (nëse nevojitet).

5. Listimi i Shteteve ku është provuar prania e llojeve (duke treguar, nëse është e nevojshme, nëse ato janë zona të folezimit, shtegtimit apo të qëndrimit).

6. Eshtë e nevojshme të konsultohet, sa të jetë e mundur, me ekspertë dhe/ose autoritete të ruajtjes së natyrës, pjesë e Shteteve të Shtrirjes, para se propozimi të paraqitet, dhe të jepet një përmbledhje e shkurtër e komenteve të tyre lidhur me propozimin. Këto të dhëna ia bëjnë më të lehtë Këshillit Shkencor dhe Konferencës së Palëve të marrin vendimet e duhura.

ANEKSI 4.2

Rezoluta 10.4 e KP-së të CMS-së (Bergen, 2011)
Mbetjet e Ngurta

Adaptuar nga Konferenca e Palëve në Takimin e tyre të Dhjetë
(Bergen, 20-25 Nëntor 2011)

Paraqitur nga Australia

Të shqetësuar që mbetjet detare ndikojnë negativisht në një numër të madh të botës shtazore nënujore shtegtare, përfshirë shumë lloje të shpendëve, breshkave, peshkaqenëve, dhe gjitarëve nënujor që janë të rrezikuar nga zhdukja;

Të ndërgjegjshëm, që ngordhja e llojeve shtegtare mund të ndodhë nëpërmjet gëlltitjes, përzierjes, kontaktit me mbeturinat në zonat detare apo bregdetare;

Duke theksuar nevojën për të bërë përpjekje intensive në zonat e rrjedhjes së sipërme dhe grykëderdhjeve, dhe sistemet e tjera ku mbeturinat detare mund të futen në mjedisin detar dhe bregdetar dhe të ndikojë në llojet shtegtare të listuara në Konventë;

Duke njohur Rezolutën 60/30, Oqeanet dhe ligji i detit, adoptuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, që thekson rëndësinë e mbrojtjes dhe ruajtjes së mjedisit nënujor dhe burimeve nënujore të saj nga ndotja dhe degradimi fizik;

Më tej njeh se ka shumë instrumente rajonale dhe ndërkombëtare të tjera që u adresohen çështjes së mbeturinave detare brenda rajoneve të tyre;

Vëren se formulimi i Angazhimit të Honolulus dhe zhvillimi i vazhdueshëm i Strategjisë së Honolulus i cili synon të reduktojë ndikimet e mbeturinave detare pergjatë dhjetë viteve në vazhdim;

Vëren më tej se adoptimi i fundit i amendamenteve nga Organizata Ndërkombëtare e Botës Nënujore në Aneksin V "Parandalimi I Ndotjes prej Mbeturinave të anijeve" të Konventës Ndërkombëtare për Parandalimin e Ndotjes nga Anijet (MARPOL) që do të ndalojë shkarkimin e të gjitha mbeturinave nga anijet në det që prej 1 Janarit 2013, përveç se në rrethana shumë të kufizuara; dhe

Bën të ditur veprimet e ndërmarra nga Shtetet për të reduktuar ndikimet negative të mbeturinave detare në ujë brenda juridisksionit të tyre;

1. ***Merr Parasysh që*** mbeturinat detare të përfshijnë ndonjë material antropogjen, të manifakturuar ose material të ngurtë të përpunuar, pavarësisht madhësisë së saj, të hedhur, ekspozuar, apo braktisur në ambjent, përfshirë të gjitha materialet të hedhura në det, bregdet, apo të sjella indirekt në det nga lumenjtë, shkarkimet e ujërave të zeza, ujërat nga stuhitë apo erërat;

2. ***Nxit*** Palët të identifikojnë vendet bregdetare apo oqeanike ku mblidhen mbeturinat detare për të identifikuar ndonjë fushë që përbën shqetësim;

3. *Më tej nxit* Palët të punojnë në bashkëpunim më fqinjët rajonalë për të identifikuar dhe adresuar burimet dhe ndikimet e mbeturinave bregdetare, duke bërë të ditur që për mbeturinat detare nuk kushtëzohen nga kufijtë sovranë;

Numri I rezolutës– 10 tregon KP10

Titulli i Rezolutës

Referenca për KP në të cilën është adoptuar rezoluta

Referenca për Palën që paraqet draftin (faza e draftimit)

Parathënia–prezanton Situatën e cështjes – problemi, pasojat, veprime të tjera që po merren në forume të ndryshme

Fjalë tipike Preambula: njohëse, duke vënë në dukje, i shqetësuar, i vetëdijshëm, duke pranuar

Referenca të vendimit të një organi tjetër Ndërkombëtar

Paragrafe vepruese– ku paraqiten veprimet e dakordësuara, ku jepen udhëzime Sekretariatit. Komiteti i Qëndrimit, Këshilli Shkencor, dhe palët e treta Instruktohen/ kërkohen Që të veprojne

Fjale tipike vepruese: Merr parasysh, inkurajo, kërkesat, udhëzon, rekomandon, kërkon, i bën thirrje

4. ***I Kërkon Sekretariatit të CMS*** të pyesë mbi marrëveshje përkatëse të cilat mund të kenë akses te të dhënat mbi ndikimet potenciale apo aktuale të mbeturinave detare tek llojet nënujore, në mënyrë që ta siguroj këtë informacion për Këshillin Shkencor para datës 11 apo Konferencës së ardhshme të Palëve;

Udhëzime për Sekretariatin

5. *Rekomandon* që Palët të zhvillojnë dhe zbatojnë planet e tyre kombëtare të veprimit të cilat duhet të adresojnë impaktet negative të mbeturinave detare në ujërat brenda juridisksionit të tyre. Gjithashtu ato mund të shtjellojnë edhe përfitimet nga ngritja e programeve të brendshme për manaxhimin e mbeturinave detare, veçanërisht në lidhje me mekanizmin e peshqve të humbur, braktisur, dhe të hedhur, si dhe problemet e peshkimit fantazmë që rrjedh prej këtyre;

6. ***Kërkon që Palët*** të sigurojnë informacion të përdorshëm mbi sasitë, impaktet dhe burimet e mbeturinave detare në ujërat brenda juridisksionit të tyre, mbi llojet nënujore të listuara në Shtojcat I dhe II të Konventës në Raportet e tyre Kombëtare;

Kërkësat ndaj Paleve

7. *Nxit* Palët dhe Organizatat të mbështesin përpjekjet e Palëve me burime të kufizuara në zhvillimin dhe zbatimin e planeve të tyre kombëtare të veprimit lidhur me mbeturinat detare;

8. ***Udhëzon Këshillin Shkencor*** të:

Udhëzimet për Këshilin Shkencor

(a) Identifikojë boshllëqet e njohurive në manaxhimin e mbeturinave detare dhe impaktet e tyre tek llojet shtegtare;

(b) Idenfikojë strategjitë e praktikës më të mirë për manaxhimin e mbeturinave të përdorura në bordin e anijeve detare tregtare, duke marrë parasysh punën e madhe të ndërmarrë nga Organizata Ndërkombëtare Detare, FAO dhe Organizata e Standarteve për të mënjanuar riprodhimin, identifikuar kodin ekzistues të etikës, dhe për të përcaktuar nevojën për përmirësimin dhe/ose zhvillimin e kodeve të reja të etikës;

(c) lehtësojë analizën e efektivitetit të ndërgjegjësimit aktual të publikut dhe fushatavee të edukimit për të identifikuar boshllëqet dhe hapësirat për t'u përmirësuar; dhe

(d) të raportojë ashtu si duhet progresin dhe zhvillimet në Konferencën e Palëve ; dhe

9. *T'I kërkojë më tej* Sekretariatit, në varësi të burimeve të disponueshme, të intensifikojë lidhjet me instrumentet përkatëse rajonale dhe ndërkombëtare **IMO, FAO, UNEP** të tilla si konventat rajonale të deteve dhe më tej, të promovojë sinergjitë, të mënjanojë riprodhimin, dhe të maksimizojë përpjekjet për reduktimin e impaktit e mbeturinave detare tek speciet shtegtuese.

Akronimet që janë të njohura për delegatët nuk janë shpjeguar në mënyrë të plotë meqenese ata presupozohet ta dine Organizatën Ndërkombëtare Detare (IMO), Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë (FAO) dhe Programi Mjedisor i Kombeve të Bashkuara (UNEP)

5 Zbatimi

"Ne jemi të lumtur që arritëm të stabilizonim popullatën e breshkave të detit. Angazhimi i Tajlandës në Memorandumin e Mirëkuptimit ishte mjaft i dobishëm në krijimin e një aleance të gjerë mes njerëzve, qeverisë, shoqërisë civile dhe sektorit privat për ta realizuar këtë projekt."

Burimi: Punonjës në terren i një organizate joqeveritare ndërkombëtare

Gjatë viteve të fundit, puna në fushën ndërkombëtare të mjedisit është fokusuar gjithmonë e më shumë te zbatimi, më shumë se te zhvillimi i marrëveshjeve të tjera referuese, si ato të realizuara në Rio, në vitin 1992.

Tekstet e traktateve, si planet e veprimit, planet strategjike dhe udhëzimet e përcaktuara nga Konventa për Mbrojtjen e Llojeve Shtegtare të Kafshëve të Egra (CMS) dhe instrumentet e saj, synojnë sigurimin e një kuadri dhe udhëzimeve përkatëse, për zbatimin në nivel kombëtar.

Kapitulli i mëposhtëm synon të paraqesë informacione mbi aspekte të ndryshme të zbatimit, për të mbështetur Pikat Kombëtare të Përfaqësimit (PKP) me rekomandime, sesi konventa CMS dhe instrumentet e saj mund të zbatohen në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar.

Në veçanti, trajtohen pikat e mëposhtme:
- Çfarë Përfshin Vetë Zbatimi? (Paragrafi 5.1)
- Cikli i Zbatimit (Paragrafi 5.2)
- Aspektet Ndërkombëtare të Zbatimit (Paragrafi 5.3)

5.1 Çfarë Përfshin Vetë Zbatimi?

Qeveritë dhe Organizatat Rajonale të Integrimit Ekonomik (REIO) si Bashkimi Evropian (BE), kanë ndërmarrë një seri angazhimesh ndërkombëtare, duke nënshkruar, dhe ku është e përshtatshme, duke ratifikuar ose aderuar në konventën CMS dhe instrumentet e saj. Por përsëri, miratimi i instrumenteve të familjes së konventës CMS është vetëm fillimi; instrumentet kërkojnë zbatimin e tyre.

Çfarë është zbatimi? Zbatim do të thotë operacionalizimi i një instrumenti në nivel kombëtar. Zbatimi kërkon që veprimet nga politikat, të ndërmerren në përputhje me pjesët operacionale të instrumentit, për të realizuar objektivat për të cilat është rënë dakord. Instrumentet e familjes së konventës CMS zbatohen nëpërmjet strategjive kombëtare. Këto mund të jenë në formën e një strategjie specifike kombëtare, e posaçme për llojet shtegtare, si pjesë e SKPVB, ose si një plan veprimi ose plan pune specifik për zbatimin kombëtar. Strategji të tilla kombëtare mund të mbështeten, integrohen ose plotësohen nga masa të tjera të politikave. Shembuj të masave të tilla përfshijnë; nxjerrjen e ligjeve dhe rregulloreve (d.m.th. ligje ose akte për llojet shtegtare), stimuj ekonomikë, politika edukimi dhe programe e staf mbështetës. Planet Kombëtare të Zbatimit (PKZ){→ shih Paragrafin 5.2.4 Opsioni 2} dhe strategjitë duhet të përfshijnë monitorimin dhe vlerësimin për raportimin mbi progresin e zbatimit {→ shih gjthashtu Kapitullin 6 per Raportimin Kombëtar} dhe të përcaktojnë nëse instrumenti i familjes së konventës CMS sjell përmirësime të mjedisit.

Cili është roli i Pikës Kombëtare të Përfaqësimit (PKP) në zbatim?

Pikat Kombëtare të Përfaqësimit (PKP) janë kontribues të rëndësishëm në zbatimin efektiv dhe efikas të konventës CMS dhe/ose instrumenteve të saj. Ato mund të kenë një rol shumë të rëndësishëm në identifikimin e aktiviteteve prioritare, të përshtatshme për vendin e tyre, p.sh. identifikimi i rajoneve/llojeve që janë prioritare për të vepruar, ose përmirësimi i komunikimit mes aktorëve të ndryshëm që mund të nxisin zbatimin e konventës CMS dhe instrumenteve të saj.

Për më tepër, PKP-të mund të jenë të dobishme në identifikimin e sinergjive dhe mundësive të reja për financimin e aktiviteteve që synojnë realizimin e procesit të zbatimit. Për këtë arsye, PKP-të duhet të mbështeten jo vetëm në financimet qeveritare, por, sipas rastit, duhet të identifikojnë burime të reja financimi. Në shumicën e rasteve, konventa CMS dhe shumë nga instrumentet e saj, sigurojnë pak ose aspak ndihmë financiare nga shtetet anëtare, për procesin e zbatimit. Sidoqoftë, në rastet kur një ndihmë e tillë financiare është e disponueshme, shtetet anëtare duhet të plotësojnë kërkesa të caktuara për ta marrë atë. Për më tepër, PKP-të duhet të konsultohen rregullisht me qeveritë e tyre, për nivelin e financimit, kontributeve vullnetare ose të vlerësuara, që shteti anëtar është i gatshëm të ofrojë për të siguruar një zbatim efektiv të konventës CMS dhe instrumenteve të saj {→ shih Paragrafin 5.2.5 Objektivi 6 për detaje të mëtejshme}.

5.2 Cikli i Zbatimit

Përdorimi dhe aplikimi i suksesshëm i një instrumenti të familjes së konventës CMS, është një proces i vazhdueshëm dhe i përsëritur. Shtetet Anëtare duhet të zbatojnë një seri hapash bindës; shumë prej tyre të realizueshme brenda vendit {→ shih Figurën 5.1}. Për të kuptuar më mirë zbatimin në nivel kombëtar, janë përshkruar gjashtë hapat bazë me terma të thjeshtë dhe koncizë.

Hapi 1: Familiarizimi me Instrumentin(tet) dhe Kërkesat për Raportimin Kombëtar
Hapi 2: Rishikim i Legjislacionit Kombëtar dhe Identifikimi i Mangësive
Hapi 3: Organizimi i një Procesi Këshillimor Kombëtar

Hapi 4: Zhvillimi i Strategjisë Kombëtare dhe/ose Planeve të Zbatimit

Hapi 5: Promovimi dhe mbështetja e zbatimit të Plan Veprimit Kombëtar Strategjik për Biodiversitetin (SKPVB) dhe/ose Plan Kombëtar të Zbatimit (PKZ)

Hapi 6: Monitorimi, Vlerësimi dhe Raportimi për Zbatimin Kombëtar

5.2.1 Hapi 1 Familiarizimi me Instrumentin(et) dhe Kërkesat për Raportimin Kombëtar

Ky hap, mundësisht, duhet të ndërmerret në momentin kur një vend është në përgatitje për të aderuar në konventën CMS dhe/ose një nga instrumentet e saj, dhe duhet të kryhet paralelisht me politikat, legjislacionin, strategjitë dhe planet e veprimit që ekzistojnë në vend. Për shtetet që janë në procesin e anëtarësimit në konventën CMS dhe/ose një nga instrumentet e saj, një hap i parë i rëndësishëm është analiza e plotë e mjeteve ligjore të detyrueshme (duke përfshirë tekstet e instrumentit, Planit Strategjik, Planeve të Veprimit, Rezolutave sipas rastit). Njohja e efekteve të mundshme ligjore të konventës CMS dhe/ose instrumenteve të saj (p.sh. nëpërmjet rishikimit të përshtatshmërisë të ligjeve dhe politikave kombëtare ekzistuese, për zbatimin e konventës CMS dhe/ose instrumenteve të saj, dhe një vlerësim të kërkesave specifike të vendit) do t'i sigurojë vendit në fjalë një tablo reale të efekteve që rrjedhin nga aderimi.

Për PKP-të, vendi i të cilëve e ka nënshkruar ose ratifikuar tashmë një instrument dhe janë njohur me tekstet ligjore, listat e llojeve (Shtojcat), vendimet, rezolutat, programin e punës dhe planet strategjike, do të ndihmojnë në përcaktimin e pritshmërive për PKP-të dhe njohjen e përgjegjësive të shtetit anëtar.



Figura 5.1 Cikli i Zbatimit për Instrumentet e Familjes CMS

Njohja, sa më shpejt, e kërkesave të raportimit të konventës CMS dhe/ose instrumenteve të saj, do të lejojë që Pika Kombëtare të Perfaqesimit (PKP) të jetë e familjarizuar me nevojat e procesit të zbatimit dhe të jetë e përgatitur për realizimin e pritshmërive të raportimit për instrumentin. {→ shih Kapitullin 6 ku Raportimi Kombëtar shqyrtohet në mënyrë të plotë}

5.2.2 Hapi 2 Rishikim i Legjislacionit Kombëtar dhe Identifikimi i Mangësive

Një rishikim i legjislacionit kombëtar në fuqi (p.sh. për ruajtjen e natyrës, për ruajtjen e ujit, planifikimin mjedisor) jep një tablo të përgjithshme sesi mbështetet zbatimi i instrumentit(eve) nga legjislacioni kombëtar dhe identifikon mbivendosjet ose mangësitë në këto rregullore. Rishikimi nuk duhet të fokusohet vetëm në ekzistencën e legjislacionit kombëtar, por duhet të përfshijë edhe zbatimin e tij (p.sh. kontrollin e gjuetisë, gjuetinë pa leje, ndotjen dhe shkatërrimin e habitatit), si dhe eksperiencat dhe mësimet e nxjerra në lidhje me efektivitetin e instrumenteve ligjore. Duhet të merren me kujdes parasysh mbivendosjet dhe konfliktet e mundshme të interesit me ministritë e tjera në fushat si; peshkimi, bujqësia, pylltaria, shfrytëzimi i minierave, infrastruktura e transportit, zhvillimi dhe planifikimi.

Metodat e përshtatshme për rishikimin përfshijnë; analizën e dokumenteve, intervistat me politikëbërësit dhe aktorët kryesorë, analizën ligjore, rishikimet e literaturës dhe rezultatet e studimeve të rastit për praktikat e menaxhimit, seminare pune me aktorët kyç, analiza të praktikave më të mira dhe shkëmbime eksperience në nivel rajonal.

Pyetjet kryesore që duhet të merren parasysh kur kryhet rishikimi përfshijnë:

- Cilat janë mangësitë aktuale në njësitë kombëtare institucionale/legjislative/rregullatore që do të duhet të forcohen, ose për të cilat do të duhet të merren masa të reja?
- Çfarë roli luajnë legjislacioni dhe institucionet kombëtare dhe lokale, në zvogëlimin e rreziqeve për llojet shtegtare dhe habitatet e tyre?
- Cilat procese institucionale/legjislative për mbrojtjen e llojeve shtegtare janë më të suksesshme sa të tjerat?
- Cilat janë mundësitë dhe perspektivat për hartimin/rihartimin e legjislacionit/institucioneve për të zvogëluar rreziqet për llojet shtegtare dhe habitatet e tyre?

5.2.3 Hapi 3 Organizimi i një Procesi Këshillimor Kombëtar

Pavarësisht nëse Pika Kombëtare e Përfaqësimit (PKP) planifikon të zbatojë konventën CMS dhe instrumentet e saj, nëpërmjet integrimit të planit të zbatimit në mjetet kombëtare ekzistuese të zbatimit (si SKPVB, Ligjet për faunën, etj.), ajo synon një plan kombëtar të veçantë për procesin e zbatimit, ose planifikon të përdorë të dyja metodat, pasi zhvillimi i një procesi konsultativ kombëtar është një hap i domosdoshëm për planifikimin e zbatimit të konventës CMS dhe instrumenteve të saj. Konsultimi i gjerë, me të gjithë aktorët përkatës të shoqërisë, gjatë gjithë ciklit të zbatimit, do të përmirësojë ndjeshëm rezultatet, duke e bërë planifikimin më efikas, më transparent dhe më gjithpërfshirës. Konsultimi i gjerë do të ndihmojë, po ashtu, sigurimin e mbështetjes nga aktorët, gjë që është e domosdoshme për zbatimin e mëtejshëm.

Një mekanizëm i tillë në nivel kombëtar, mund të krijohet si i pavarur, me qëllim trajtimin e çështjeve që lidhen me zbatimin e konventës CMS dhe/ose instrumenteve të saj, ose sipas rastit mund të përfshihet në mekanizmat ekzistues të koordinimit kombëtar (si komitetet kombëtare të SKPVB, Komitetet Kombëtare Ramsar, etj.)

Planifikimi dhe menaxhimi i këtij procesi konsultimi dhe përgatitja e axhendës, janë përgjegjësi e PKP-së.

Dhe kjo nuk është një detyrë e lehtë. Një ndër hapat e parë kryesorë është identifikimi i aktorëve kyç dhe lidhja mes tyre. Aktorët kryesorë mund të përfshijnë ekspertë teknikë dhe shkencorë, politikëbërës nga organe të tjera qeveritare (p.sh. ministritë e planifikimit, bujqësisë, transportit ose financës), organizatat joqeveritare, përfaqësues të sektorit privat, përfaqësues të banorëve indigjenë dhe komuniteteve lokale, ose PKP-të e marrëveshjeve të tjera multilaterale për mjedisin si; KDB, CITES, Konventa Ramsar dhe Konventa për Trashëgiminë Botërore. Ajo që duhet të synojë Pika Kombëtare e Përfaqësimit (PKP) është një grup i vogël, përfaqësues dhe gjithëpërfshirës i aktorëve që janë të gatshëm të jenë pjesë e një grupi thelbësor pune, për planifikimin dhe vazhdimësinë e procesit të zbatimit. Përveç kësaj, mund të jetë e nevojshme të përfshihet një gamë më e gjerë e pjesëmarrësve, në një proces më të gjerë - duke përfshirë, për shembull, persona ose institucione që preferojnë të këshillohen gjatë fazave të tjera, por jo të përfshihen në fazën e organizimit ose të hartimit të draftit. Ky grup më i madh i aktorëve mund të përfshihet p.sh. nëpërmjet dëgjesave publike ose nëpërmjet përdorimit të anketave ose medias sociale (në internet).

SHEMBULL PRAKTIK 5.1

Komiteti Kombëtar në Kili (Shembull i një Proçesi Këshillimi Kombëtar)

Komiteti kombëtar rrit efektivitetin dhe minimizon përdorimin e burimeve financiare dhe të personelit

Komiteti Kombëtar luan një rol kryesor në zbatimin e CMS-së dhe instrumenteve të tjera për të cilat Kili është një Shtet i Zonës së Shtrirëse. Ai është krijuar me një dekret zyrtar (të Ministrisë së Punëve të Jashtme, e cila drejton Komitetin dhe është autoriteti kombëtar përgjegjës për konventën CMS në Kili) dhe përfshin ente nga ministri të ndryshme, përfshirë ministritë; e Mjedisit, Bujqësisë, Ekonomisë, Arsimit, Punëve Publike dhe Mbrojtjes (Drejtoria e Territorit Detar dhe Çështjeve Ujore). Të gjitha agjensitë e tjera, organizatat joqeveritare të përfshira në punën për konventën CMS, shkencëtarët dhe biologët, janë të ftuar (kur kërkohen këshillat e tyre) të marrin pjesë në mbledhjet e Komitetit.

Komiteti Kombëtar për konventën CMS përfshin të gjithë aktorët dhe aktivitetet e Familjes CMS. Ai trajton çështjet e konventës CMS që janë të lidhura ngushtë me llojet e pranishme në vend.

Që procesi i konsultimit të jetë i suksesshëm, do të jetë shumë e rëndësishme që aktorët të marrin pjesë në mënyrë të plotë dhe efektive {→ shif gjithashtu Paragrafin 4.1.1.1 dhe Shembullin Praktik 5.1}. Kjo do të thotë se Pika Kombëtare e Përfaqësimit (PKP) do të duhet të sigurojë transmetim të informacioneve dhe komunikim të qartë dhe transparent mes të gjithë aktorëve. Për të realizuar këtë, Pika Kombëtare e Përfaqësimit (PKP) mund të marrë parasysh përdorimin e njoftimeve qeveritare, letrave të hapura për grupet e aktorëve, paketave të informimit, kërkesave me shkrim, etj.

Në qendër të konsultimeve do të jetë një seri e përsëritur e seminareve praktike, forumeve, seminareve dhe takimeve, ose shkëmbime korrespondence të grupit kryesor të punës, në varësi të burimeve të disponueshme. Këto mjete komunikimi do të shërbejnë për shkëmbimin e informacioneve dhe mundësive mes aktorëve. Përveç kësaj, grupi duhet të zhvillojë dhe të diskutojë mbi draft - dokumentin e planifikimit kombëtar. Gjatë këtyre shkëmbimeve, është e rëndësishme që të ruhet një atmosferë që i motivon pjesëmarrësit, që të kontribuojnë në mënyrë aktive në diskutime, të sigurojnë informacione, të kërkojnë zgjidhje dhe të qëndrojnë të hapur për dialog. Një atmosferë e tillë do të nxisë idenë e pronësisë mes aktorëve dhe do t'i motivojë ata të ndjekin zbatimin e planeve.

5.2.4 Hapi 4 Zhvillimi i Strategjisë Kombëtare dhe/ose Planin e Zbatimit

Për t'u siguruar se konventa CMS dhe/ose çdo instrument i saj është zbatuar si duhet në nivel kombëtar, kërkohet zhvillimi i një Strategjie kombëtare dhe/ose Plani i zbatimit për llojet shtegtare.Vendimet dhe zgjidhjet nga organi vendimarrës për konventën CMS dhe/ose instrumentet e saj, bashkë me programin e punës dhe strategjinë, duhet të studiohen me kujdes, për të identifikuar se çfarë është e vlefshme për vendin në fjalë. Për shembull, një vend që zhvillon një sektor të madh të energjisë së rinovueshme do të duhet të marrë parasysh rezolutat që kanë lidhje me ndikimin e impianteve të energjisë së erës. Sidoqoftë, nëse vendi nuk rrethohet nga deti, vendimet që lidhen me çështjet detare mund të mos jenë shumë të vlefshme. Për zhvillimin e një Strategjie Kombëtare dhe/ose Plan Zbatimi, mund të merren parasysh tre opsionet e mëposhtme:

1. Integrimi i plotë i llojeve shtegtare në Strategjinë Kombëtare dhe në Planin e veprimit për Biodiversitetin (SKPVB)
2. Plan Kombëtar i Zbatimit i veçantë për llojet shtegtare (PKZ)
3. Një ndërthurje e planit SKPVB dhe PKZ

SHEMBULL PRAKTIK 5.2

Proçesi i suksesshëm i zbatimit siguron po ashtu financimet e duhura (Kenia)

Në Kenia, procesi i zbatimit parashikon si hap të parë përgatitjen e një strategjie. Kjo strategji shërben si hartë për zbatimin. Hap i dytë ndihmon për të identifikuar aktivitetet kryesore. Një aktivitet në kuadrin e zbatimit përfshin, për shembull, mbrojtjen e një habitati specifik. Në hapin e tretë, aktorë të ndryshëm brenda dhe jashtë qeverisë rishikojnë listën e aktiviteteve të identifikuara dhe ftohen të angazhohen për financimin dhe zbatimin e një ose më shumë nga aktivitetet e renditura. Nëpërmjet këtij procesi, Kenia, për disa aktivitete, ka siguruar me sukses financime nga organizatat joqeveritare, e ndërkohë ka siguruar një zbatim koherent dhe efikas për strategjinë e saj kombëtare.

Pavarësisht se cili opsion zgjidhet, është e qartë se një strategji efektive mund të përgatitet vetëm nëpërmjet një procesi konsultimi, me përfshirjen e plotë të të gjithë aktorëve përkatës {→ shih Shembullin Praktik 5.2}. Roli i Pikës Kombëtare të Përfaqësimit (PKP) ka të bëjë, kryesisht, me nisjen dhe koordinimin e procesit të zhvillimit të njëngaopsioneve tësipërpërmendura. Përorientim, konventaCMSkavënënëpërdorimudhëzimeqëshpjegojnë sesi të integrohen llojet shtegtare në SKPVB. Këto udhëzime u janë paraqitur Palëve në konferencën KP-10. *

Opsioni 1: Integrimi i plotë i Llojeve Shtegtare në Strategjinë Kombëtare dhe Planin e veprimit për Biodiversitetin (SKPVB)

SKPVB-të janë mjetet kryesore për zbatimin e Konventës për Diversitetin Biologjik (KDB). Konventa është një nga marrëveshjet shumëpalëshe për mjedisin (MEA) në lidhje me biodiversitetin, që kërkon prej shteteve anëtare të përgatisin një strategji kombëtare për biodiversitetin (ose një instrument të barazvlefshëm) dhe të sigurojnë që kjo strategji të përfshihet në aktivitetet e të gjithë atyre sektorëve, veprimet e të cilëve kanë ndikim (pozitiv ose negativ) në biodiversitet. Aktualisht, pothuajse të gjitha shtetet kanë zhvilluar një SKPVB. Në tetor 2010, Konferenca e Palëve për konventën KDB miratoi Planin Strategjik për Biodiversitetin, të vitit 2011-2020 dhe Objektivat Aichi. Plani i ri Strategjik fokusohet në një koncept më të zgjeruar të ruajtjes së biodiversitetit dhe jo te konventa KDB si një institucion. Të gjitha konventat që kanë lidhje me biodiversitetin dhe instrumentet përkatëse, nxiten të mbështesin zbatimin e këtij plani strategjik dhe Objektivave Aichi dhe, si rrjedhojë, aktivitetet e tyre mund të përfshihen në SKPVB. Në konferencën KP-10 të KDB-së u kërkua

* http://www.cms.int/bodies/COP/cop10/docs_and_inf_docs/doc_27_guidelines_nbsap_e.pdf

KUTI INFORMACIONI 5.1

Çfarë është një SKPVB?

Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin ose SKPVB është një proces nëpërmjet të cilit, vendet mund të planifikojnë mënyrën e trajtimit të rreziqeve për biodiversitetin. Ato janë një kërkesë e Paragrafit 6 (a) të tekstit të Konventës për Diversitetin Biologjik (KDB) dhe vlerësohen si një mjet kryesor për zbatimin e konventës KDB në nivel kombëtar si dhe në nivel global. Ato janë gjithmonë e më shumë të lidhura me instrumentet e tjera për biodiversitetin si dhe sektorë të tjerë kombëtarë që kontribuojnë në zbatimin e Planit Strategjik për Biodiversitetin (2011-2012) dhe Objektivave të Aichi, në përputhje me Paragrafin 6 (b) të tekstit të konventës KDB, e cila e vë theksin në sinergjinë me sektorët e tjerë për zhvillimin dhe zbatimin e SKPVB-ve. Megjithëse SKPVB-ja mund të marrë formën e një dokumenti të vetëm, të planifikimit për biodiversitetin (dhe shumë vende e kanë zgjedhur këtë formë), kjo nuk është domosdoshmërisht e nevojshme.

SKPVB mund të shikohet, po ashtu, si e formuar nga një seri elementesh - për shembull: ligje dhe proçedura administrative, axhenda të kërkimit shkencor; programe dhe projekte; aktivitete komunikimi, edukimi dhe për ndërgjegjësimin e publikut; forume për dialogun ndërministror dhe shumë aktorëve - të cilët sigurojnë së bashku mjetet për realizimin e tre objektivave të KDB-së, duke krijuar kështu bazën për procesin e zbatimit në nivel kombëtar. Niveli i dytë, ose SKPVB-të e rishikuara, në përgjithësi janë më shumë në linjë me këtë përkufizim më të zgjeruar; ato i ngjajnë më shumë një procesi planifikimi sesa një dokumenti fiks. Një proces i tillë planifikimi është i përshtatshëm edhe për konventat dhe marrëveshjet e tjera, të cilat kanë lidhje me biodiversitetin.

Përshtatur nga prezantimi i SKPVB, Moduli 1
http://www.cbd.int/doc/training/nbsap/b1-train-intro-nbsap-revised-en.pdf

po ashtu që palët të rishikojnë, të përditësojnë dhe të ndryshojnë SKPVB-të e tyre deri në vitin 2014.

Aktualisht, konventa CMS dhe instrumentet e saj nuk sigurojnë një mekanizëm për procesin e zbatimit, pasi çështjet që lidhen me llojet shtegtare nuk mund dhe nuk duhet të shikohen të ndara nga çështja më e gjerë e mbrojtjes, dhe përdorimi i qëndrueshëm i biodiversitetit, ka arsye të mjaftueshme për integrimin e strategjive dhe veprimeve për mbrojtjen e llojeve shtegtare në SKPVB. Para se të merret në konsideratë Opsioni 1 dhe 3, PKP-ja duhet të kontrollojnë statusin aktual të SKPVB-së së vendit të tyre dhe nëse këto opsione janë ende të vlefshme. Një skicë orientuese e një plani SKPVB paraqitet në {→ shih Kutinë e Informacionit 5.1} Siç tregohet më sipër, pothuajse të gjitha shtetet kanë aktualisht një plan efektiv të SKPVB-së dhe janë të njohur tashmë me të gjitha detajet e SKPVB-ve.[**]

Avantazhi i përdorimit të SKPVB-së si një mjet për mbrojtjen e llojeve shtegtare është se ky instrument është i njohur dhe i përcaktuar tashmë brenda vendit. Në shumë vende, SKPVB-të do të miratohen si ligje, d.m.th. nëpërmjet miratimit zyrtar nga Parlamenti në shumë raste, duke siguruar kështu bazën politike për procesin e zbatimit. Strategjia SKPVB ose ligji për biodiversitetin kombëtar mund të krijojnë po ashtu një komitet të posaçëm, me mandat, për të koordinuar planifikimin dhe rishikimin e procesit të zbatimit.

Megjithëse hartimi ose rishikimi i SKPVB-ve dhe miratimi zyrtar i tyre mund të jetë vërtetë një sfidë, këto përpjekje shtesë mund të jenë mjaft të vlefshme për të siguruar mbështetjen e nevojshme politike për ruajtjen e llojeve. {→ shih Kutinë e Infomacionit 5.2 për udhëzime sesi ta bëni këtë} Një disavantazh i të qenit pjesë e SKPVB është se llojet shtegtare mund të tërheqin më pak vëmendje nga sa mund të kishin si subjekt i një Strategjie kombëtare dhe/ose Plani Zbatimi të posaçëm.

[**] Si pjesë e krijimit të kapaciteteve, Sekretariati i KDB-së ka zhvilluar disa module trajnimi në lidhje me SKPVB-në, të cilat mund t'i gjeni në http:// at http://www.cbd.int/nbsap/training/default.shtml.

KUTI INFORMACIONI 5.2

UDHËZIMET PËR INTEGRIMIN E SPECIEVE SHTEGTARE NË STRATEGJITË KOMBËTARE DHE PLANET E VEPRIMIT PËR BIODIVERSITETIN (SKPVB)

Këto udhëzime propozojnë si më poshtë:

↪ *Proçesi*

1) Vendosni kontakte dhe bashkëpunoni me Pikat Kombëtare të Përfaqësimit për KDB-në dhe konventa të tjera që kanë lidhje me biodiversitetin
2) Njihuni me vendimet e KDB-së, programet e punës, objektivat etj. dhe lidhjen e tyre me CMS-në
3) Përgatisni një proces të veçantë planifikimi për konventën CMS, për identifikimin dhe prezantimin e prioriteteve të saj në procesin e SKPVB-së

   ↪ Procesi duhet të marrë parasysh sesi mund të kontribuojnë sa më mirë mjetet e CMS-së në realizimin e objektivit të përgjithshëm të vitit 2020 për biodiversitetin dhe 20 Objektivat shoqëruese të Aichi.
4) Promovoni integrimin koherent të llojeve shtegtare në SKPVB-të e Shteteve të Shtrirjes
5) Përfshihuni plotësisht në procesin e SKPVB-së
6) Siguroni informacionet bazë për llojet shtegtare, për procesin e SKPVB, për vendet që janë pjesë e Shteteve Shtrirëse

↪ *Mjetet për zbatimin:*

7) Promovoni përmirësimin e monitorimit dhe të kërkimit për llojet shtegtare
8) Promovoni objektivat dhe treguesit për llojet shtegtare
9) Promovoni krijimin e rrjeteve të zonave të mbrojtura, si të dobishme për llojet shtegtare
10) Promovoni rehabilitimin e habitateve për llojet shtegtare
11) Promovoni dispozitat për përdorimin e qëndrueshëm të llojeve shtegtare në SKPVB
12) Promovoni integrimin e llojeve shtegtare në Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor (VNM) dhe Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM)
13) Promovoni aktivitetet publike dhe të komunikimit në lidhje me llojet shtegtare
14) Eksploroni vlerën e llojeve shtegtare dhe potencialin për mbrojtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm
15) Promovoni ruajtjen e njohurive tradicionale, novacioneve dhe praktikave të komuniteteve lokale dhe banorëve vendas në lidhje me llojet shtegtare
16) Mobilizimi i burimeve

↪ *Trajtimi i kërcënimeve ndaj llojeve shtegtare:*

17) Ndryshimi i klimës
18) Llojet e huaja invazive/pushtuese
19) Kërcënimet e shkaktuara nga aktivitetet e sektorit ekonomik

Burimi: Udhëzimet për Integrimin e Ruajtjes së Specieve Shtegtuese në SKPVBs
http://www.cms.int/bodies/COP/cop10/docs_and_inf_docs/doc_27_guidelines_nbsap_e.pdf

Opsioni 2: Plan Zbatimi Kombëtar, i veçantë për llojet shtegtare (PKZ)

Në rast se integrimi i llojeve shtegtare në SKPVB nuk është një opsion i zbatueshëm, alternativa mund të jetë zhvillimi i një Plani Zbatimi Kombëtar, specifik për konventën CMS dhe/ose instrumentet e saj. Një PKZ duhet të fokusohet më shumë në zbatimin konkret të CMS-së dhe instrumenteve të saj sesa në zhvillimin e një strategjie kombëtare {→ shih Kutinë e informacionit 5.3 për detaje}. Plani PKZ duhet të jetë, po ashtu, më shumë i një natyre tematike dhe mund të mos kërkojë miratim zyrtar në një nivel të lartë politik (p.sh. nga Parlamenti), por mund të miratohet nga ministria përkatëse. Për t'i dhënë rëndësinë e duhur politike, ministria, më shumë sesa PKP, mund të marrë drejtimin për zhvillimin e një plani të tillë, në konsultim me agjensitë qeveritare dhe aktorët e tjerë.

Avantazhi me këtë metodë qëndron në faktin se proçedura do të jetë më e menaxhueshme se një SKPVB dhe nevojat për ruajtjen e llojeve shtegtare do të jenë më të qarta - ato do të jenë më pak të spikatura në rastet kur përfshihen në një SKPVB. Disavantazhi, është rreziku kryesor për një mbështetje më të pakët politike dhe financiare nga qeveria në tërësi, në lidhje me zbatimin e një plani të tillë.

KUTI INFORMACIONI 5.3

Një plan orientues për një plan PKZ

1. **Hyrja që përshkruan;**
   a. ***Rëndësinë e llojeve shtegtare*** - rëndësia e llojeve shtegtare, parë nga një këndvështrim mjedisor, ekologjik, gjenetik, shkencor, estetik, argëtues, kulturor, edukativ, social dhe ekonomik
   b. ***Statusin e mbrojtjes për llojet shtegtare*** në vend dhe rreziqet kryesore me të cilat ndeshen p.sh. ndotja, ndryshimi i klimës, kapja e paligjshme e tyre, llojet invazive/pushtuese, linjat elektrike, impiantet e energjisë së erës etj.
   c. ***Instrumentet e CMS-së*** në të cilat vendi është një Shtet Anëtar, rëndësia e këtyre instrumenteve dhe vendimet e marra për vendin në kuadër të tyre;
   d. ***Kuadri konstitucional, ligjor dhe institucional*** në lidhje me llojet shtegtare;
   e. ***Mësimet e nxjerra nga Raportet Kombëtare*** të paraqitura për konventën CMS dhe/ose instrumentet e saj ku vendi ka qenë për një kohë të caktuar Shtet Anëtar.
2. **Plani i Zbatimit**
   a. Veprimet Kombëtare për zbatimin e CMS-së dhe/ose instrumentit të saj dhe vendimet përkatëse të marra nëpërmjet:
      i. ***Rishikimit të legjislacionit ekzistues*** **kombëtar** dhe nëse duhet, rekomandimet për të filluar një proces për zhvillimin ose amendimin e legjislacionit të tillë. Në parim, në kohën e aderimit në konventën CMS dhe/ose instrumentit të saj, mund të jenë hedhur hapa për të përshtatur legjislacionin kombëtar me dispozitat e këtyre instrumenteve. Këshillohet që të kontrollohet nëse kjo është kryer tashmë në momentin e aderimit në CMS dhe/ose instrumentet e saj. Për shkak të natyrës dinamike të funksionimit të konventës CMS dhe instrumenteve të saj, vendimet e reja të marra mund të kërkojnë krijimin e ligjeve të reja ose amendimin e atyre ekzistuese.
      ii. ***Aktivitete specifike të ruajtjes*** duhet të propozohen për të ndaluar ose zbutur ndikimin e kërcënimeve me të cilat përballen llojet shtegtare: për shembull, zhvillimi i një Plan Veprimi Kombëtar për një Lloj të caktuar (shpesh në bazë të një Plani Veprimi Ndërkombëtar për një lloj të caktuar), ruajtja dhe mbrojtja e habitateve kryesore për llojet shtegtare, ose mbrojtja e një rrjeti ekologjik.
      iii. ***Aktivitetet e kërkimit dhe monitorimit.*** Për të vlerësuar statusin e mbrojtjes të llojeve shtegtare në nivel kombëtar, kërkohet monitorimi i llojeve dhe habitateve të tyre.

vazhd. nga fq. 73

KUTI INFORMACIONI 5.3

Mund të bëhen kërkime të tjera për të zbuluar rrugët e shtegtimit të përdorura nga specie të caktuara, ose si se të ndalohen kërcënime të caktuara.

iv. ***Ngritja e kapaciteteve për të mbështetur zbatimin*** *e* planit kombëtar të zbatimit mund të jetë po ashtu e nevojshme për të siguruar që ka kapacitete të përshtatshme për zbatimin e tij.

v. ***Komunikimi, Edukimi, Pjesëmarrja dhe Ndërgjegjësimi (CEPA) në Plan*** *për ta promovuar atë, mes vendimarrësve dhe publikut të përgjithshëm, p.sh. nëpërmjet një fushate për llojet {→shih Kutinë e Informacionit të CEPA më poshtë}*

vi. ***Mobilizimi i burimeve për zbatimin e Planit*** në nivel kombëtar në nivel kombëtar dhe më tej, për t'u siguruar se burimet financiare dhe/ose njerëzore janë të gatshme për të kryer aktivitetet e sipërpërmendura, si dhe zbatimin aktual të aktiviteteve në terren

vii. ***Integrimi i mbrojtjes së specieve shtegtare në planet ndërsektoriale*** si për zhvillimin e qëndrueshëm, uljen e varfërisë, përshtatjen dhe zbutjen e ndryshimeve të klimës, bashkëpunimin tregtar dhe ndërkombëtar, por edhe në planet specifike të sektorëve si; bujqësia, peshkimi, pylltaria, minierat, energjia, turizmi, transporti, financa, e të tjera.

viii. ***Zbatimi i planit PKZ në nivel shtetëror/provincial dhe lokal***. Megjithëse qeveria qëndrore është përgjegjëse për zbatimin e planit PKZ, është e qartë se në shumë vende autoritetet janë edhe në nivel shtetëror/provincial ose lokal. Kjo do të thotë se qeveria duhet të fillojë, të nxisë dhe të mbikëqyrë zbatimin nga këto autoritete.

ix. ***Bashkëpunimi ndërkombëtar për të ruajtur ose përmirësuar statusin e mbrojtjes të llojeve specifike*** kërkon që të gjitha Shtetet Shtrirëse të punojnë së bashku. Në planin PKZ mund të rendi-tet bashkëpunimi ekzistues në nivel ndërkombëtar dhe të trajtohet nevoja për një bashkëpunim më të gjerë.

x. ***Rekomandohet shumë Krijimi i një Proçesi Këshilimi Kombëtar*** për të koordinuar dhe moni-toruar zbatimin e planit PKZ. Kompleksiteti në lidhje me mbrojtjen e llojeve shtegtare dhe përfshirja e shumë aktorëve justifikon krijimin e një Procesi të tillë Këshillimi Kombëtar, i cili do të ndihmojë në ndarjen e detyrave mes anëtarëve të ndryshëm.

3. Monitorimi, Vlerësimi dhe Raportimi

Ka një rëndësi të madhe për të vlerësuar arritjet e bëra në zbatimin e planit PKZ dhe ato që duhet të bëhen më tej. Hapi 6 do të japë më shumë informacione lidhur me këtë aspekt të Planit. { → shih Kapitullin 6 mbi Raportimin Kombëtar}

4. Proçedura për rishikimin e planit PKZ

Plani duhet të përfshijë dispozita që identifikojnë se kur dhe nga kush do të rishikohet në mënyrë periodike. Elementët kryesorë mund të përfshijnë PKP dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm. Shpeshtësia e rishikimeve mund të përshtatet me shpeshtësinë e takimeve të organeve vendimarrëse.

Opsioni 3: Një ndërthurje e Planit SKPVB dhe PKZ

Siç tregohet në Opsionin 1, një disavantazh i integrimit të llojeve shtegtare në SKPVB është se vëmendja ndaj tyre mund të jetë më e pakët. Në të njëjtën kohë, planet SKPVB që merren me çështje më të gjera të biodiversitetit, i trajtojnë shqetësimet për llojet shtegtare në mënyrë të përgjithshme, pa hyrë në detaje të hollësishme. Sidoqoftë, nëpërmjet zhvillimit të një plani PKZ, çështjeve që kanë lidhje me llojet shtegtare mund t'ju kushtohet një vëmendje më e madhe.

Me integrimin e llojeve shtegtare në planet SKPVB (Opsioni 1) ndërkohë që në të njëjtën kohë zhvillohet një

KUTI INFORMACIONI 5.4

Komunikimi, Edukimi [Pjesëmarrja] dhe Ndërgjegjësimi [Publik] (CEPA)

Akronimi CEPA do të thonë Komunikim, Edukim dhe Ndërgjegjësim Publik (si në rastin e konventës KDB, ASCOBANS dhe AEWA) ose Komunikim, Edukim, Pjesëmarrje dhe Ndërgjegjësim (si në rastin e Konventës Ramsar). Komunikimi, Edukimi dhe Ndërgjegjësimi Publik janë aktivitete të rëndësishme për të siguruar lidhjen midis teorisë shkencore dhe kushteve ekologjike nga njëra anë, dhe realitetit social dhe ekonomik me të cilin ndeshen njerëzit në anën tjetër. Programi CEPA 2009-2015 i konventës Ramsar u miratua në Konferencën e 10të të Palëve në Changwon, Kore, në vitin 2008; në takimin e 17të të Komitetit Këshillimor të ASCOBANS (Tetor 2010) u miratua plani CEPA për marrëveshjet, ndërsa për marrëveshjen AEWA, aktivitetet e CEPA mbulohen nga Rezoluta 5.5 "Zbatimi dhe Rishikimi i Strategjisë së Komunikimit" të miratuar në TP-5 në vitin 2012.

plan PKZ shumë më i detajuar, ku përcaktohen prioritetet për vendin, për mënyrën e zbatimit të konventës CMS dhe/ose instrumenteve të saj, mund të sigurohet një vëmendje maksimale. Kjo do të sjell një nivel më të lartë të mbështetjes politike, një akses më të mirë në burime dhe në të njëjtën kohë një vizibilitet më të lartë për mbrojtjen e llojeve shtegtare.
Një skicë se si mund të strukturohet një plan SKPVB është i përfshirë {→ shih Aneksin 5.1}.

5.2.5 Hapi 5 Nxit dhe Lehtëso Zbatimin e Planit Kombëtar Strategjik të Veprimit për Biodiversitetin (SKPVB) dhe/ose Planit Kombëtar të Zbatimit (PKZ)

Pas përfundimit dhe miratimit nga qeveria të Planit Kombëtar Strategjik të Veprimit për Biodiversitetin (SKPVB) dhe/ose Planit Kombëtar të Zbatimit (PKZ), ai duhet të hyjë në fazën e zbatimit. Promovimi dhe mbështetja e zbatimit të konventës CMS dhe instrumenteve të saj janë pjesë e përgjegjësive të PKP-së. Për këtë arsye, në përgjithësi pritet që Pika Kombëtare e Përfaqësimit të luajë rol në zbatimin e planit SKPVB dhe/ose PKZ.

Pritet që plani SKPVB dhe/ose PKZ të identifikojnë së pari se kush është përgjegjës për kryerjen e aktiviteteve të parashikuara nga plani dhe së dyti - për sa është e mundur - burimet e disponueshme për zbatimin e tyre. Në këtë kuadër, roli i Pikës Kombëtare të Përfaqësimit duhet të përfshijë, kryesisht, nxitjen e veprimeve nga aktorë të ndryshëm, duke siguruar dhe mbështetur përkatësisht koordinimin dhe sinergjitë mes aktiviteteve të ndryshme, dhe duke u përpjekur të eliminojë mangësitë për ato aktivitete, për të cilat, në planin SKPVB dhe/ose PKZ nuk mund të identifikohen më parë organi drejtues dhe/ose burimet.

Paragrafi i mëposhtëm nënvizon disa nga funksionet kryesore të Pikës Kombëtare të Përfaqësimit për të siguruar dhe promovuar zbatimin e planit SKPVB dhe/ose PKZ. Ajo që është e rëndësishme; pjesë të këtyre funksioneve, kryesisht ato që lidhen me monitorimin e realizimit të planit SKPVB dhe/ose PKZ, mund të plotësohen nëpërmjet mekanizmit kombëtar të konsultimit.

1. **Siguroni një komunikim të vazhdueshëm në nivel kombëtar gjatë të gjitha fazave të ndryshme të zbatimit të planit SKPVB dhe/ose PKZ**

Ky funksion është shumë i rëndësishëm dhe pritet të ndikojë në mënyrë të konsiderueshme në efektivitetin e realizimit të funksioneve të tjera të renditura më poshtë {→ shih gjithashtu Paragrafin 3.2 për Komunikimin dhe Shpërndarjen e Informacioneve}.

Është thelbësore që Pika Kombëtare e Përfaqësimit të komunikojë rregullisht me aktorët kryesorë në të gjitha fazat e zbatimit. Komunikimi është çelësi për të siguruar mbështetje për zbatimin e aktiviteteve për mbrojtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të llojeve shtegtare. Komunikimi efikas do të forcojë kapacitetet institucionale të Pikave Kombëtare të Kontaktit, do të lidhë më mirë departamentet përkatëse qeveritare dhe aktorët e tjerë, dhe do të promovojë sinergjitë dhe bashkëpunimin që lidhet me mbrojtjen dhe menaxhimin e llojeve shtegtare. Në këtë aspekt, zhvillimi i një plani CEPA mund të jetë i vlefshëm dhe duhet të jetë, mundësisht, pjesë e vetë planit SKPVB dhe/ose PKZ {→ shih gjithashtu Kutinë e Informacionit 5.3 dhe 5.4}.

2. Nxitni fillimin e veprimeve të përcaktuara në planin SKPVB dhe/ose PKZ, nga drejtuesit e aktiviteteve

Një funksion kryesor i Pikave Kombëtare të Përfaqësimit është koordinimi i aktiviteteve të dakordësuara më parë, për zbatimin në nivel kombëtar. Kjo mund të realizohet nëpërmjet mbajtjes së një pasqyre të "kush bën çfarë" në zbatimin e planit dhe duke i kujtuar drejtuesit e aktiviteteve për rolin dhe angazhimet e tyre. Pikat Kombëtare ë Përfaqësimit mund të kenë rolin e informimit për zyrtarin e nivelit të lartë.

3. Kur është e përshtatshme, promovoni integrimin e elementeve përkatëse të planit SKPVB dhe/ose PKZ në strategjitë, politikat, planet dhe programet e tjera sektoriale dhe ndërsektoriale

KUTI INFORMACIONI 5.5

Çfarë është integrimi i politikave?

"Integrimi i politikave" do të thotë: integrim i mbrojtjes dhe përdorimit të qëndrueshëm të biodiversitetit në planet ndërsektoriale si; zhvillimin e qëndrueshëm, uljen e varfërisë, përshtatjen/zbutjen e ndryshimeve të klimës, bashkëpunimin tregtar dhe ndërkombëtar, si dhe në planet specifike të sektorëve si bujqësia, peshkimi, pylltaria, minierat, energjia, turizmi, transporti, financa e të tjera. Ai nënkupton ndryshime në modelet përkatëse, strategjitë dhe modelet e zhvillimit.

Burimi: Përditësimi i Strategjive Kombëtare për Biodiversitetin dhe Planeve të Veprimit është në përputhje me Planin Strategjik për Biodiversitetin 2011-2020 dhe Objektivat e Aichi për biodiversitetin

Politika për mbrojtjen e llojeve shtegtare nuk duhet parë e ndarë nga politikat e tjera sektoriale dhe ndërsektoriale; por politikat sektoriale dhe ndërsektoriale duhet të shikohen më shumë si mjete nëpërmjet të cilave mund të ruhen llojet shtegtare. Përpjekjet për integrimin e politikave {→ shih Kutine e Informacionit 5.5} duhet të jenë pjesë e vetë planit SKPVB dhe/ose PKZ {→ shih gjithashtu Paragrafin 5.2.4}. Planet specifike të sektorëve përfshijnë planet që lidhen me bujqësinë, peshkimin, pylltarinë, minierat, energjinë, turizmin, transportin dhe të tjera, ndërsa planet ndërsektoriale mund të lidhen me zhvillimin e qëndrueshëm, uljen e varfërisë, përshtatjen/zbutjen e ndryshimeve klimatike, tregtinë dhe bashkëpunimin ndërkombëtar.

4. Monitorimi i progresit në zbatimin e komponentëve përkatës të planit SKPVB dhe/ose PKZ dhe sigurimi i një lidhjeje me proçesin e raportimit kombëtar për Konventën dhe instrumentet përkatëse

Përgjegjësia për monitorimin e zbatimit të planit SKPVB dhe/ose PKZ mund të jetë detyrë e Pikës Kombëtare të Përfaqësimit, ose si alternativë, mund t'i jepet një komiteti ose një grupi me shumë aktorë. Një komitet ose një grup i tillë, mund të përfshijë përfaqësues të aktorëve të njëjtë (ose një nënkategori të tyre) që kanë marrë pjesë në procesin e konsultimit kombëtar. Edhe në rastin e dytë, Pikat Kombëtare të Përfaqësimit

pritet të luajnë një rol qëndror në ndihmë të këtyre punëve. Në rolin e tyre si koordinatorë të procesit të Raportimit Kombëtar {→ shih Kapitullin 6} Pikat kombëtare të Përfaqësimit duhet të sigurojnë po ashtu që progresi i arritur do të regjistrohet rregullisht për të thjeshtuar proçesin e hartimit dhe sintetizimit të informacioneve kur pritet Raporti Kombëtar.

5. Përpjekja për të identifikuar dhe përfshirë aktorë të tjerë për kryerjen e aktiviteteve për të cilat nuk mund të identifikohet një drejtues në planin SKPVB dhe/ose PKZ

Në fazën e planifikimit mund të mos jetë gjithmonë e mundur të identifikohet se kush është përgjegjës për aktivitetet dhe projektet e parashikuara nga plani SKPVB dhe/ose PKZ, dhe në një rast të tillë, Njësia Koordinuese pritet të lidhet në mënyrë aktive me aktorët e aftë dhe të gatshëm për të drejtuar zbatimin e pjesëve specifike. Zakonisht, do të përfshihen departamentet qeveritare, agjensitë e specializuara dhe pjesë të shoqërisë civile si organizatat joqeveritare (OJQ), institucionet dhe sektori privat. Mund të përfshihen po ashtu aktorë ndërkombëtarë, si organizata joqeveritare ndërkombëtare. Kërkimi për drejtues, për zbatimin e elementeve të planit, mund të kryhet paralel me identifikimin e burimeve për zbatimin pikërisht të këtyre elementeve.

6. Promovimi/mbështetja e identifikimit të burimeve për zbatimin e masave/aktiviteteve për të cilat burimet nuk mund të identifikoheshin në fazën e planifikimit

Ndërkohë që plani SKPVB dhe/ose PKZ, mundësisht, duhet të kenë identifikuar tashmë burimet e nevojshme për të mbështetur zbatimin e aktiviteteve dhe projekteve të parashikuara, kjo mund të mos jetë gjithmonë e mundur, kryesisht kur periudha e mbuluar nga plani nuk përputhet me ciklin e buxhetit të vendit. Ndërkohë që përgjegjësia për sigurimin e burimeve të duhura pritet të ndahet mes drejtuesve dhe aktorëve të ndryshëm të aktiviteteve, pritet, gjithashtu, që Njësia Koordinuese të luajë një rol aktiv. Shumë nga burimet financiare do të duhet të gjenden brenda vendit dhe çdo vend do të ketë institucionet dhe proçedurat e tij përkatëse. Ajo që është e rëndësishme; zbatimi i disa aktiviteteve/projekteve të parashikuara nga plani mund të sjellin të ardhura (p.sh. nga turizmi), të cilat duhet të jenë përsëri të disponueshme për zbatimin e planit. Po ashtu, mbështetja nga sektori privat duhet të kërkohet në mënyrë aktive {→ shih Shembullin Praktik 2.1}.

Burimet e vendit, në shumë raste, mund të mbështeten nga burime shumëpalëshe ose dypalëshe. Njësitë Koordinuese të vendeve në zhvillim, normalisht, duhet të njohin agjensitë e bashkëpunimit dhe të zhvillimit të vendeve të tjera, ose agjensitë ndërkombëtare dhe organizatat joqeveritare që mbështesin projektet në vendet e tyre, dhe që kanë interes në financimin e aktiviteteve në fushën e mbrojtjes së faunës. Njësitë Koordinuese pritet të luajnë rol në lehtësimin e kontaktit mes donatorëve të mundshëm dhe drejtuesve të aktiviteteve.

7. Promovimi i aktiviteteve për edukimin dhe ndërgjegjësimin publik

Edukimi dhe ndërgjegjësimi publik kanë një rëndësi të madhe për të siguruar mbështetje për zbatimin e konventës CMS dhe instrumenteve të saj në të gjitha nivelet e shoqërisë. Një larmi e madhe e aktiviteteve mund të parashikohen, kur më parë identifikohen në planin CEPA gjatë kohës së zhvillimit të instrument {→ shih Kutinë e Informacioni 5.4 më sipër}. Njësitë Koordinuese, ndërkohë që nuk pritet të jenë domosdoshmërisht drejtuese, pritet të promovojnë dhe të mbështesin zhvillimin e iniciativave të planit CEPA në vendet e tyre. Kjo duhet të realizohet sidomos në lidhje me pjesëmarrjen e vendit në fushatat dhe iniciativat e promovuara nga konventa CMS dhe instrumentet e saj, si p.sh. Dita Botërore e Shpendëve Migratorë (WMBD) dhe fushatat për llojet shtegtare. {→ shih Kutinë e Informacioni 5.6, 5.7 dhe Shembullin Praktik 5.3}

KUTI INFORMACIONI 5.6

Dita Botërore e Shpendëve Shtegtarë

Elementët informues si; fushatat e ndërgjegjësimit publik, janë po ashtu një instrument i rëndësishëm për të mbështetur përpjekjet për procesin e zbatimit. Një shembull i një fushate të ndërgjegjësimit publik, për të cilin Njësitë Koordinuese nxiten të nisin aktivitete në nivel kombëtar, është Dita Botërore e Shpendëve Migratorë (WMBD). Kjo fushatë ka filluar në vitin 2006 dhe është zhvillohet çdo vit, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit, dhe nënvizon nevojën për mbrojtjen e shpendëve shtegtarë dhe habitateve të tyre. Në fundjavën e dytë të muajit maj, njerëzit në të gjithë botën ndërmarrin veprime dhe organizojnë aktivitete publike si; festivale të shpendëve, programe edukimi dhe ekskursione për të vëzhguar shpendët me rastin e festimit të Ditës Botërore të Shpendëve Shtegtarë.

Këto lloj fushatash janë jashtëzakonisht efektive për rritjen e ndërgjegjësimit në publik dhe janë sidomos të rëndësishme për llojet që njihen më pak.

http://www.worldmigratorybirdday.org/

KUTI INFORMACIONI 5.7

Fushatat për Llojet

Konventa CMS ka organizuar një seri fushatash për llojet: Fushata "Viti i ...". Ato kanë filluar në vitin 2006 me Vitin e Breshkës, Vitin e Delfinit, 2007-2008 dhe Vitin e Gorillës, 2009.

Dyvjeçari 2011-2012 u quajt Viti i Lakuriqit të Natës dhe kjo fushatë ndihmoi për të rritur njohuritë dhe njohjen në nivel botëror të rolit të lakuriqëve të natës dhe rëniet e numrit të popullatës së tyre. Po ashtu, në vitin 2011 nisi një fushatë rajonale e quajtur "Viti i Dugongut të Paqësorit" që synonte rritjen e ndërgjegjësimit në komunitetet përkatëse për Dugongun (Dugong dugong), në mënyrë të veçantë në zonat ku aktivitetet njerëzore mund të rrisin më shumë përpjekjet për mbrojtjen. Fushata për Dugongun përfshiu shkollat vendase me programe edukative për fëmijët dhe nxiti mbulimin nga media, duke ofruar çmime dhe organizuar diskutime, në internet, në radio dhe në televizione.

8. Nisja dhe mbështetja e procesit të rishikimit të legjislacionit ekzistues, ose sipas rastit zhvillimi i legjislacionit të ri

Kur identifikohet nevoja për rishikimin e legjislacionit kombëtar ekzistues dhe/ose zhvillimi i legjislacionit të ri {→ shih Paragrafet 5.2.2 dhe 5.2.4} Njësia Koordinuese pritet të luajë rol në nisjen e procesit, në ndjekjen e tij gjatë hapave të ndryshme dhe në përpjekjet për të shmangur pengesat kur ky proces ndeshet me vonesa ose bllokime. Mund të jetë e dobishme ndihma nga ana e ministrive, departamenteve dhe agjensive të tjera, anëtarëve të parlamentit ose komisioneve përkatëse parlamentare, grupeve të punës ose komisioneve qeveritare ndërsektoriale, për të ndihmuar në mbështetje të një pune të tillë.

9. Sigurimi i koordinimit dhe sinergjive në zbatim me MEA-t e tjera përkatëse

Njësia Koordinuese nxitet që të mbajë kontakte të rregullta me Njësitë Koordinuese të marrëveshjeve MEA

SHEMBULL PRAKTIK 5.3

Dita Botërore e Shpendëve Shtegtarë në Uganda, 2010

NatureUganda, Partner i BirdLife International në Uganda, mori pjesë në festimet e vitit 2010, me temën "Ruajini shpendët shtegtarë në krizë - çdo lloj ka rëndësinë e vet!". Për të festuar këtë ditë, NatureUganda organizoi një ekskursion që kishte lidhje me shpendët, në gjirin Mabamba, një nga pikat e shtegtimit të shpendëve në vend.

Gjiri Mabamba është një Zonë e Rëndësishme për Shpendët (IBA) dhe një pikë Ramsar, si dhe një nga pikat më interesante dhe spektakolare në vend për të vëzhguar shpendët. Kjo zonë është e njohur për lloje të rrezikuara në nivel global si; Lejleku sqepkëpuce (*Balaeniceps rex*), Dallëndyshja blu (*Hirundo atrocaerulea*) dhe Bilblithi i verdhë i papiruseve (*Calamonastides gracilirostris*). Gjiri është një pikë ndalëse shtegtimi për grupe mjaft të mëdha të dallëndysheve të detit dhe pulëbardhave, si dhe një habitat i rëndësishëm për llojet vendase si; rosat, lejlekët, çafkat dhe baltakët e familjes Jacanidae.

Ky organizim synonte rritjen e ndërgjegjësimit mes anëtarëve të NatureUganda, komuniteteve lokale përreth zonës së shtegtimit dhe publikut të gjerë, për shpendët shtegtarë që rrezikohen në botë. Në mënyrë më specifike, qëllimi ishte të theksohej sesi shpendët shtegtarë janë një pjesë integrale e diversitetit biologjik të ekosistemeve dhe sesi rreziku i zhdukjes së llojeve individuale të shpendëve ndikon në llojet e tjera dhe në ekosistemin e përgjithshëm.

Burimi: http://www.natureuganda.org/and http://www.worldmigratorybirdday.org/2010/index.php?option=com_content&view=article&id=9&Itemid=9

të tjera, me synimin që të ndajnë informacione mbi zbatimin e konventës CMS dhe/ose instrumenteve të saj, dhe të identifikojë mundësitë për sinergji dhe bashkëpunim. Pas realizimit të procesit të konsultimit kombëtar, ky kontekst do të jetë i përshtatshëm për kryerjen e një koordinimi të tillë. Normalisht pritet edhe pjesëmarrja e Njësive Koordinuese në mekanizmat e konsultimit kombëtar të MEA-ve të tjera {→shih Paragrafin 5.3.2 për informacione shtesë dhe këshilla}.

10. Mbështetja e kërkimit dhe monitorimi

Nxitja e programeve specifike të kërkimit dhe monitorimit për ndjekjen e proçesit në kuadër të realizimit të objektivave kombëtare për speciet shtegtuese është një aktivitet i rëndësishëm për promovim kombëtar. Proçeset e monitorimit duhet të mbledhin informacione plotësuese, nëpërmjet kryerjes së inspektimeve dhe vrojtimeve. Kjo duhet të sjellë përditësimin dhe rishikimin periodik të planeve PSKVB ose strategjive të tjera të zbatimit, nëpërmjet të cilave rritja e informacioneve shkencore të siguruara nga monitorimi dhe vlerësimi i çdo faze zbatimi përfshihet në proçesin e përhershëm të rishikimit.

11. Promovimi i Instrumenteve Ekonomike dhe Financiare në Mbështetje të Zbatimit

Ekziston një gamë e gjerë e përgjigjeve ekonomike në nivel kombëtar, në mbështetje të zbatimit të suksesshëm të çdo Marrëveshjeje Shumëpalëshe për Mjedisin (MEA). Në përgjithësi, çdo aplikim fillestar i instrumenteve ekonomike dhe financiare duhet të paraprihet nga kontrolli i rregulloreve ekzistuese për subvencione të mundshme "jo të mira" (ato që bëjnë po aq dëm sa edhe mirë). Njësitë Koordinuese duhet të kenë parasysh se asnjë instrument i vetëm ekonomik nuk është më i miri për të gjitha tipat e problemeve të ekosistemit dhe situatave social-ekonomiket.

12. Miratimi i Planit PSKVB dhe/ose PKZ në ligj

Pas përgatitjes të njërës prej tyre, duhet të merret parasysh miratimi me ligj, gjë që në çdo rast, sidoqoftë, do të duhet të bëhet në shumë vende. Kjo mund të jetë e vlefshme edhe për një plan PKZ ose për rishikimin e

një ligji ekzistues për biodiversitetin, i cili amendohet për të përfshirë dispozita specifike për llojet shtegtare. Miratimi i planit PSKVB/PKZ me ligj do të ketë përfitime të dukshme, pasi ligji është i detyrueshëm. Po ashtu, kjo gjë do të përcaktojë më qartë objektivat e politikës kombëtare për biodiversitetin, do të identifikojë një vizion dhe rezultatet ideale, sipas nevojës do të përcaktojë çdo organ përgjegjës për monitorimin e zbatimit dhe, kur duhet, do të përcaktojë përgjegjësitë mes niveleve të ndryshme të qeverisë (në nivel kombëtar, shtetëror, provincial, bashkiakë ose nivel fshati).

13. Zhvillimi i Programeve të Zbatimit dhe Kuadreve Përkatëse

Një pjesë e rëndësishme e zbatimit është miratimi i ligjeve dhe rregulloreve të duhura, por, po aq i rëndësishëm është edhe zbatimi i tyre. Është e rëndësishme që të tregohet një vëmendje e kujdesshme për krijimin e programeve dhe një kuadri për zbatim, për t'u siguruar se individët ose organet, aktivitetet e të cilëve rregullohen nga to, janë në përputhje të ligjeve dhe rregulloreve.

14. Sekretariati/Njësia Koordinuese Mund të Ndihmojë

Ndërkohë që zbatimi i konventës CMS dhe instrumenteve të saj në nivel kombëtar është kryesisht përgjegjësi e Shteteve anëtare individuale, Sekretaria/Njësia koordinuese mbetet e gatshme për të ndihmuar Pikat Kombëtare te Përfaqësimit në promovimin e zbatimit, brenda limiteve të burimeve të tyre njerëzore dhe financiare.

5.2.6 Hapi 6 Monitorimi, Vlerësimi dhe Raportimi mbi Ecurinë e Zbatimit në Nivel Kombëtar

PSKVB-ja dhe/ose PKZ-ja duhet të përfshijnë rishikimin, monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të një vendi, në mënyrë që të përcaktojnë nëse konventa CMS-ja dhe instrumentet e saj po japin rezultate të dukshme, dhe nëse përmbushen detyrimet sipas instrumenteve. *

Monitorimet e ndërmarra në nivel kombëtar janë mjaft të rëndësishme për vlerësimin e ndikimit real të CMS-së dhe instrumenteve të saj, në synimet e tyre që lidhen me zbatimin. Me fjalë të tjera, monitorimi mat progresin e një vendi dhe ndihmon në identifikimin e sfidave specifike me të cilat mund të përballet një vend gjatë përmbushjes së objektivave të CMS-së dhe instrumenteve të saj. Raportet Kombëtare, procesi i përpilimit të të cilave mbikëqyret nga PKP-ja, shërbejnë si treguesi kryesor sesi instrumentet e Familjes CMS po zbatohen, si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel ndërkombëtar. {→ Kapitulli 6 shpjegon në detaje kriteret e raportimit.}

* Shih Udhëzuesin e UNEP-it 14(b) mbi implementimin e MEA-s: "Planet kombëtare të implementimit mund të nevojiten në një marrëveshje shumëpalëshe mjedisore, të cilat mund të përfshijnë monitorimin dhe vlerësimin e efekteve mbi mjedisin, në mënyrë që të përcaktohet nëse një marrëveshje shumëpalëshe mjedisore po sjell përmirësime në mjedis"

5.3 Aspektet Ndërkombëtare të Zbatimit

Duke pasur parasysh natyrën e llojeve shtegtare që lëvizin mes shteteve, implementimi i suksesshëm kombëtar do të varet nga bashkëpunimet në një nivel ndërkufitar, rajonal dhe nën-rajonal.* Ruajtja efektive e llojeve shtegtare kërkon bashkëpunim mes shteteve të zonës, mes ekosistemeve të përbashkëta ose shteteve të pozicionuara përgjatë rrugëve të shtegtimit. Do të jetë e nevojshme të bëhet një vlerësim se cilët elementë të zbatimit arrihen më mirë përmes bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar. Gjithashtu, mbështetja ndërkombëtare nga subjektet operacionale të Kombeve të Bashkuara dhe agjensive të specializuara, është një burim i rëndësishëm ndihme për zbatimin në nivel kombëtar, për të cilën mund të kenë nevojë PKP-të. Ky seksion mbulon aspektet ndërkombëtare të zbatimit dhe ndihmon në identifikimin e faktorëve kryesorë dhe proceseve kryesore që do të ndihmojnë PKP-të në zhvillimin e strategjive të vendit të tyre dhe në të kërkuarit ndihmë për promovimin e zbatimit të tyre.

5.3.1 Zbatimi Ndërkufitar dhe Rajonal

Zbatimi ndërkufitar është pjesa kryesore e instrumenteve të Familjes CMS, për shkak të natyrës shtegtuese të llojeve që ata mbulojnë. Për këtë arsye, zbatimi efikas duhet të rezultojë nga bashkëpunimi dhe koordinimi mes vendeve të shumta që janë të rëndësishme për një lloj të veçantë shtegtarë {→ shih Shembullin Praktik 5.4}. Nëpërmjet ndërlidhjeve dhe komunikimit, PKP-të janë faktorë të rëndësishëm në nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar {→ shih Figurën 5.1}. Disa programe bashkëpunuese janë zhvilluar për menaxhimin e burimeve të përbashkëta të specieve shtegtare ose ruajtjen e llojeve të veçanta.

SHEMBULL PRAKTIK 5.4

Ruajtja e Gorillave të Maleve në Uganda, Kongo dhe Ruanda

Vetëm 790 Gorilla Mali vazhdojnë të ekzistojnë në të gjithë botën. Pothuajse gjysma e tyre jetojnë në Parkun Kombëtar të Buindit në Uganda dhe gjysma tjetër kanë shtegtuar ndërmjet Ugandës, Republikës Demokratike të Kongos dhe Ruandës, në peizazhin Virunga. Në përpjekje për të shpëtuar këtë kushëri të afërt të njeriut, të treja vendet bashkëpunojnë në menaxhimin e Peizazhit Virunga, i cili shtrihet përgjatë të treja vendeve.

Këto tre vende kanë arritur ta rrisin popullatën e Gorillave të Malit në Peizazhin Virunga, nga 380 individë në vitin 2003 në 480 individë në vitin 2010. Kjo është arritur përmes një planifikimi të përbashkët, ndarjes së informacioneve, ekipeve të përbashkëta monitoruese gjatë lëvizjes së kafshëve, aktiviteteve të përbashkëta të zbatimit, kërkimit bashkëpunues, ndarjes së të ardhurave dhe angazhimit të vazhdueshëm të tre Qeverive në një bashkëpunim shumëpalësh.

Të treja vendet po e kalojnë tanimë bashkëpunimin nënjë nivel tjetër duke krijuar Traktatin e Bashkëpunimit më të Madh Ndërkufitar të Virungas, për të ofruar, nëpërmjet bashkëpunimit, masa konkrete për ruajtjen e të gjithë peizazhit dhe ekosistemeve të tij.

* Neni IV, paragrafi 4 i CMS-së i nxit palët të lidhin marrëveshje "për çdo popullsi apo pjesë gjeografikisht të ndarë të popullsisë së ndonjë specie ose taksoni më të ulët të kafshëve të egra, anëtarët e të cilave në mënyrë periodike kalojnë një ose më shumë prej kufijve të juridiksionit kombëtar." Shumë shpend dhe gjitarë ndjekin rrugët shtegtare që u dalin para ose ekosistemet e veçanta si zona për të pushuar dhe ushqyer.

Proceset e këshillimit nën-rajonale janë shumë të dobishme për të rritur shkëmbimin e informacionit ndërmjet grupeve të ndryshme të interesit, të cilët nuk do të ndërvepronin në formë tjetër me njëri-tjetrin.

MEA të tjera japin shembuj të dobishëm të bashkëpunimit nën-rajonal. Për shembull, Ramsar dhe Konventat e Trashëgimisë Botërore i nxisin shtetet e tyre anëtare të përcaktojnë vende, përmes të cilave individët, komunitetet dhe kombet, të punojnë për mbrojtjen e habitateve. Për Familjen CMS, , *identifikimi i korridoreve shtegtuese* në të gjithë vendet, ka nevojë për një bashkëpunim të fortë. Objektivi do të jetë rrjetëzimi i zonave potencialisht të mbrojtura, nëpërmjet krijimit të korridoreve shtegtuese, jashtë juridiksionit kombëtar dhe përtej kufijve ndërkombëtarë.* Sërish, bashkëpunimi ndërkufitar është një mjet kyç për të mbështetur qëllimet e instrumenteve të Familjes CMS. Në të njëjtën kohë, krijimi i korridoreve shtegtuese mund të ndihmojë në zgjimin e ndërgjegjes publike dhe qeveritare, siç është edhe rasti i Konventës Ramsar.

5.3.2 Bashkëpunimi me Organizatat Ndërkombëtare

Lidhja me organizatat e tjera që kanë qëllime apo objektiva të njëjta ofron mundësi të rëndësishme për bashkëpunim. Për shembull, shumë organizata jo-fitimprurëse janë duke punuar në mënyrë efektive në ruajtje dhe restaurim. Disa janë mjaft të përhapura në vende të ndryshme, duke siguruar një bazë për zhvillimin e marrëdhënieve ndërkombëtare. Për më tepër, bashkëpunimi me organizata të ndryshme mund të rrisë kapacitetet, përfshirë edhe komunikimin, lobimin, mbrojtjen, si dhe krijimin e partneriteteve.

Për PKP-të, nga disa vende ekzistojnë operacione specifike të OKB-së në nivel kombëtar që mund të jenë shumë të dobishme për integrimin e strategjive kombëtare në planifikimin e aktiviteteve, në sektorët ekonomik dhe shoqëror, të ndryshme nga mjedisi. Gjithashtu, ekzistojnë edhe mundësi për zhvillimin e mëtejshëm të ndihmës ndërkombëtare, në formën e ngritjes së kapaciteteve, ndihmës teknike dhe transferimit të teknologjisë, kjo gjë mund të nxisë zbatimin e strategjive kombëtare. Mjeti kryesor i OKB-së për këtë është Kuadrot e Ndihmës për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDAF). UNDAF-i është krijuar në konsultim me qeveritë e vendeve në zhvillim për ta përqëndruar ndihmën e OKB-së dhe masat e Ekipeve të Vendeve të OKB-së tek prioritetet e vendit. UNDAF përfshin rezultate, aktivitete dhe përgjegjësitë e agjensive të OKB-së, të cilat janë pranuar nga qeveritë {→ shih Kutine e Informacionit 5.8}.

Për PKP-të e vendeve në zhvillim, është i rëndësishëm krijimi i një dialogu me Ekipet e tyre Vendase të OKB-së dhe subjektet kombëtare, për t'u siguruar se strategjitë kombëtare për llojet shtegtare të bëhen pjesë e kuadrove të zhvillimit. Pasi të bëhen pjesë e mundësive për ndihmë, menjëherë, për të mbështetur zbatimin e strategjisë, do të gjenerohen këshilla dhe mundësisht ndihmë financiare. Duke qenë pjesë e dialogut për krijimin apo rishqyrtimin e UNDAF-ve, do të përmirësohet koordinimi dhe mund të jepet ndihmesë nga sektorë të tjerë që gjithashtu marrin mbështetje nga UNDAF-ja, për rrjedhën e strategjive që kanë vend për llojet shtegtare. Lidhjet me çështje të tjera mjedisore dhe strategjitë e MEA-s do të jenë të rëndësishme, sidomos për ato çështje, të cilat në kuadrin e ndihmës kombëtare kanë prioritet të lartë, të tilla si; ndryshimi i klimës, ujit dhe menaxhimit të mbetjeve, kimikateve dhe menaxhimit të biodiversitetit. Përveç kësaj, zhvillimi i një kuptimi të përbashkët sesi strategjitë e zbatimit për llojet shtegtare përshtaten me prioritetet kryesore botërore, të tilla si Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM) dhe Objektivat e ardhshëm për një Zhvillim të Qëndrueshëm (SDGs) dhe objektivat e Biodiversitetit Aichi, do të përmirësojnë rritjen e potencialit të strategjive mbi llojet shtegtare të UNDAF.

Fasiliteti Mjedisor Global (GEF), në nivel kombëtar, është një mekanizëm i fuqishëm financiar. Ai nuk është një mekanizëm financiar për konventën CMS dhe instrumentet e saj, por financon projekte të biodiversitetit, aktivitete dhe PSKVBs. Për këtë arsye, ai mund të jetë i dobishëm për të ndihmuar punën me llojet shtegtare të një vendi, në një kontekst më të gjerë të biodiversitetit.

* Shih psh. Vendimin VII / 28, shtojca, aktiviteti 1.3.7 i programit të punës për zonat e mbrojtura sipas CBD-së.the CBD.

Ekzistojnë disa organizata ndërkombëtare, ndërqeveritare dhe joqeveritare, që kanë përvojë, mandate apo burime, të cilat i mundësojnë të ndihmojnë vendet me strategji kombëtare dhe plane zbatimi. Organizata të tilla ndërqeveritare përfshijnë Organizatën Botërore të Ushqimit të Kombeve të Bashkuara (FAO), Universitetin e Kombeve të Bashkuara (UNU), Institutin e Kombeve të Bashkuara për Trajnim dhe Hulumtim (UNITAR) dhe të tjera, përfshirë këtu edhe organizatat rajonale. Organizatat joqeveritare përfshijnë Unionin Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN), Fondin Mbarëbotëror për Natyrën (WWF), Fauna dhe Flora Ndërkombëtare (FFI), Institutin e Burimeve Botërore (WRI), Mbrojtjen e Natyrës (TNC), BirdLife International, Wetlands International dhe të tjera.

Zbatimi i instrumenteve mund të mbështetet edhe nga seminare, mbledhje dhe aktivitete jashtë proceseve zyrtare institucionale. Këto mund të organizohen në bashkëpunim me Njësinë e Sekretarisë/Koordinimit dhe Shteteve Anëtare të instrumentit.

KUTI INFORMACIONI 5.8

UNEP dhe Integrimi i Qëndrueshmërisë Mjedisore në UNDAF dhe proçeset e përbashkëta të programimit të vendeve anëtare në OKB

UNEP ka qenë i angazhuar gjithnjë e më shumë në proceset e përbashkëta të programimit të vendeve, për të luajtur një rol më të dukshëm dhe efikas në adresimin e problemeve që lidhen me mungesën e kapaciteteve të UNCT-së, për integrimin e duhur të mjedisit në punën e tyre. Në veçanti, angazhimi i UNEP-së ka vënë në dukje disa ndërhyrje që kanë për qëllim forcimin e integrimit sistematik të qëndrueshmërisë mjedisore në analizën e vendit dhe UNDAF-të, përfshirë mbështetjen e Grupit të Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (UNDG) për të nxjerr udhëzimet për qëndrueshmërinë mjedisore, përfshirë politikat e MEA-s. Pjesa më e madhe e punës është përqëndruar në përgatitjen e përmbledhjeve mjedisore kombëtare, me qëllim përmirësimin e komponentëve mjedisorë të vendit, të cilët marrin pjesë në grupet tematike të punës midis agjensive dhe mbështesin integrimin mjedisorë tek rezultatet dhe matricat e UNDAF-së.

LISTË E PLOTË

Njohje/Analizë e tekstit të CMS-së dhe instrumenteve të saj, përfshirë kriteret e Raportimit Kombëtar

Rishikim dhe Rishqyrtim i Legjislacionit Kombëtar Ekzistues

- ❑ Rishikimi duhet të kontrollojë boshllëqet dhe mënyrën sesi legjislacioni dhe politikat ekzistuese mbështesin zbatimin e instrumenteve. Rishikimi nuk duhet të përqendrohet vetëm tek ekzistenca e legjislacionit kombëtar por duhet të parashikojë edhe zbatimin e tij.

Planifikimi i zbatimit duke ndjekur proçesin kombëtar të konsultimeve

- ❑ Këshillohuni me aktorë të ndryshëm në nivel kombëtar, përfshirë ministritë dhe ekspertë të tjerë teknik/shkencor, si dhe PKP-të e MEA-ve të tjera
- ❑ Procesi duhet të jetë i hapur, transparent dhe përfshirës, për të nxitur legjitimitetin dhe pronësinë për planet e zbatimit
- ❑ Krijoni ose bashkohuni me komitetet kombëtare ekzistuese për zbatimin e nevojave të ruajtjes së llojeve shtegtare

Zhvilloni Strategji Kombëtare dhe/ose Plane Zbatimi

- ❑ Për zhvillimin e një Strategjie Kombëtare dhe/ose Plani Zbatimi mund të merren në konsideratë këto variante:
  1. Integrimi i plotë i Llojeve Shtegtare në Strategjinë Kombëtare dhe Plan Zbatimin e Biodiversitetit (PVSKB)
  2. Plan Zbatimi Kombëtar më vete për Llojet Shtegtare (PKZ)
  3. Kombinim i PVSKB-së dhe PKZ-së

  Pavarësisht alternativës së zgjedhur, është e qartë se një strategji efikase mund të përpunohet me anë të një procesi këshillimi me pjesëmarrjen e plotë të të gjithë grupeve përkatëse të interesit.

Promovoni dhe bashkëpunoni për të mbështetur në mënyrë aktive zbatimin në terren

- ❑ Lidh vendimmarrjen me zbatimin në terren
- ❑ Përmirësoni planet kombëtare të zbatimit për ngritjen e kapaciteteve të CMS-së dhe instrumenteve të tij (p.sh. komunikimi dhe ndërgjegjësimi)
- ❑ Rishikim i burimeve kombëtare në dispozicion të zbatimit
- ❑ Siguroni burime financiare shtesë dhe burime të tjera për zbatim
- ❑ Studioni kalimin e një strategjie kombëtare dhe/ose strategjie zbatimi në ligj
- ❑ Zhvillim i kuadrove të zbatimit dhe miratimit

Monitorimi, vlerësimi dhe raportimi mbi Zbatimin Kombëtar

- ❑ Strategjitë dhe/ose planet kombëtare duhet të përfshijnë rishikimin, monitorimin dhe vlerësimin e aktiviteteve zbatuese të një vendi, për të përcaktuar nëse CMS-ja dhe instrumentet e saj po rezultojnë në përmirësime të dukshme dhe se po përmbushen detyrimet sipas instrumenteve.

Nxitja e zbatimit rajonal dhe ndërkufitar dhe zbatimi në nivel ndërkombëtar

- ❑ Angazhohen proçeset ndërkombëtare si UNDAF dhe GEF

PËRSËRITJE KAPITULLII

Pyetja 1: Ç'kuptim ka zbatimi në nivel kombëtar për kontekstin e konventës CMS?

Pyetja 2: Cilat qasje mund të përdoren si mjete për zbatimin e konventës CMS dhe instrumenteve të saj në nivel kombëtar?

Pyetja 3: Cilët janë elementët kryesorë për zbatimin në nivel kombëtar?

Përgjigjet:

1) Të vendosi obligimet dhe strategjitë e CMS dhe instrumentet e saj në politikën e brendshme dhe të ligjit 2) Plani Veprimit Strategjik Kombetar per Biodiversitetin (PVSKBS), PKZ ose kombinim i te dyjave 3) Konsultin, Koordinim, komunikim, raportimi kombetar, miratimin e strategjive dhe / ose planet e zbatimit në ligje, zbatimi i zhvilluar dhe korrizat e përputhshmërisë

Në kapitullin tjetër do të gjeni informacione lidhur me hapin e fundit të zbatimit, Raportet Kombëtare.

SHËNIME

ANEKSI 5.1
Paketë Trajnuese e SKPVB e KBD-se Versioni 2.1, Kutia 4
Shtjellimi e një SKPVB

I. HYRJE

Llogaritja e saktë e bazës së nevojshme, caktimi i kushteve për përditësimin e SKPVB dhe ofrimi i një mënyre të arsyetuari për strategjinë dhe veprimet që lidhen me të. Nëse është e nevojshme, mund të plotësohet me studime të thelluara që i shtohen SKPVB-së kryesore.

1. Vlerat e biodiversitetit, shërbimet e ekosistemit në vend dhe kontributi i tyre në mirëqënien e njeriut - Rëndësia e biodiversitetit për vendin. Thekson kontributin për mirëqenien e njeriut, zhvillimin socio-ekonomik, përfshirë edhe reduktimin e varfërisë. Përfshin analizën e vlerave ekonomike dhe jo vetëm.

2. Shkaqet dhe pasojat e humbjes së biodiversitetit - Kërcënimet kryesore për biodiversitetin (ekosistemet) dhe shkaqet e tyre themelore. Ndikimet e kërcënimeve në biodiversitet dhe ekosistemet, implikimet socio-ekonomike të këtyre impakteve. Përshkruani ndikimin e keqësimit të gjendjes së biodiversitetit dhe ekosistemeve në mirëqenien e njeriut, jetesës, uljen e varfërisë etj. Lidhini kërcënimet (nxitësit e drejtëpërdrejtë) me shkaqet themelore (nxitësit jo të drejtëpërdrejtë) dhe bashkangjitini ato në sektorët përkatës të ekonomisë.

3. Kuadri ligjor, kushtetues dhe institucional - Përmbledhje e politikave të biodiversitetit, të kuadrit të planifikimit, politikave më të gjera dhe proceseve të planifikimit (planeve zhvillimore kombëtare, strategjitë e uljes së varfërisë; planet përshtatëse me ndryshimet klimatike etj). Përfshin një përshkrim të çdo elementi të rëndësishëm kushtetues, ligjor dhe institucional.

4. Mësimet e nxjerra nga PVSKB**-të e mëparshme dhe proçesi i zhvillimit të SKPVB-së së përditësuar** - Një përshkrim i shkurtër i progresit të zbatimin të hershëm të SKPVB-së (ku nevojitet). Rezultatet përmbledhëse të çfarëdo vlerësimi të efikasitetit të SKPVB-së së hershme. Cilat janë sfidat dhe mangësitë që duhet të adresohen, dhe fushat kryesore prioritare për SKPVB-në e rishikuar. Gjithashtu mund të parashikojë skenarë për të ardhmen e biodiversitetit. Mund të përfshijë edhe reflektime të shkurtra për procesin e zhvillimit të SKPVB-së së hershme dhe sesi ajo mund të ketë ndikuar mbi efikasitetin e e saj. Shkurtimisht përshkruan procesin e përditësimit të SKPVB-së, përfshirë konsultimet me grupet e interesit.

II. STRATEGJIA KOMBËTARE MBI BIODIVERSITETIN: PARIMET, PRIORITETET DHE OBJEKTIVAT

Elementët kryesorë të nivelit të lartë të Strategjisë që ofrojnë kuadrin për SKPVB-në si një e tërë.

5. Vizioni afatgjatë - Përshkruan vizionin afatgjatë për gjendjen e biodiversitetit në vend. Kjo duhet të jetë një deklaratë frymëzuese që pasqyron rëndësinë e biodiversitetit për njerëzit dhe shpërndahet gjerësisht në të gjithë vendin. Kjo mund të jetë për vitin 2050 (siç është rasti për Planin Strategjik për Biodiversitetin 2011-2020), ose mund të jetë në një linjë me planet e tjera afatgjata të zhvillimit kombëtar.

6. Parimet që drejtojnë strategjinë - Vlerat dhe besimet themelore të SKPVB-së.

7. Synimet kryesore ose fushat prioritare - Çështjet më të rëndësishme që duhet të adresohen nga SKPVB-ja. Ndër to duhet të jenë synimet për të garantuar vazhdimësinë e biodiversitetit (p.sh integrimin e biodiversitetit në politikat, strategjitë dhe planet e gjera kombëtare).

8. Objektivat Kombëtare (SMART) - Objektivat kombëtare të biodiversitetit në përputhje me Objektivat Aichi të Biodiversitetit. Këto duhet të jenë strategjike, specifike, të matshme, ambicioze,

por realiste, me afate kohore (zakonisht për vitin 2020). Ato mund të grupohen sipas objektivave kryesore ose fushave prioritare.

III. PLAN ZBATIMI KOMBËTAR

Detajet e Strategjisë dhe Planit të Zbatimit.

9. Masat kombëtare për të arritur strategjinë me anë të piketave - Masat që nevojiten për arritjen e objektivave. Këto duhet të përfshijnë kryesisht masat strategjike si; masat institucionale, legjislative, ekonomike apo politike, dhe masat institucionale që garantojnë kushtet dhe nxitësit e nevojshëm për të arritur qëllimet dhe objektivat e PVSKB-së. Masat më specifike do të jenë treguese, duke provuar se qasjet do të duhet të përshtaten sipas përvojës së zbatimit. Plani duhet të përcaktojë se kush bën çfarë, ku, kur dhe si.

10. Aplikimi i PVSKB-ve tek subjektet nën-kombëtare - Si do të zbatohet PVSKB-ja në nivel shteti/rajoni (veçanërisht e rëndësishme për vendet federale, ose gjysmë-federale; vende në të cilat menaxhimin territorial ia kalojnë këtyre subjekteve) dhe në nivel lokal apo bashkiakë (përfshirë këtu edhe qytetet). Strategjia dhe plani kombëtar i veprimit mund të plotësohet nga versionet e nivelit lokal të planit (LBSAPs) të zhvilluara më vete.

11. Masa sektoriale - përqëndrimi në planet për zhvillim, ulje të varfërisë dhe ndryshimit klimatike-masat dhe hapat që do të merren për të integruar biodiversitetin në politikat, strategjitë dhe planet e gjera kombëtare (të tilla si planet e zhvillimit kombëtar, strategjitë për uljen e varfërisë; planet e përshtatjes me ndryshimet klimatike etj) dhe në politikat, strategjitë dhe planet sektoriale në të gjithë qeverinë, sektorin privat dhe shoqërinë civile.

IV. PLANET E ZBATIMIT

12. Plani për krijimin e kapaciteteve për zbatimin e PVSKB-së, duke përfshirë teknologjinë për vlerësimin e nevojave - Nevojat teknike dhe njerëzore për të zbatuar PVSKB-në dhe sesi mund të mobilizohen ato.

13. Komunikimi dhe strategjia e përhapjes së PVSKB-së. - Si do të promovohet PVSKB-ja në vend, mes vendimarrësve dhe publikut të gjerë (Kjo dallon nga aktivitetet CEPA të PVSKB-së - e cila do të futet në nën-seksionet e masave kombëtare dhe nën-kombëtare).

14. Plani për mobilizimin e burimeve për implementimin e PVSKB-së- Burimet financiare që nevojiten për zbatimin e NBSAP-së dhe sesi do të mobilizohen ato me të gjitha burimet, përfshirë buxhetin vendor, ndihmën e jashtme (ku nevojitet) dhe mekanizmat e reja financiare.

V. MONITORIMI DHE RAPORTIMI INSTITUCIONAL

15. Strukturat Kombëtare të Koordinimit - Cilat janë strukturat kombëtare, institucionet, partneritetet që do të udhëheqin, koordinojnë dhe sigurojnë zbatimin e PVSKB-së (p.sh. komitetet kombëtare, komitetet ndërministrore dhe Sekretaria ose Njësia Koordinuese për t'i mbështetur ato), identifikimi i qartë i roleve dhe përgjegjësitë e aktorëve të ndryshëm institucionalë. Nëse nevojitet, krijimi i mekanizmave koordinues me autoritetet vendore në krijimin dhe zbatimin e LBSAP-ve dhe/ose me partnerët rajonalë në rastin e strategjive rajonale.

16. Mekanizmi Clearing House - duke përfshirë zhvillimin dhe/ose përmirësimin e CHM-së kombëtare dhe si po përdoret ajo në mbështetje të zhvillimit dhe zbatimit të PVSKB-ve; zhvillimin e rrjetit kombëtar, (dhe rajonale, ku nevojitet) institucional për biodiversitetin.

17. Monitorimi dhe vlerësimi - Si do të monitorohet dhe vlerësohet zbatimi i PVSKB-së, përfshirë dispozitat për raportimin dhe identifikimin e treguesve, për të ndjekur progresin drejt objektivave ndërkombëtare.

6 Raportimi Kombëtar

"Proçesi i Raportimit Kombëtar është një pjesë thelbësore e proçesit të përgjithshëm të zbatimit të instrumenteve të Familjes CMS"

Raportet Kombëtare janë dokumente zyrtare me anë të të cilave vendet raportojnë tek organet vendimarrëse të Familjes CMS dhe/ose instrumenteve të saj, në lidhje me masat që kanë ndërmarrë për të zbatuar prioritetet e instrumenteve. Raportet Kombëtare shërbejnë, në mënyrë të përmbledhur, si një e dhënë zyrtare për zbatimin e çdo instrumenti dhe në mënyrë të veçantë tregojnë zbatimin e tij gjatë kalimit të kohës.

Procesi i Raportimit Kombëtar është thelbësor për funksionimin efikas të instrumenteve, dhe, kur bëhet siç duhet, mund të sjell përfitime të konsiderueshme si për instrumentin dhe për vendin në fjalë.

Procesi i raportimit ka vlerë të madhe për vetë vendet, pasi paraqet progresin e tyre dhe identifikon prioritetet e tyre që lidhen me procesin e zbatimit në të ardhmen. Ai gjithashtu ndihmon vendet të vlerësojnë zbatimin dhe të bëjnë planifikime me vende të tjera. Raportimi Kombëtar jep informacion për rritjen e ndërgjegjësimit nëpërmjet aktiviteteve kombëtare, përhapjen e çështjeve të zakonshme të biodiversitetit në të gjithë sektorët dhe nxit investime të mëtejshme të zbatimit të konventës CMS dhe instrumenteve të saj.

Ky kapitull do të paraqesë një pasqyrë të mëtejshme të proçedurave të Raportimit Kombëtar, duke trajtuar në mënyrë të veçantë këto çështje:

- Përse është i nevojshëm Raportimi Kombëtar? (Paragrafi 6.1)
- Përfitimet e Raportimit Kombëtar për Vendin Raportues (Paragrafi 6.2)
- Kur dhe Çfarë Raportohet (Paragrafi 6.3)
- Kush Raporton dhe Si Raportohet (Paragrafi 6.4)
- Hapat për Përpilimin e Raportit Kombëtar (Paragrafi 6.5)
- Dorëzimi i Raportit Kombëtar dhe Ndjekja (Paragrafi 6.6)

6.1 Përse është i nevojshëm Raportimi Kombëtar?

6.1.1 Si Përshtatet Raportimi Kombëtar në Procesin e Përgjithshëm të Zbatimit

Raportimi Kombëtar është një pjesë integrale e procesit të përgjithshëm të zbatimit të instrumenteve të Familjes CMS. Ky proces zakonisht ndodh në përfundim të periudhës midis seancave, para mbledhjeve të organeve vendimarrëse. Megjithatë, ai duhet të shihet si një proces i vazhdueshëm, themelor, që ndikon në planifikimin e aktiviteteve, zbatimin e tyre dhe vlerësimin e progresit të bërë në bazë të CMS-së dhe secilit prej instrumenteve të saj.

6.1.2. Baza ligjore për Raportimin Kombëtar

Të gjithë instrumentet e Familjes CMS përfshijnë dispozita për përgatitjen dhe dorëzimin e Raporteve Kombëtare para mbledhjeve të organeve vendimarrëse. Megjithatë, detyrimet ndryshojnë në varësi të statusit ligjor të instrumentit të CMS-së. Për CMS-në dhe marrëveshjet e saj - të cilat janë ligjërisht të detyrueshme - raportimi është një detyrim për çdo Palë. Megjithatë, nuk ka asnjë kriter të raportimit të detyrueshëm sipas Memorandumit të Mirëkuptimit, të cilët, në natyrë, janë ligjërisht jo-detyrues. Megjithatë, Nënshkruesit e këtyre Memorandumeve duhet të bëjnë raportime periodike mbi zbatimin e tyre në nivel kombëtar. Referencat për tekstet ligjore të çdo instrumenti, në lidhje me Raportimin Kombëtar janë përmbledhur në {→ Tabela 6.1} .

6.2 Përfitimet e Raportimit Kombëtar për Vendin Raportues

Raportimi Kombëtar sipas CMS-së dhe instrumenteve të saj, nëse bëhet siç duhet, ka përfitime të shumta për vendet raportuese:

- Procesi i Raportimit Kombëtar mund të shërbejë si një nxitje për mbledhjen sistematike të të dhënave dhe informacionit në lidhje me llojet shtegtare. Ai gjithashtu siguron përditësim të rregullt të këtyre të dhënave dhe informacioneve, si dhe për disa vende mund të ofrojë një kuadër të veçantë për sistemimin dhe arkivimin e të dhënave dhe informacioneve.
- Raportimi Kombëtar të çon në rritje të njohurive mbi llojet shtegtare dhe çështjeve të tjera që lidhen me to, si dhe në identifikimin e boshllëqeve në njohuritë aktuale.
- Raportet kombëtare janë një mjet për shkëmbimin e informacionit - si brenda vendit ashtu dhe jashtë tij. Ato sjellin gjithashtu të dhëna dhe informacione të grumbulluara nga publiku i gjerë.
- Raportimi Kombëtar lejon, gjithashtu, që vendet të identifikojnë çështjet që lidhen me ruajtjen; çështje që duhen trajtuar brenda vendit të tyre, në një rajon dhe/ose më gjerë, ndërkombëtarisht nga disa vende.
- Për shkak të natyrës së tij, të punës me shumë grupe interesi, Raportimi Kombëtar krijon një aleancë brenda vendit në lidhje me procesin e zbatimit.
- Raportet Kombëtare mund të shërbejnë si pikënisje për planifikimin e aktiviteteve kombëtare të zbatimit sipas Instrumenteve të Familjes CMS {→ shih Kapitullin 5 mbi implementimin}.

6.2.1 Rëndësia dhe Përdorimi i Informacionit të Paraqitur nga Raportet Kombëtare

Të dhënat dhe informacioni i mbledhur nga Raportet Kombëtare, kur janë objektive dhe gjithëpërfshirëse, janë shumë të vlefshme për shumë procese dhe grupe të interesuarish. Për këtë arsye është e rëndësishme që të dhënat të jenë sa më të plota dhe të sakta që të jetë e mundur.

Tabela 6.1 Baza Ligjore dhe Afatet për Raportimin Kombëtar sipas CMS-së dhe Instrumentet e saj(afatet e raportimit mund të ndryshojnë me kalimin e kohës, ndaj ju lutemi t'i kontrolloni me Sekretarinë/ Njësinë koordinuese përkatëse për informacionin më të fundit mbi shpeshtësinë dhe afatet për Raportimet Kombëtare)

Instrumenti i Familjes CMS	Baza ligjore	Afati kohor /Shpeshtësia
CMS	Neni VI (3)	6 muaj para KP
Marrëveshjet		
ACAP	Neni VII: (1) c) & Neni IX: (6) d)	120 ditë para mbledhjes së TP
ACCOBAMS	Neni VIII: b)	120 ditë para mbledhjes së TP
AEWA	Neni V: (1) c)	120* ditë para mbledhjes së TP
ASCOBANS	Neni 2.5	Dorëzimi vjetor deri në 31 Mars
EUROBATS	Neni VI	90 ditë para mbledhjes së TP
GORILLA	Neni III dhe Neni IV: (1) c)	120 ditë para mbledhjes së TP
FOKAT E DETIT WADDEN	N/A	N/A
MEMORANDUM MIRËKUPTIMI		
Elefant i Afrikës Perëndimore	Paragrafi 7 i MOU	raportet dorëzohen çdo 2 vjet
Bilbilthi i kënetave	1. Paragrafi 6 i MOU-së; 2. Dokument zyrtar: CMS/AW-1/6	raportet dorëzohen çdo 2 vjet deri në 31 Mars të vitit pasardhës
Dreri Bukhara	Paragrafi 5 i MOU-së	raporte vjetore
Lopa e detit (Dugong dugong)	1. Paragrafi 6&9; 2. Dokumentet e mbledhjeve: CMS/Dugongs/SS2/Doc3: Rule 2	raporte të rregullta; dokumentet për mbledhjen do të përgatiten të paktën 30 ditë para fillimit të Mbledhjeve të Shteteve Nënshkruese
Shpendët livadheve të Amerikës së Jugut	Paragrafi 5 i MOU-së	(përcaktohet nga mbledhja e parë e nënshkruesve)
Bustardi i Madh	Paragrafi 4 i MOU-së	raporte të rregullta
Flamingot e Andeve të Larta	Paragrafi 5 i MOU-së	raporte të rregullta (formati dhe shpeshtësia e raportimeve vendoset në mbledhjen e parë të nënshkruesve)
Huemul të Andeve Jugore	Neni 7 i MOU-së	raporte vjetore
Breshkat e Detit IOSEA	1. Paragrafi 8 i MOU; 2. raporti i mbledhjes së parë të vendeve nënshkruese: pika 74	90 ditë para mbledhjes vjetore të shteteve nënshkruese (përdor vetëm bazë raportuese të dhënash)
Breshka Ujore Afrikë	Paragrafi 6 i MOU-së	raport vjetor deri në 30 Shtator të çdo viti
Foka e Mesdheut	Paragrafi 8 i MOU-së	raportet dorëzohen çdo 2 vjet
Balenat e Paqësorit	Paragrafi 8 i MOU-së; UNEP/CMS/PIC2/Doc.5-01/Rev.1	raportet e rregullta përputhen me mbledhjet e nënshkruesve të MOU-ve
Shpendët grabitqarë, shtegtarë, në Afrikë dhe Euroazi	1. Paragrafi 15 i MOU-së; 2. CMS/Raptorët/MoS1/Doc.12.2: pika 9	raportet dorëzohen çdo 3 vjet sipas ciklit të mbledhjeve të nënshkruesve; afati vendoset gjatë Mbledhjeve të Shteteve Nënshkruese
Pata kokëkuqe	Neni 4 dhe 7 i MOU-së	raporti mbi zhvillimin e MOU-ve të paktën 1 herë në vit
Antilopa Saiga	Paragrafi 3 dhe 6 i MOU-së	raporte të rregullta; raporte të detajuara brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi (raporti kërkohet sipas formatit të raportimeve të caktuar nga shtetet nënshkruese në konsultim me sekretariatin e CMS
Peshkaqenët	Seksioni 5: Paragrafi 15 (b) i MOU-së	raporte të rregullta
Krilla e Siberisë	Paragrafi 5 i MOU-së	raporte vjetore deri në 31 Mars
Kojliku sqephollë	Teksti Mou (detyra të tjera: pika 2)	raporte vjetore
Gjitarët e detit të Afrikës Perëndimore	Paragrafi 8 i MOU-së	raporte të rregullta

* AEWA MOP i zgjeruar, përmes Rezolutës 5.1, afati i fundit për dorëzimin e raporteve kombëtare në MOP6 për 180 ditë dhe sesionet e ardhshme të MOP mund të marrin vendime të ngjashme. Për përditësime mbi afatet ju lutem shikoni faqen e internetit të AEWA: **www.unep-aewa.org** ose kontaktoni Sekretariatin AEWA/UNEP.

Raportet Kombëtare funksionojnë si ndalesa e vetme për marrjen e informacionit zyrtar të një vendi mbi llojet shtegtare dhe masat e ndërmarra për ruajtjen e tyre. Përmes kësaj, qeveria përmbush detyrimet e saj sipas konventës CMS dhe instrumenteve të saj.

Nga këndvështrimi i CMS-së dhe instrumenteve të saj, të dhënat e mbledhura në Raportin Kombëtar ofrojnë informacion kundrejt treguesve të Planeve Strategjike apo treguesve të tjerë të zbatimit, dhe në nivel më të gjerë ndërkombëtar, mund të japin informacion mbi progresin e bërë drejt arritjes së objektivave Aichi {→ shih Paragrafin 5.2 dhe Kutinë e Informacionit 5.2}. Pra, raportimi jep një vlerësim të zbatimit të instrumentit si një i tërë dhe informon mbi vendimet e organit të saj vendimarrës, si dhe jep informata lidhur me proceset më të gjera ndërkombëtare të menaxhimit të biodiversitetit.

Në nivel kombëtar, Raportet Kombëtare janë thelbësore për të kuptuar gjendjen e përgjithshme të zbatimit, progresin dhe pikat e forta, por edhe mangësitë dhe dobësitë e Planit Kombëtar Strategjik të Veprimit për Biodiversitetin, Planit Kombëtar të Zbatimit {→ shih Paragrafin 5.2.4 dhe 5.2.5} dhe arritjen e objektivave të Instrumentit. Me zhvillimin e një mjeti analitik për të plotësuar Sistemin Online të Raportimit {→ shih Kutine e Informacionit 6.2 “Sistemi Online i Raportimit dhe Përparësitë e tij”} analiza e të dhënave dhe informacionit do të jetë e automatizuar dhe, aksesi dhe përdorimi i informacionit nëpërmjet internetiti do të rritet ndjeshëm, për informacionet e grumbulluara me anë të Raporteve Kombëtare.

Qeveritë mund të përdorin të dhënat dhe informacionet për të informuar mbi vendimarrjen e tyre dhe planifikimin e mëtejshëm të zbatimit. OJQ-të gjithashtu mund të përdorin informacionin e grumbulluar, me qëllim përcaktimin e prioriteteve të tyre për aktivitetet në terren. Të dhënat e përmbledhura në Raportin Kombëtar ofrojnë një burim të dobishëm të dhënash për hulumtime akademike; në fushën e ruajtjes, përdorimit të qëndrueshëm, menaxhimit të mjedisit dhe të tjera.

Sektori privat, për shembull, mund të përdorë informacionin e vënë në dispozicion përmes Raporteve Kombëtare në planifikimin strategjik të biznesit.

6.3 Kur dhe Çfarë Raportohet

6.3.1 Shpeshtësia dhe Afatet

Shpeshtësia dhe afatet e Raportimit Kombëtar për çdo instrument të familjes së konventës CMS, janë të përcaktuara në tekstet e tyre. {→ Tabela 6.1} më sipër paraqitet një përmbledhje për shpeshtësinë dhe afatet e të gjitha instrumenteve.
Shtetet anëtare rekomandohet që të dorëzojnë Raporte Kombëtare te Njësia koordinuese/Sekretaria përkatëse në afatin e caktuar, për të mundësuar një kohë të dytë, të përshtatshme për analizën dhe sintezën e të gjithë raporteve të dorëzuar. Raportet që dorëzohen pas afatit nuk do të merren parasysh në sintezën e përgatitur nga Sekretaria/Njësia Koordinuese. Kjo do të thotë se vlerësimi i zbatimit të instrumentit nuk do të jetë i zgjeruar dhe as i besueshëm, dhe do të jetë një bazë jo e saktë për vendimarrjen.

6.3.2 Formatet e Raporteve Kombëtare

Shumica e instrumenteve të familjes së konventës CMS kanë Formatin e tyre të Raportit Kombëtar {→ shih Kutinë Informacionit 6.1}. Formati përcakton se cilat lloje informacionesh duhet të raportohen nga vendet, sipas çdo instrumenti. Në përgjithësi kategoritë e informacioneve lidhen me statusin e llojeve shtegtare të mbuluara nga instrumenti, rreziqet dhe kërcënimet me të cilat ato përballen, reagimet përkatëse, si dhe njohuritë, kapacitetin, çështjet institucionale dhe financiare. Formatet janë në përputhje me Planet Strategjike dhe Planet e Veprimit të Instrumenteve, dhe me vendimet e organeve vendimarrëse që e

përcaktojnë përgatitjen e raportit.
Formatet e raportimit sigurohen në gjuhën(ët) përkatëse të punës për konventën CMS dhe instrumentet e saj. Formati i Raportimit Kombëtar të CMS-së është i disponueshëm në tre gjuhë pune të Konferencës së Palëve (COP), të cilat janë; anglisht, frëngjisht dhe spanjisht. Sidoqoftë, në rastin e disa marrëveshjeve, si p.sh. AEWA dhe EUROBATS, Formatet e Raportimit Kombëtar janë të disponueshme vetëm në anglisht dhe frëngjisht, të cilat janë dy gjuhët e punës së Mbledhjes përkatëse të Palëve (MOP).

Formatet e raportimit zakonisht miratohen nga organi vendimarrës i konventës CMS ose instrumenteve përkatëse. Mandati për të kryer rishikime ose amendime në formatet e raportimit gjatë periudhave ndërsesionale mund t'i jepet organeve të varësisë, si Komisionet Këshillimore/Mbështetëse.

Për versionin më të fundit të formateve individuale të Raportimit Kombëtar, kontaktoni me Sekraterinë/ Njësinë Koordinuese të instrumentit përkatës të CMS-së.

KUTI INFORMACIONI 6.1

Formati i AEWA-së

AEWA po punon për një format moduli. Përveç modulit kryesor, do të kenë dy module specifike - një për statusin e llojeve dhe një tjetër për statusin e zonës. Moduli kryesor duhet të paraqitet në çdo Mbledhje të Palëve (MOP), e cila organizohet në intervale trevjeçare, ndërsa modulet specifike do të duhet të paraqitet më rrallë.

6.4 Kush Raporton dhe si Raportohet

Përgjegjësia për procesin e Raportimit Kombëtar sipas konventës CMS dhe instrumenteve të saj i takon Pikës Kombëtare Fokale, të përcaktuar për secilin vend. Sidoqoftë, Pikat Kombëtare të Përfaqësimit (PKP) mund të caktojnë një Njësi Përgjegjëse Kombëtare, e cila emërohet për realizimin e procesit të Raportimit Kombëtar në vend PKP-ve.

6.4.1 Përfshirja e Grupeve të Interesit dhe Koordinimi

Procesi i Raportimit Kombëtar është kolektiv, bashkëpunues dhe pjesëmarrës. Ky proces mes shumë agjensive, sektorëve dhe aktorëve, duhet të përfshijë, mundësisht, të gjitha institucionet përkatëse qeveritare, shkencore dhe akademike, organizatat joqeveritare dhe organizatat e aktorëve të tjerë në nivele të ndryshme, të cilët kanë kontribut në zbatimin e instrumenteve të Familjes CMS-së dhe/ose mund të sigurojnë të dhënat dhe informacionet e nevojshme.

Këto institucione, organizata dhe aktorë, duhet të bëhen pjesë e Mekanizmave kryesorë të Koordinimit Kombëtar për zbatimin e instrumenteve të CMS-së. Këto Mekanizma duhet të koordinohen nga Pikat Kombëtare të Përfaqeësimit (PKP) {→ shih Paragrafin 5.2.3 për një përshkrim të Procesit të Konsultimit Kombëtar dhe Shembullin Praktik 5.1}.

6.4.2 Platformat e Raportimit

Brenda familjes së konventës CMS, Raportimi Kombëtar kryhet aktualisht duke përdorur dy metoda

kryesore. Deri së fundmi, formatet e raportimit kanë qenë të disponueshme vetëm në aplikacionet standarte të software-ve të zyrës (Microsoft Word ose Adobe PDF). Kjo do të thotë se skedarët standartë në Word ose PDF plotësoheshin nga çdo vend dhe i dërgoheshin Sekretarisë/Njësisë Koordinuese.
Si alternativë, disa nga marrëveshjet si IOSEA, ACAP dhe ACCOBAMS kanë filluar t'i ofrojnë formatet e tyre të Raportimit Kombëtar si modele në internet, që mund të hapen dhe të plotësohen nëpërmjet faqeve të tyre të internetit.
Një platformë e re qëndrore në internet - Sistemi i Raportimit Online (ORS) - është krijuar në mbështetje të proceseve të Raportimit Kombëtar për familjen e konventës CMS. Në Sistemin e Raportimit Online, formatet e raportimit ofrohen si modele në internet. Kjo lejon që të dhënat të futen drejtpërdrejt në një sistem në internet dhe të ruhen në një bazë përkatëse të të dhënave. Aktualisht, Sistemi i Raportimit Online përdoret nga konventa CMS, AEWA dhe ASCOBANS. Sistemi i Raportimit Online është i disponueshëm për t'u përdorur nga të gjitha instrumentet e CMS-së, dhe shumë konventa të tjera kanë hedhur tashmë hapa për përdorimin e tij {→ shih Kutinë e Informacionit 6.2}.

KUTI INFORMACIONI 6.2

Sistemi i raportimit Online dhe avantazhet e tij

Sistemi i Raportimit Online (ORS) është krijuar në vitet 2010-2011 nga UNEP-WCMC, në bashkëpunim të ngushtë dhe nën drejtimin e Sekretarisë të UNEP/AEWA. AEWA ishte instrumenti i parë i CMS-së që ka përdorur sistemin ORS për raportimin e tij, në sesionin e 5të të Mbledhjes së Palëve (MOP), në Maj 2012.

Sistemi ORS është një platformë e zgjeruar, e bazuar në internet, për Raportimin Kombëtar. Ai është një sistem i sofistikuar, por elastik dhe i lehtë në përdorim, i cili lejon krijimin dhe modifikimin me lehtësi të modeleve të personalizuara të Raportimit Kombëtar. Nuk ka nevojë për aftësi teknike programimi për të riprodhuar një format raportimi brenda sistemit ORS. Për këtë arsye, edhe Sekretaritë/Njësitë Koordinuese, pa kapacitete në teknologjinë e informacionit, mund t'i administrojnë proceset e raportimit nëpërmjet sistemit.

Sistemi përfshin një funksion delegimi, i cili lejon që personi përgjegjës për procesin e raportimit në një vend, të përcaktojë pjesë ose edhe pyetje individuale të raportit, drejtuar kontribuesve të ndryshëm. Të gjithë kontribuesit kombëtarë mund të kenë akses dhe të punojnë njëkohësisht në Raportin Kombëtar. Ky është një mjet i dobishëm për menaxhimin e përfshirjes së shumë aktorëve kontribues në procesin e Raportimit Kombëtar.

Pas dorëzimit të raportit të plotë, informacionet mbeten të disponueshme dhe plotësohen paraprakisht për ciklin e ardhshëm të raportimit. Do të kërkohet vetëm përditësimi i informacioneve, nëse është e nevojshme, duke ulur kështu ndjeshëm ngarkesën e punës në ciklet vijuese të raportimit.

Informacionet e përfshira kalojnë drejtpërdrejtë në një bazë të dhënash, nga e cila, të dhënat mund të nxirren dhe të analizohen me lehtësi nga Sekretaria/Njësia Koordinuese. Kjo kursen mjaft kohë dhe burime në krahasim me formatet e raportimit në Microsoft Word ose Adobe PDF të përdorura më parë.

Në një të ardhme të afërt planifikohet që sistemi ORS të plotësohet me një modul të një mjeti analitik. Ky mjet analitik i parashikuar do të sigurojë akses për çdo përdorues të internetit dhe do të lejojë një analizë automatike të të dhënave, në kohë dhe në regjistrime të ndryshme të përdoruesve. Mjeti analitik do të rrisë ndjeshëm aksesin dhe përdorimin e të dhënave dhe informacioneve të paraqitura nëpërmjet Raportimeve Kombëtare, dhe do t'i rrisë avantazhet e sistemit ORS.

Si përfundim, sistemi ORS po vlerësohet për t'u përdorur nga marrëveshje të tjera që kanë lidhje me biodiversitetin dhe që nuk kanë lidhje me CMS-në, si konventa CITES dhe Ramsar. Zgjerimi i komunitetit të përdoruesve të sistemit ORS mund të lehtësojë harmonizimin midis formateve të raportit dhe procesit të raportimit, kur është e mundur, dhe me gjasë mund të çojë në marrëveshje për ndarjen e kostove midis pjesëmarrëse të Sekretarisë së MEAs, gjë që do të sillte uljen e kostove në lidhje me mirëmbajtjen afatgjatë dhe zhvillimin e mëtejshme të sistemit.

6.5 Hapat për Hartimin e Raportit Kombëtar

Si një pjesë integrale e zbatimit, raportimi është një proçes i vazhdueshëm dhe i përsëritur. Ai fillon me planifikimin e zbatimit dhe vazhdon me vlerësimin e asaj që është bërë.

HAPI 1: Nisja e planifikimit të raportimit bashkë me planifikimin e zbatimit

PËR TË QENË TË QARTË PËR ATO QË DUHET TË RAPORTOHEN
Është shumë e rëndësishme që të kuptohet qartë se çfarë duhet të raportohet në fund të ciklit të zbatimit. Për këtë arsye, Pika Kombëtare e Përfaqësimit (PKP) duhet të studiojë dhe të jetë plotësisht e familjarizuar, që në një fazë të hershme, me formatin e raportimit. Është e rëndësishme që të rishikohet çdo pyetje dhe të kuptohet mirë se çfarë informacionesh kërkohen. Nëse një raport është dorëzuar tashmë në fillim të ciklit të mëparshëm të raportimit - kjo do t'i sigurojë po ashtu Pikës Kombëtare të Përfaqësimit (PKP) një përmbledhje për të dhënat dhe informacionet që janë paraqitur ose që mungojnë.

TË IDENTIFIKOHET KUSH MUND TË NDIHMOJË DHE KONTRIBUOJË
Nëse e dinë se çfarë duhet të raportojnë, kjo do t'i ndihmojë Pikat Kombëtare të Përfaqësimit (PKP) që të identifikojnë institucionin, organizatën ose aktorin më të përshtatshëm për të dhënë informacionet e kërkuara. Pjesë të ndryshme si dhe pyetje individuale të Raportit Kombëtar mund t'u caktohen anëtarëve të Mekanizmit Kombëtar të Koordinimit, në përputhje të ekspertizës së tyre, si dhe sipas përfshirjes së tyre në procesin e zbatimit.

SI TË MARRIN INFORMACION
Pikat Kombëtare e Përfaqësimit (PKP) duhet të identifikojnë të gjitha burimet e mundshme të të dhënave dhe informacioneve, në nivel kombëtar ose ndërkombëtar, që mund të përdoren për të plotësuar çdo pyetje në Raportin Kombëtar, dhe të qartësojnë mënyrat për marrjen e informacioneve. Duhet të kryhen kontrolle në lidhje me të dhënat dhe informacionet që janë, ose nuk janë aktualisht të disponueshme, dhe nëse formati i tyre është në përputhje me atë që kërkohet në Raportin Kombëtar. Pikat Kombëtare të Përfaqësimit (PKP) duhet, po ashtu, të parashikojnë çdo nevojë të mundshme për analizën dhe/ose përmbledhjen e të dhënave dhe informacioneve para se të futen në raport.

Pikat Kombëtare të Përfaqësimit (PKP) duhet të sigurohen që të kenë identifikuar çdo proces paralel të mundshëm me raportimin, sipas instrumenteve ose marrëveshjeve të tjera, ku kërkohen të dhëna dhe informacione të ngjashme, në mënyrë që të mund të shmangin përsëritjen e punës dhe raportimin e informacioneve kontradiktore ose të ndryshme.

KOHA - CAKTIMI I MOMENTEVE KRYESORE DHE AFATEVE
Pikat Kombëtare të Përfaqësimit (PKP) duhet të krijojnë, po ashtu, një kalendar për procesin e tyre të raportimit. Për të bërë këtë, duhet të caktohen momente kryesore dhe afate të brendshme për të ndihmuar që Pikat Kombëtare të Përfaqësimit (PKP) t'i marrin informacionet e nevojshme në kohë, për plotësimin e Raportit Kombëtar. Aktorët e tjerë duhet të informohen për afatet kryesore që ndikojnë në dorëzimin në kohë të raportit, si dhe afatin përfundimtar të dorëzimit (për afatet e dorëzimit të instrumenteve të ndryshme të CMS-së {→ shih Tabelen 6.1 dhe Shembullin Praktik 6.1}.

HAPI 2: Përfshirja e informacioneve në formatin e raportit me qëllim që të jenë të disponueshme gjatë të gjithë ciklit të zbatimit

Në përputhje me momentet kryesore dhe afatet e caktuara - të dhënat dhe informacionet duhet të futen në Raportin Kombëtar gjatë të gjithë ciklit të zbatimit. Kjo do ta shpërndajë ngarkesën e punës në kohë dhe do

të shmangë mbingarkesën në minutat e fundit, në përpjekjet për plotësimin e raportit. Përgjigjet duhet të jenë objektive dhe të sinqerta - Raporti Kombëtar synon të identifikojë mangësitë si dhe arritjet.

HAPI 3: Sigurimi i koordinimit të rregullt në nivel kombëtar gjatë të gjithë ciklit të zbatimit

Për të siguruar një progres të vazhdueshëm në hartimin e Raportit Kombëtar, Pikat Kombëtare e Përfaqësimit (PKP) duhet të përfshijnë monitorimin dhe rishikimin e procesit të raportimit, si pjesë e takimeve të rregullta të Mekanizmit të Koordinimit Kombëtar. Këto takime duhet të përdoren për të harmonizuar dhe verifikuar të dhënat dhe informacionet që vijnë nga burime të ndryshme. Midis takimeve, ose në raste kur zhvillimi i takimeve nuk është i mundur, mund të përdoren mënyra të tjera të komunikimit; si; emaili, telekonferencat ose sistemi ORS, për të deleguar dhe për të rishikuar në vazhdimësi kontributet e bëra për Raportin Kombëtar.

HAPI 4: Përfundimi dhe përgatitja e Raportit Kombëtar për dorëzim

Para dorëzimit të Raportit Kombëtar, Pikat Kombëtare e Përfaqësimit (PKP) duhet të sigurohen që të përfshihet çdo e dhënë ose informacion i fundit që mungon, nëse ka. Duhet të verifikohet saktësia e të gjitha informacioneve të përfshira dhe nëse raporti është i plotë. Nuk duhet të lihen pjesë bosh - nëse nuk ka të dhëna ose informacione të disponueshme, kjo duhet të thuhet. Kjo do të jetë e dobishme për të përcaktuar mangësitë dhe shkaqet, dhe për të shmangur një situatë të paqartë.

Duhet të siguroheni që Raporti kombëtar është pranuar nga Mekanizmi i Koordinimit Kombëtar. {→ shih Paragrafin 5.2.3 Shembullin Praktik 5.1 për Komisionin Kombëtar të CMS-së në Kili}

SHEMBULL PRAKTIK 6.1

Mbrojtja dhe menaxhimi i zonave të rëndësishme për shpendët shtegtarë ujorë

Në formatin e raportit të vitit 2009-2011, palët në AEWA pritej të raportonin për statusin e mbrojtjes dhe të menaxhimit, për zonat e identifikuara si zona me rëndësi kombëtare ose ndërkombëtare për shpendët shtegtarë ujorë. Për secilën nga këto dy kategori të rëndësishme, kërkoheshin përmbledhje në fushat e mëposhtme:

Numri total i zonave

Zona në total (në hektarë)

Numri i zonave të mbrojtura në raport me totalin e përmendur më sipër

Zona e mbrojtur (në hektarë) në raport me totalin e përmendur më sipër

Numri i zonave të mbrojtura me plane efektive menaxhimi që janë në zbatim

Zona e mbrojtur (në hektarë) e mbuluar nga planet e menaxhimit që janë në zbatim

Për të siguruar shifrat e kërkuara për çdo fushë, duhej të identifikoheshin, përdoreshin, analizoheshin dhe përmblidheshin një sasi e madhe e të dhënave për zonat e mbrojtura. Në radhë të parë, kjo kërkonte identifikimin se ku ruheshin informacionet për inventarin kombëtar të zonave të rëndësishme për shpendët shtegtarë ujorë dhe bazën e të dhënave për zonat e mbrojtura. Hapi tjetër ishte marrja e këtyre informacioneve dhe nxjerrja e të dhënave të nevojshme për zonat e përzgjedhura, të cilat duhej të analizoheshin për të sjellë të gjithë parametrat në të njëjtin format. Hapi i fundit ishte grumbullimi dhe përmbledhja e të dhënave, për të siguruar një shifër të vetme për secilën nga fushat e përshkruara më sipër. Mbi të gjitha, ky ishte një ushtrim që kërkonte kohë, i cili duhet të merrej parasysh që nga fillimi i planifikimit të procesit të raportimit.

Hapi i fundit është miratimi i raportit për dorëzim nga autoriteti përkatës qeveritar.

6.6. Dorëzimi i Raportit Kombëtar dhe Ndjekja

Pas verifikimit dhe miratimit të Raportit Kombëtar, ai duhet të dorëzohet te Sekretaria/Njësia Koordinuese përkatëse për familjen e konventës CMS. Pas dorëzimit, raporti do të rishikohet nga Sekretaria/Njësia Koordinuese dhe mund t'i kthehet vendit në fjalë me kërkesën për informacione shtesë dhe përpunime të mëtejshme, nëse është e nevojshme.

Raporti përfundimtar do të përfshihet në analizën e përgjithshme ndërkombëtare për zbatimin e instrumentin përkatës. Duhet pasur parasysh se pas dorëzimit përfundimtar, raporti bëhet një dokument zyrtar dhe publik, dhe do të paraqitet në takimin vijues të organit vendimarrës për konventën CMS ose instrumentet e saj.

KËSHILLA TË VLEFSHME 6.1

Kërkohet që vendet ta dorëzojnë në kohë Raportin e tyre Kombëtar. Raportet që dorëzohen pas afatit nuk do të merren parasysh në analizën dhe sintezën e përgatitur nga Sekretaria/Njësia Koordinuese. Kjo gjë do të bëj që vlerësimi i zbatimit për instrumentin përkatës nuk do të jetë i zgjeruar, i besueshëm dhe do të jetë një bazë jo e saktë për vendimarrjen. Për të siguruar dorëzimin në kohë të raportit përfundimtar, Pikat Kombëtare të Përfaqësimit (PKP) nxiten që ta dorëzojnë draft-raportin përfundimtar te Sekretaria/Njësia Koordinuese për rishikim para afatit.

6.6.1 Çfarë ndodh Pas Dorëzimit të Raportit Kombëtar?

Dorëzimi i Raportit kombëtar shënon fillimin e një cikli të ri të raportimit. Pikat Kombëtare të Përfaqësimit (PKP) duhet të fillojnë të planifikojnë aktivitetet e zbatimit dhe të raportimit sipas formatit të raportit të fundit të miratuar, ose Raportit të fundit Kombëtar, në rastet kur është dorëzuar një i tillë. Duhet pasur parasysh se vendimet e marra në takimet e organeve vendimarrëse, mund të sjellin ndryshime në formatet e raportimit. Për këtë arsye, Pikat Kombëtare të Përfaqësimit (PKP) duhet të sigurohen që ta përshtatin zbatimin dhe raportimin, për të pasqyruar formatin e ri të raportimit, kur ai të jetë i disponueshëm.

Kur formatet e rishikuara të miratohen {→ shih Paragrafin 6.3.2 Formatet e Raporteve Kombëtare}, ato do të jenë të disponueshme nga Sekretariati/Njësia Koordinuese.

Pasi Raporti Kombëtar të dorëzohet, raporti i plotë do të jetë i disponueshëm për publikun në faqen e internetit të konventës CMS ose të instrumentit përkatës. Të gjitha Raportet Kombëtare të dorëzuara nga vendet, do të ngarkohen në një faqe interneti qëndrore dhe do të arkivohen përgjithmonë, me aksesin e mundësuar nëpërmjet internetit të ofruar nga Sekretaria/Njësia Koordinuese {→ shih Kutine e Informacionit 6.3}. Përveç kësaj, Raportet Kombëtare që janë dorëzuar tek instrumentet e familjes së konventës CMS do të shpërndahen më tej dhe do të jenë të disponueshme nëpërmjet portaleve në internet, si InforMEA (www.informea.org) në të ardhmen, ku do të bëhen pjesë e të dhënave në nivel botëror të informacioneve për Raportet Kombëtare, të dorëzuara nga vendet e Marrëveshjeve Shumëpalëshe për Mjedisin (MEA).

KUTI INFORMACIONI 6.3

Mjeti Analitik

Sistemi i Raportimit Online do të plotësohet, në një kohë të përshtatshme, nga një mjet analitik. Kjo do të bëjë të mundur analizën e automatizuar dhe të menjëhershme për të dhënat e dorëzuara dhe do të hartohet në një mënyrë të tillë që do të lejojë një akses të vogël në internet për raportet e personalizuara.

LISTA E PLOTË

Hapat për Hartimin e Raportit Kombëtar

- ❑ Nisni planifikimin e raportimit bashkë me planifikimin e zbatimit
- ❑ Të jeni të qartë për ato që duhet të raportohen
- ❑ Të identifikoni kush mund të ndihmojë dhe kontribuojë në proçesin e hartimit të informacioneve
- ❑ Të siguroheni që të merrni informacione të sakta për Raportet Kombëtare
- ❑ Të përfshini informacionet në formatin e raportit kur bëhen të disponueshme, gjatë të gjithë ciklit të zbatimit
- ❑ Siguroni një koordinim të rregullt në nivel kombëtar gjatë të gjithë ciklit të zbatimit
- ❑ Tregoni kujdes për afatet për Raportimin Kombëtar dhe caktoni momentet kryesore dhe afatet
- ❑ Përfundoni dhe përgatitni Raportin Kombëtar për dorëzim
- ❑ Përdorni Raportin kombëtar përfundimtar si bazë për informacione për ciklin e ardhshëm të zbatimit dhe Raportimit Kombëtar për konventën CMS dhe/ose instrumentin përkatës

PËRSËRITJE KAPITULLI

Pyetja 1: Çfarë janë Raportet Kombëtare?

Pyetja 2: Si mund të përdorin qeveritë të dhënat nga Raportet Kombëtare?

Pyetja 3: Cila nga këto përshkruan më mirë proçesin e Raportimit Kombëtar?
A) I çrregullt dhe statik B) I vazhdueshëm dhe përsëritës

Përgjigje: *1) Raportet Kombëtare janë dokumentet zyrtare me të cilat vendet raportojnë tek organet vendim-marrëse të Instrumentave të familjes CMS mbi masat që kanë ndërmarrë për të zbatuar prioritetet e instrumentave.2) Qeveritë mund të përdorin të dhëna dhe informacion për të informuar mbi vendim-marrjen e tyre dhe planifikimin e mëtejshëm të zbatimit. 3) Raportimi Kombëtar është një proces formues dhe periodik.*

SHËNIME

Fjalor

ACAP – Marrëveshja për Mbrojtjen e Albatrosit dhe Shpendëve të Detit

Aderoj, miratoj dhe nënshkruaj – proçeset me anë të të cilave një vend bëhet një Shtet Anëtar në një instrument

Plani i Veprimit – një seri masash për të zbatuar një instrument ose për të siguruar statusin e mbrojtjes të një lloji ose grup llojesh

Komision Këshillues (AZ) – organi i varësisë i krijuar për shumë instrumente për të siguruar këshillim shkencor dhe teknik midis mbledhjeve të Shteteve anëtare; në rastin e ASCOBANS ka edhe përgjegjësinë për administrimin dhe politikat

AEWA – Marrëveshja për Mbrojtjen e Shpendët Shtegtarë Ujorë Afrikano-Euroaziatikë

Marrëveshje – term i përdorur për të përshkruar shtatë instrumentet e detyrueshme ligjore sipas konventës CMS

Objektivat e Aichi për Biodiversitetin – një seri objektivash për të realizuar pesë Objektivat Strategjike të KDB-së

Llojet Aliene/ të huaja – një lloj kafshe ose bime që shfaqet në një habitat ku nuk është shfaqur më parë në mënyrë natyrale. Ato lloje që çrregullojnë ekuilibrat ekologjik njihen edhe si lloje aliene invazive/ pushtuese

Shtojcë – një shtesë/ aneks për një instrument, shpesh përdoret për të renditur llojet për të cilat zbatohet instrumenti

ASCOBANS – Marrëveshja për Mbrojtjen e Balenave të Vogla të Detit Balltik, Atlantikut Verilindor, Detit të Irlandës dhe Detit të Veriut

Biodiversiteti (Diversiteti biologjik) – të gjitha burimet e ndryshueshmërise mes organizmave të gjalla nga të gjitha burimet, duke përfshirë ndër të tjera ekosistemet tokësore, detare dhe të tjera ujore, si dhe komplekset ekologjike ku ata bëjnë pjesë: Biodiversiteti përfshin diversitetin brenda llojit, mes llojeve dhe ekosistemeve (Neni 2 i konventës KDB)

BirdLife International – një koalicion ndërkombëtar i organizatave joqeveritare që punojnë për mbrojtjen e shpendëve

Konventa e Bonit – një emër alternativ për Konventën për Mbrojtjen e Specieve Shtegtare të Kafshëve të Egra (CMS) që vjen nga fakti se konventa u negociua në atë qytet

Byro – një grup i vogël i përfaqësuesve të palëve, përfshirë zyrtarët në takimin e organit vendimmarrës që janë përgjegjës për drejtimin e aktiviteteve

Kapje e Rastësishme – kapja aksidentale e llojeve (jo të nevojshme) në rrjetat ose grepat e peshkimit

CDB (Konventa për Diversitetin Biologjik ose Konventa për Biodiversitetin) – një nga konventat ndërkombëtare të miratuara në Samitin e Rios në vitin 1992

CITES (Konventa për Tregtinë Ndërkombëtare për Llojet e Rrezikuara të Faunës dhe Florës së Egër) – një konventë ndërkombëtare e administruar nga UNEP e krijuar në Washington, SHBA në vitin 1973

CMS (Konventa për Mbrojtjen e Specieve Shtegtuese të Kafshëve të Egra) – një konventë ndërkombëtare e administruar nga UNEP e krijuar në Bon, Gjermani në vitin 1979

Familja e CMS-së – një term përmbledhës për të përshkruar konventën CMS dhe marrëveshjet ligjore të detyrueshme si dhe Memorandumet e Mirëkuptimit të realizuara në kuadër të saj

Komisioni i Plotë – organi funksioni i të cilit në Konferencën e Palëve (KP) është të diskutojë në detaje propozimet dhe të bëjë rekomandime në seancën plenare.

Veprimet e Bashkërenduara – një mekanizëm në kuadër të konventës CMS i krijuar në Konferencën e tretë të Palëve për identifikimin e llojeve të renditura në Shtojcën I të konventës, që duhet të ketë një vëmendje të veçantë.

Konferenca e Palëve (COP)(KP) – institucioni kryesor vendimmarrës i Konventës që organizohet çdo tre vjet

Grupi i Kontaktit – një grup ad hoc i krijuar në organet vendimmarrëse për të trajtuar një çështje ku është e vështirë gjetja e konsensusit.

Palët kontraktuese (ose Palët) – vendet dhe organizatat e integrimit ekonomik rajonal që janë përfshirë zyrtarisht në një Konventë ose një Marrëveshje

Konventa për Llojet Shtegtare – emri i shkurtër i Konventës për Speciet Shtegtare të Kafshëve të Egra që sjell edhe inicialet CMS, të përdorura zakonisht për këtë konventë

Konventa për Mbrojtjen e Llojeve Shtegtare të Kafshëve të Egra – termi i plotë i konventës CMS ose Konventës për Speciet Shtegtare

Njësia Koordinuese – organi administrativ me qendër në Abu Dabi që siguron shërbime të Sekretariatisë për Memorandumet e Mirëkuptimit për raptorët dhe dugongët

Komisioni i Kredencialeve – një komision i krijuar në takimet e organeve vendimmarrëse për të siguruar saktësinë e "kredencialeve" (letrat që autorizojnë pjesëmarrjen e delegatëve në takim, të lëshuara nga qeveria e Shtetit anëtar)

Vendim – një zgjidhje ose një rekomandim i bërë nga një organ vendimmarrës

Organ Vendimmarrës – termi i përdorur për të përshkruar Konferencën e Palëve për CMS-në, Mbledhjen e Palëve për një Marrëveshje ose Mbledhjen e Nënshkruesve për një Memorandum Mirëkuptimi

Depozituesi (Qeveria Depozituese) – vendi ose organizata që merr të gjitha dokumentet zyrtare nga Shtetet Anëtare kur aderojnë ose miratojnë Konventën ose një Marrëveshje (Gjermania për CMS-në, Holanda për AEWA, Mbretëria e Bashkuar për EUROBATS dhe Kombet e Bashkuara për ASCOBANS)

E-buletine – broshura të botuara periodikisht që shpërndahen me e-mail ose postohen në faqe interneti në vend që të printohen dhe të dërgohen me postë

E-platforma e komunitetit – një mjet për ngritjen e kapacitetit dhe komunikimit në web që lejon që personat e interesuar ("komuniteti") të ndërveprojë për një subjekt të caktuar.

EUROBATS – Marrëveshja për Mbrojtjen e Popullatave të Lakuriqëve të Natës në Europë

Fauna and Flora Ndërkombëtare (FFI) – një organizatë jo-qeveritare, ndërkombëtare, për mbrojtjen e llojeve, me qendër në Kembrixh

Organizata për Ushqimin dhe Bujqësinë e Kombeve të Bashkuara (FAO) – një agjenci e specializuar e Kombeve të Bashkuara me qendër në Romë, Itali. Ajo është themeluar në vitet 1940 si pasuese e Institutit Ndërkombëtar të Bujqësisë

Burimet Gjenetike – materialet gjenetike (çdo material bimor, shtazor, mikrobial ose me origjinë tjetër që përmban njësi trashëgimie funksionale) me vlerë aktuale ose potenciale (Neni 2 i konventës KDB)

Facilitetet Globale për Mjedisin (GEF) – një organizatë financiare e pavarur roli i së cilës është financimi i projekteve në lidhje me biodiversitetin, ndryshimin e klimës dhe çështje të tjera. Qendra e saj është në Washington.

Kreu i Delegacionit – personi që drejton delegacionin e një Pale në një organ vendimmarrës të një instrumenti

InforMEA – një portal jozyrtar për Marrëveshjet Shumëpalëshe për Mjedisin (MEA), mirëmbahet nga Kombet e Bashkuara, me qëlim ruajtjen e të dhënave mbi vendimet e mbledhjeve të organeve vendimarrëse

Grupi i Punës në Sesion – një grup *ad hoc* i krijuar për të funksionuar gjatë një takimi të organit vendimarrës, organit të varësisë ose organit teknik dhe shkencor, për të vlerësuar një fushë të caktuar të politikave

Instrument – një term i përdorur për të përshkruar Konventën, një Marrëveshje ose një Memorandum Mirëkuptimi

Grupi Ndërsesional i Punës – një grup *ad hoc* i krijuar nga mbledhja e organit vendimmarrës, Organit të Varësisë ose Organit Teknik dhe Shkencor për të vlerësuar një fushë të caktuar të politikave dhe për të raportuar në mbledhjen e ardhshme.

Ndërhyrje – një kontribut verbal në një debat gjatë një mbledhje

IOSEA – Memorandumi i Mirëkuptimit për Mbrojtjen dhe Menaxhimin e Breshkave të Detit dhe Habitatet e tyre në Oqeanin Indian dhe Azinë Juglindore

IUCN (Unioni Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Natyrës) – një organizatë për mbrojtjen e llojeve, e themeluar në vitin 1948, bashkon Shtetet Anëtare dhe organizatat joqeveritare, dhe mban Listën e kuqe të të dhënave për llojet e rrezikuara

Mbetjet Detare – mbetjet e hedhura dhe të akumuluara në det, si qeset dhe shishet plastike, që përbëjnë një kërcënim për kafshët

Takimi i Palëve (MOP) – organi vendimmarrës i një Marrëveshjeje

Takimi i Palëve Nënshkruese (MOS) – organi vendimmarrës i një Memorandumi Mirëkuptimi

Shtetet Anëtare – vendet që janë Palë (Kontraktuese) për një Konventë ose një Marrëveshje ose Nënshkruesit e një Memorandumi Mirëkuptimi

Memorandumi i Mirëkuptimit (MOU) – termi i përdorur për të përshkruar një instrument ligjor jo detyrues nga të cilat 19 janë realizuar sipas konventës CMS

Llojet Shtegtuese – një lloj ose një njësi taksonomike e kafshëve të egra, nga të cilat e gjithë popullata ose një pjesë e popullatës, e ndarë gjeografikisht, kapërcen në mënyrë ciklike dhe të parashikuar kufijtë e një ose më shumë juridiksioneve kombëtare

Rrjeti për Faunën e Egër Shtegtuese – Një partneritet i shoqërisë civile me objektivin për koordinimin dhe zhvillimin e veprimeve për mbrojtjen e faunës së egër shtegtare nëpërmjet proçeseve ndërkombëtare.

Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (MDG) – tetë objektiva të zhvillimit ndërkombëtar që janë përcaktuar zyrtarisht pas Samitit të Mijëvjeçarit të Kombeve të Bashkuara në vitin 2000

Marrëveshjet Shumëpalëshe për Mjedisin (MEA) – një marrëveshje ligjore e detyrueshme midis më shumë se dy shteteve në lidhje me mjedisin, shpesh të realizuara në kuadër të Kombeve të Bashkuara

Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin (SKPVB) – mjeti kryesor për zbatimin e Konventës për Diversitetin Biologjik në nivel kombëtar

Pika Kombëtare e Përfaqësimit (PKP) – zyrtari i caktuar nga një Shtet Anëtar, për të drejtuar zbatimin e një instrumenti dhe për koordinimin me Sekretarinë ose me Njësinë Koordinuese dhe Shtetet e tjera Anëtare

Vëzhgues – një person që merr pjesë në një mbledhje të organit vendimarrës ose të varësisë, pa të drejta votimi, si p.sh. një përfaqësues i një Shteti jo Anëtar, një organizate joqeveritare ose një organizate ndërqeveritare

Sistemi i Raportimit Online (ORS) – një sistem raportimi në internet që i lejon Shtetet anëtare të përfshijnë të dhënat drejtpërdrejtë në një model elektronik

Palët (ose Palët kontraktuese) – vendet që kanë miratuar ose aderuar në konventën CMS, ose në një nga Marrëveshjet e saj (shikoni po ashtu Shtetet Anëtare dhe Nënshkruese)

Seanca Plenare – pjesa e Konferencës së Palëve që ka fuqinë për marrjen e vendimeve, si zgjedhja e përfaqësuesve, miratimi i axhendës dhe miratimi i vendimeve (shih gjithashtu Komisioni i Plotë)

Konventa Ramsar – Konventa e Ligatinave me Rëndësi Ndërkombëtare, e krijuar në qytetin Iranian Ramsar, në vitin 1971

Shteti Shtrires – një vend që ka juridiksionin mbi çdo pjesë të zonës së shpëndarjes së një lloji shtegtare

Raportues – pjesëmarrës në një Grup Pune, ose anëtar i një Komisioni që ka për detyrën raportimin e diskutimeve të Grupit të Punës ose Komisionit përkatës

Miratoj – shih aderoj, miratoj dhe nënshkruaj

Rekomandim – një vendim i një organi vendimmarrës që përshkruan veprime të dëshirueshme (shih gjithashtu Rezolutën)

Organizata e Integrimit Ekonomik Rajonal (REIO) – një organizatë si Bashkimi Evropian ku shtetet sovrane transferojnë kompetencat për politika të caktuara në një organ përtej nivelit kombëtar

Rezervë – njoftim nga një Shtet Anëtar që nuk dëshiron të ketë detyrimin në kuadër të një dispozite të caktuar të një instrumenti

Rezolutë – një vendim nga një organ vendimmarrës që përcakton politikën ose jep udhëzime për Sekretariatin, Njësinë Koordinuese, organin këshillimor shkencor ose të varësisë ose për Shtetet anëtare (shih gjithashtu Rekomandimin)

Samiti i Rios – një samit botëror i mbajtur në vitin 1992 që solli krijimin e Konventës për Diversitetin Biologjik (KDB), Konventës në Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimin e Klimës (UNFCCC) dhe Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Shkretëtirëzimit (UNCCD)

Rregullat e Proçedurës (ROP) – rregullat që rregullojnë administrimin e mbledhjeve (p.sh. votimin dhe të drejtën për të folur) për takimet e organeve të tilla si COP, MOP, MOS dhe Komisionin e Përhershëm)

Fondi për Mbrojtjen e Saharasë – një organizatë joqeveritare ndërkombëtare e themeluar në vitin 2004 për të mbrojtur faunën e egër të Saharasë dhe livadhet kufitare Saheliane

SBSTTA (Organ i Varësisë për Këshillimin Shkencor, Teknik dhe Teknologjik i Konventës KDB) – organi teknik dhe shkencor i Konventës për Diversitetin Biologjik, i ngjashëm me Këshillin Shkencor të konventës CMS

Këshilli Shkencor (ScC) – organi që siguron këshilla shkencore dhe teknike për konventën CMS

SDG (Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm) – objektivat e zhvillimit ndërkombëtar të pranuara në konferencën e Kombeve të Bashkuara (Rio +20) të mbajtur në Rio de Zhaneiro, Brazil në Qershor 2012

Sekretariati – organizata që administron një instrument

Nënshkruaj – shih aderoj, miratoj dhe nënshkruaj

Nënshkrues – një Shtet Anëtar i një Memorandumi Mirëkuptimi ose një vend që ka treguar synimin për t'u bërë një Shtet Anëtar i konventës CMS ose një Marrëveshjeje

Media Sociale – mënyra të komunikimit mes njerëzve që bëjnë të mundur që të krijojnë, të ndajnë dhe të shkëmbejnë informacione dhe ide nëpërmjet rrjeteve të komuniteteve në internet

Delegat i Sponsorizuar – një delegat në një mbledhje të Organit vendimmarrës, për të cilin kostot e udhëtimit dhe qëndrimit mbulohen nga organizatorët

Komiteti i Përhershëm (StC) – organi i varësisë që zakonisht ka përgjegjësinë për të përfaqësuar Shtetet Anëtare të një instrumenti dhe për të mbikëqyrur zbatimin mes mbledhjeve të Organit vendimmarrës. Në rastin e konventës ASCOBANS, ky rol luhet nga Komisioni Këshillimor

Deklaratë – një ndërhyrje zyrtare nga një delegat në një mbledhje që zakonisht shpjegon pozicionin e qeverisë së delegatit mbi një çështje të caktuar

Plan Strategjik – dokumenti i miratuar nga Shtetet Anëtare për një instrument ku përcaktohen objektivat afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë për zbatimin dhe zhvillimin

Organ Vartës – një term i përdorur për të përshkruar organet si; Komisionin e Përhershëm të një Instrumenti, qëllimi kryesor i të cilit është të përfaqësojë interesat e Shteteve Anëtare gjatë takimeve të organeve vendimarrëse

Organi i Varësisë për Këshillimin Shkencor, Teknik dhe Teknologjik i Konventës KDB (SBSTTA) – emri i Organit teknik dhe Shkencor të Konventës për Diversitetin Biologjik

Organi Teknik dhe Shkencor – organ i krijuar në kuadër të shumë instrumenteve, qëllimi i të cilit është të ofrojë këshillim teknik dhe shkencor, si p.sh. Këshilli Shkencor në konventën CMS)

Komisioni Teknik (TC) – emri për Organin Teknik dhe Shkencor për instrumente të ndryshme, si p.sh. AEWA

Termat e Referencës (TOR) – udhëzimet e dhëna për një komision ose Grup Pune ku specifikohet se çfarë duhet të bëhet

Teksti – formulimi i një instrumenti ku përcaktohen kërkesat (në krahasim me instrumentin si një institucion)

Mbrojtja e Natyrës (TNC) – një organizatë mjedisore me qendër në SHBA që është aktive në Shtetet e Bashkuara dhe shumë vende të tjera në botë

Konventa e Kombeve të Bashkuara për Ligjin e Detit (UNCLOS) – konventa e përcaktuar nga Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Ligjin e Detit (UNCLOS III), e mbajtur mes viteve 1973 dhe 1982

Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Shkretëtirëzimit (UNCCD) – një nga marrëveshjet MEA të realizuara në Samitin e Rios. Qendra e UNCCD është në Bon, Gjermani

Kuadri i Ndihmës për Zhvillimin e Kombeve të Bashkuara (UNDAF) – kuadri i programit strategjik që përshkruan përgjigjen për prioritetet kombëtare të zhvillimit për sistemin e Kombeve të Bashkuara në mënyrë kolektive

Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin (UNEP) – organi i Kombeve të Bashkuara me përgjegjësinë për mjedisin i krijuar si rezultat i Konferencës së Stokholmit për Mjedisin Human e vitit 1972. Qendra e saj është në Nairobi, Kenia.

UNEP/WCMC – Qendra Botërore e Monitorimit për Mbrojtjen (UNEP-WCMC) është një bashkëpunim mes Programit të Kombeve të Bashkuara për Mjedisin dhe WCMC dhe e ka qendrën në Mbretërinë e Bashkuar

Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimin e Klimës (UNFCCC) – një nga marrëveshjet MEA të realizuara në Samitin e Rios. Qendra e UNFCCC është në Bon, Gjermani.

Instituti i Kombeve të Bashkuara për Trainimin dhe Kërkimin (UNITAR) – i themeluar në vitin 1965 për trajnimin e personelit, sidomos nga vendet në zhvillim, për kryerjen e detyrave administrative dhe operacionale brenda Kombeve të Bashkuara

Universiteti i Kombeve të Bashkuara (UNU) – organi akademik dhe kërkimor i Kombeve të Bashkuara i themeluar në vitin 1973 me qendër në Tokio, Japoni

Wetlands International – organizatë joqeveritare me qendër në Holandë dhe me zyra në 20 vende që punon për qëndrueshmërinë dhe rehabilitimin e ligatinave dhe burimeve të tyre

Shoqata e Mbrojtjes së Faunës së Egër – një organizatë amerikane që menaxhon projekte kombëtare dhe ndërkombëtare për mbrojtjen, kërkime dhe programe edukimi.

Grup Pune – një grup ekspertësh dhe/ose përfaqësuesish me detyrën për të studiuar një çështje të veçantë ose hartimin e një dokumenti (shih gjithashtu Grup Pune në Sesion dhe Grup Pune Ndërmjet Sesioneve)

Konventa e Trashëgimisë Botërore – një marrëveshje ndërkombëtare e realizuar në vitin 1972 dhe e administruar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukimin, Shkencën dhe Kulturën (UNESCO), synimi i të cilës është mbrojtja e trashëgimisë botërore, natyrore dhe asaj së ndërtuar

Instituti i Burimeve Botërore (WRI) – një organizatë e pavarur me zyrat kryesore në Washington dhe Pekin e fokusuar në ndërveprimin e zhvillimit socio-ekonomik dhe mjedisit

Fondi Ndërkombëtar për Natyrën (WWF) – një organizatë e madhe joqeveritare ndërkombëtare që punon për mbrojtjen e specieve

Lista Faqeve të Internetit

Faqja e internetit e CMS-së	www.cms.int
Vendimet e Konferencës së Palëve të CMS-së	www.cms.int/bodies/COP/res_and_recs_cop1_to_10.pdf
Shtojcat e CMS-së (anglisht)	www.cms.int/documents/appendix/appendices_e.pdf
Shtojcat e CMS-së (frëngjisht)	www.cms.int/documents/appendix/appendices_f.pdf
Shtojcat e CMS-së (spanjisht)	www.cms.int/documents/appendix/appendices_s.pdf
Lista e Palëve të CMS-së	http://www.cms.int/about/part_lst.htm
Lista e Instrumenteve të CMS-së	http://www.cms.int/species/index.htm
Regjistrimi në Internet	http://www.unep-cms.com/
Udhëzimet për Planet SKPVB të CMS-së	http://www.cms.int/bodies/COP/cop10/docs_and_inf_docs/doc_27_guidelines_nbsap_e.pdf
AEWA	www.unep-aewa.org
Planet e Veprimit për Llojet Individuale të AEWA-së	www.unep-aewa.org/publications/ssap/index.htm
ASCOBANS	www.ascobans.org/
EUROBATS	www.eurobats.org/
Memorandumi i Mirëkuptimit për Breshkat e Detit i IOSEA	www.ioseaturtles.org/
Memorandumi i Mirëkuptimit për Peshkaqenët	http://sharksmou.org/
Strategjia Kombëtare për Ligatinat, 2003-2008, për Turqinë	http://www.ramsar.org/cda/en/ramsar-documents-wurl-policies-2003-2008-national/main/ramsar/1-31-116-162%5E21224_4000_0__
Plani i Komunikimit, Edukimit dhe Ndërgjegjësimit Publik (CEPA) për Mbrojtjen e Ligatinave në Kinë	http://www.ramsar.org/pdf/cepa/outreach_actionplan_china.pdf
Nature Uganda	http://www.natureuganda.org/
Dita Botërore e Shpendëve Shtegtues	http://www.worldmigratorybirdday.org/
WMBD në Botë	http://www.worldmigratorybirdday.org/2010/index.php?option=com_content&view=article&id=9&Itemid=9
Portali informues i Kombeve të Bashkuara për Marrëveshjet Shumëpalëshe për Mjedisin	www.informea.org
Prezantimi me SKPVB, Moduli 1	http://www.cbd.int/doc/training/nbsap/b1-train-intro-nbsap-revised-en.pdf

Atributet për Fotografinë

Titulli: (L-R, T-B): Breshka jeshile (*Chelonia mydas*): WWF-Canon / Jürgen Freund; Takimi i Peshkaqenëve: ENB; Lakuriqi i natës me krahët e harkuar (*Miniopterus schreibersii*): François Schwaab; Simpoziumi i Tretë i Azisë Juglindore për Gjitarët Detarë, Langkawi, Malajzi: Vivian Kuit; Antilopa shimitar Oryx (*Oryx dammah*): Olivier Born; Seminari i SKPVB në Harare, Zimbabve: Francisco Rilla; Flamingot e Andeve (*Phoenicopterus jamesi*): Omar Rocha; Babi dhe biri, Ekuador: Francisco Rilla; Delfini i zakonshëm (*Delphinus delphis*): João Corvina; Balenat me gungë (*Megaptera novaeangliae*) nëna dhe i vogli, Ishujt Ha'apai, Tonga: Glenn Edney / www.grida.no

Fq. VI: Dr. Bradnee Chambers: Francisco Rilla

Fq. 1: Elefantët afrikanë (*Loxodonta africana*): Biosphoto / Denis-Huot Michel & Christine / Fotografi

Fq. 10: Fokat e limanit (*Phoca vitulina*): Svend Tougaard

Fq. 14, Tabela 2.1 (T-B): Leopardi i borës (*Uncia uncia*): Mbrojtja e leopardit të borës; Albatrosi me çafkë të bardhë (*Thalassarche cauta*): Barry Baker; Delfini me vija (*Stenella coeruleoalba*): Julia Neider; Northern Bald Ibis (*Geroniticus eremita*): Sergio Tomey / www.sergiotomey.com; Orka (*Orcinus orca*): WDCS; Lakuriqi i natës me veshë të gjatë (*Plectorus auritus*): F. Greenaway; Gorilla lindore (*Gorilla beringei beringei*): Mondberge; Fokat e limanit (*Phoca vitulina*): Svend Tougaard

Fq. 15, Tabela 2.1 (vazhdon.) (T-B): Bilbilthi i kënetave (*Acrocephalus paludicola*): M. Lane / WILDLIFE / Fotografi; Dreri bukara (*Cervus elaphus yarkandensis*): Olga Pereladova / WWF Russia; Delfini pantropikal me pika (*Stenella attenuata*): William Rossiter; Dugong (*Dugong dugon*): J. Freund / WILDLIFE / Fotografi; Farangrënësi i kënetave (*Sporophila palustris*): Adrian Azpiroz; Pula me mjekër (*Otis tarda*), mashkull: Béla Motkó; Flamingot e Andeve (*Phoenicopterus jamesi*): Omar Rocha

Fq. 16, Tabela 2.1 (vazhdon.) (T-B): Breshka e zakonshme e detit (*Caretta caretta*): Jonathan Bird / Fotografi; Breshka jeshile e detit (*Chelonia mydas*): Douglas Hykle; Foka mesdhetare (*Monachus monachus*): M.A. Cedenilla / Habitat i CBD-së; Shqiponja peshkngrënëse (*Pandion haliaetus*): nga of Wings Over Wetlands; Pata kokëkuqe (*Chloephaga rubidiceps*): David Middleton / fotonatura.com; Antilopa Saiga (*Saiga tatarica*): Navinder Singh; Peshkaqeni balenë (*Rhincodon typus*): Komonuelthi i Australisë (GBRMPA); Krilla siberiane (*Grus leucogeranus*): George Archibald

Fq. 17, Table 2.1 (vazhdon.) (T-B): Kojliku sqephollë (*Numenius tenuirostris*): C.H. Gomersall / RSPB; Dreri i Andeve Jugore (*Hippocamelus bisulcus*): Hernán Pastore; Delfini i zakonshëm (*Delphinus delphis*): João Corvina; Elefanti afrikan (*Loxodonta africana*): Yannick Beaudoin / www.grida.no

Fq. 22: Sqepluga (*Platalea leucorodia*): Tim Faasen

Fq. 24: Breshka e zakonshme e detit (*Caretta caretta*): Jonathan Bird / Fotografi

Fq. 27: Antilopa shimitar Oryx (*Oryx dammah*): Olivier Born

Fq. 28: Mbledhje e Pikave të Përfaqësimit për Amerikën Latine, Panama: Francisco Rilla

Fq. 29: Foka e limanit (*Phoca vitulina*): Svend Tougaard

Fq. 42: Antilopa saiga (*Saiga tatarica*): I. Shpilenok / WILDLIFE Fotografi

Fq. 44: Gorilla lindore (*Gorilla beringei beringei*), Republika Demokratike Lindore e Kongos: Tim Freccia / www.grida.no
Fq. 45: Flamingot e Andeve (*Phoenicopterus jamesi*): Omar Rocha

Fq. 47: Dugong (*Dugong dugon*): Komonuelthi i Australisë

Fq. 64: Zgalemi i bardhë i stuhisë (*Pelagodroma marina*): Tony Palliser

Fq. 65: Antilopa shimitar (*Oryx dammah*): Olivier Born

Fq. 84: Mizakapësi bishtgjatë (*Alectrurus risora*): Adrian Aspiroz

Fq. 88: Pata kokëbardhë (*Branta leucopsis*): Tim Faasen

SHËNIME

UNEP CMS

Sekretariati UNEP/CMS
Kampusi UN
Platz der Vereinten Nationen 1
D-53113 Bon
Gjermani

Tel: (+49) 228 815 24 01/02
Fax: (+49) 228 815 24 49
E-mail: secretariat@cms.int
www.cms.int

Sekretariati UNEP/AEWA
Kampusi UN
Platz der Vereinten Nationen 1
D-53113 Bon
Gjermani

Tel: (+49) 228 815 24 13
Fax: (+49) 228 815 24 50
E-mail: aewa@unep.de
www.unep-aewa.org

UNEP promovon praktika mjedisore të shëndetshme në nivel global dhe në aktivitetet e saj. Ky publikim është printuar në letër të ricikluesshme, që është prodhuar duke përdorur praktika miqësore ndaj mjedisit dhe është e çertifikuar nga Këshilli Administrativ Pyjor. Politika jonë shpërndarëse synon të zvogëlojë emitimin e karbonit prej UNEP-it.